

RELACION

PËR

**PROJEKTLIGJIN ‘PËR BUXHETIN E
VITIT 2018’**



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

PROJEKTBUXHETI 2018

“BUXHETI I QYTETARIT, PËR QYTETARIN”

Tiranë, Tetor 2017

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	4
2. SITUATA EKONOMIKE	6
2.1. ZHVILLIMET KRYESORE MAKROEKONOMIKE GJATË VITIT 2017	6
2.2. PERSPEKTIVA AFATMESME 2018-2020	8
3. TREGUESIT KRYESORË TË BUXHETIT PËR VITIN 2018	9
3.1 TË ARDHURAT E PRITSHME PËR VITIN 2017	9
3.2 PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2018.....	12
3.3 SHPENZIMET PUBLIKE.....	15
3.4 DEFIÇITI BUXHETOR	16
3.5 VEPRIMTARITË POTHUAJSE FISKALE	18
3.6 MINIMIZIMI I RISKUT PËR VEPRIMET EKSTRA-BUXHETORE.....	20
3.7 BUXHETI VENDOR 2018.....	21
4. POLITIKAT SEKTORIALE DHE PËRFITIMET PËR QYTETARIN.....	29
5. REFORMAT NË BUXHETIN 2018.....	53
6. POLITIKAT E TAKSAVE PËR VITIN 2018.....	65
6.1 PAKETA E RE FISKALE.....	65
7. MONITORIMI I DETYRIMEVE TE REJA TË PRAPAMBETURA	70
7.1. MOSREALIZIMI NË KOHË I INVESTIMEVE PUBLIKE	71
7.2. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK	72
8. SHTOJCA ILUSTRUESE.....	74
8.1 TREGUESIT E PËRZGJEDHUR MAKROEKONOMIKË DHE FISKALË	74
8.2 ZHVILLIMET FISKALE GJATË 9-MUJORIT 2017	76
8.3 SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR 9-MUJORIN 2017.....	81
8.4 ECURIA E BORXHIT PUBLIK PËR 9-MUJORIN 2017	95
8.5 LISTA E KONCESIONEVE/PPP.....	102

1. HYRJE

Projektbuxheti 2018 starton një fazë të re të thellimit të reformave të ndërmarra gjatë katër viteve të kaluara duke u fokusuar në rritjen e ritmit të rritjes ekonomike dhe sjelljen më afër të shërbimeve publike te qytetari. Ky projektbuxhet dhe ai afatmesëm bazohet në një kuadër Makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Konkretisht, parashikimet e rritjes ekonomike kapin vlera përtej 4% bazuar në një rritje të balancuar si sektoriale ashtu dhe të kërkesës së brendshme dhe të huaj.

Defiçiti buxhetor për vitin 2018 planifikohet të jetë në nivelin 2.0% të PBB. Për të tretin vit rradhazi balanca primare parashikohet të jetë pozitive në nivelin 0.6% duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse për të dytin vit rradhazi. Rrjedhimisht, niveli i borxhit publik të targetuar, do të ulet me rreth 2.5 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 68.6% të PBB dhe do të vijojë këtë trend rënës në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Financimi i defiçitit do të realizohet nëpërmjet huamarrjes së brendshme dhe asaj të huaj, e cila do të bazohet tek huatë me terma pjesërisht të favorshme në kuadër të financimit të projekteve prioritare të Qeverisë, huatë me terma të favorshme në kuadër të mbështetjes së politikave zhvillimore të ndërmarra nga Qeveria dhe huamarrja me terma tregtare, në rast se kushtet e tregjeve financiare do të jenë optimale.

Projektbuxheti 2018 do të ketë më shumë burime në dispozicion si rezultat i politikave fiskale të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe uljen e informalitetit në të njëjtën kohë që synon nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Thellimit dhe zgjerimit të luftës kundër informalitetit, do të synojë formalizimin e mëtejshëm të tregut si dhe rritjen e të hyrave të buxhetit që do gjenerohen nga respektimi dhe zbatimi i sistemit tatimor në fuqi. Fokus të veçantë do të ketë taksa mbi pasuritë e paluajtshme ku Shqipëria mbetet mbrapa vendeve të rajonit dhe vendeve të BE si një burim i rëndësishëm i të ardhurave të qeverive vendore dhe rregullator i tregut.

Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2018-2020, pavarësisht konsolidimit fiskal i cili mbetet një angazhim serioz i Qeverisë për mandatin e saj qeverisës 2017-2021, do të vijojnë të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike në nivelin mesatar prej 5% të PBB, duke e orientuar atë drejt financimit të projekteve të rëndësishme strategjike të rrugëve nacionale, ujit të pijshëm, shëndetësi, arsim dhe bujqësi. Kjo do të arrihet pavarësisht konsolidimit fiskal i cili mbetet një angazhim serioz i Qeverisë për mandatin e saj qeverisës 2017-2021. Risetëzimi rural do të jetë fokusi kryesor i mbështetjes së qeverisë për zhvillimin rajonal në këtë mandat katërvjeçar. Për këtë qëllim, synohet përfshirja aktive e njësive të qeverisjes vendore nëpërmjet mekanizmit të bashkëfinancimit i cili jo vetëm rrit nivelin e financimit të projekteve në shërbim të komunitetit por edhe nivelin e angazhimit të vetë njësive të vetëqeverisjes vendore për të zgjeruar më tej dhe për të mirëmbajtur asetet e përfutuara nga këto projekte.

Projektbuxheti 2018 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për zbatimin e pesë reformave në sektorë kyç të ekonomisë: reforma e ujit, reforma në drejtësi, reforma në administratën publike, reforma e menaxhimit të financave publike dhe reforma administrative-territoriale të cilat, së bashku me reformat e tjera të ndërmarra, do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre.

Buxheti Vendor, për herë të parë, si rezultat i zbatimit të ligjit të ri “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i miratuar në prill të këtij viti, do të transferohet në nivel vendor 2 për qind e tatimit mbi të

ardhurat personale. Gjithashtu, transferta e pakushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore vetëm sipas këtij ligj do të jetë jo më pak se 1% e Produktit të Brendshëm Bruto, e cila në vlerë nominale përbën një rritje me rreth 3 miliardë lekë. Të ardhurat e njërive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2018 pritet të jenë 9% më të larta se ato të vitit 2017 kryesisht bazuar në përmirësimin e taksës mbi pronën. Pritshmëria është që kjo rritje e të ardhurave të shkojë e tëra në rritjen e investimeve publike të bashkive.

2. SITUATA EKONOMIKE

2.1. ZHVILLIMET KRYESORE MAKROEKONOMIKE GJATË VITIT 2017

Nga tërësia e statistikave dhe informacioneve të disponueshme, duket se ekonomia vijon tashmë një trajektore përshpejtuese të rritjes. Referuar statistikave të llogarive kombëtare tremujore, rezulton një përshpejtim i rritjes ekonomike për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 në nivelin 4.0% nga 3.14% në po të njëjtën periudhë të 2016-ës, apo nga 3.4% të 2016-ës në tërësi. Edhe midis tremujorëve të parë e të dytë të vitit 2017 rezulton një përshpejtim i rritjes ekonomike me norma rritje përkatësisht 3.94% dhe 4.06%.

Nga ana e kërkesës, rritja në gjysmën e parë të vitit 2017 është gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme. Në gjysmën e parë të vitit 2017 konsumi regjistroi një rritje reale prej 2.1% duke vijuar të njëjtin trend të vitit 2016 me një rritje reale mesatare prej 2.8%. Gjithashtu edhe investimet kanë vijuar të regjistrojnë ritme relativisht të larta, të vëna re që prej tremujorit të tretë të vitit 2015, ndonëse në gjysmën e parë të 2016, këto ritme të rritjes u ngadalësuan disi, përgjithësisht rrjedhojë e uljes së investimeve në industrinë nxjerrëse e lidhur kjo me konjunkturën e çmimeve të karburanteve. Investimet për gjysmën e parë të 2017 u rritën me 12.6% në terma realë nga një rritje prej 6.18% të regjistruar në vitin 2016 në tërësi.

Ndërkohë, kërkesa e huaj u rrit në terma real me 14.8% për gjysmën e parë të vitit 2017, e mundur nga një rritje e fortë e eksportit të mallrave në tremujorin e parë dhe një rritje e eksportit të shërbimeve në tremujorin e dytë.

Nga ana e ofertës, kontributin kryesor në rritjen e gjysmës së parë të vitit 2017 e dhanë degët: Ndërtimi me rritje reale 19.1% dhe kontribut 1.52 pikë përqindje; Aktivitete financiare dhe të sigurimit me rritje 13.16% dhe kontribut 0.4 pikë përqindje; Industria me rritje 5.1% dhe kontribut 0.6 pikë përqindje; si dhe administrata publike dhe mbrojtja, arsimit dhe shëndetësia me rritje 4.1% dhe kontribut 0.5 pikë përqindje. Ndërkohë, rritje dhe kontribut negativ për gjysmën e parë të 2017 kishte dega Arte, argëtim dhe çlodhje.

Përgjithësisht në linjë me përshpejtimin e vënë re në aktivitetin ekonomik rezulton edhe dinamika në tregun e punës. Sipas Anketës së Forcave të Punës, punësimi në gjysmën e parë të vitit 2017 u rrit me rreth 3.15%, kundrejt gjysmës së parë të vitit 2016, ndërkohë shkalla e papunësisë ka vijuar trendin e saj rënës që prej T1-2014 ku shënoi pikun prej 18.0%, duke zbritur gradualisht në rreth 14.3% në T2-2017 për popullsinë e moshës 15-64 vjeç. Në harkun kohor të një viti, pra krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2016 ku shkalla e papunësisë regjistronte nivelin 15.9%, rezulton një reduktim prej 1.6 pikë përqindje, i cili përbën gjithashtu një sinjal të rëndësishëm pozitiv sa i takon situatës ekonomike dhe pritshmërive në vijimësi.

Edhe treguesit e tjerë indirekt, në tërësi sinjalizojnë për një trend përshpejtues të ekonomisë. Ndër më kryesorët e treguesve indirekt, të cilët kanë njohur përmirësim konstant përfshirë edhe tremujorin e tretë të këtij viti, vlen të përmenden:

- *Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)* shënoi nivelin 113.8 në T3-2017 duke pësuar një rritje prej 1.8 pikësh nga tremujori i kaluar, ndërsa në krahasim me T3-2016 ka pësuar një përmirësim prej 8.4 pikë përqindje. Niveli aktual i TNE-së qëndron 13.8 pikë mbi mesataren afatgjatë¹ (në nivelin 100), dhe rreth 17.1 pikë përqindje mbi mesataren e 6 viteve të fundit (2011- T3_2017). Rritja e TNE-së reflektoi përmirësimin e besimit të bizneseve të tregtisë e ndërtimit, dhe besimit të

¹ Niveli 100 përfaqëson mesataren afatgjatë

konsumatorëve. Ndërkohë, nivelet e treguesve të besimit në shërbime dhe në industri rezultuan lehtësisht më të ulëta krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

- Rezultatet e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e dytë të vitit 2017 tregojnë se standardet e kredisë për bizneset mbetën pothuajse të pandryshuara nga tremujori i kaluar, ndërsa standardet e kredisë për individë janë lehtësuar. Sipas madhësisë së biznesit vihet re se standardet e kreditimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë lehtësuar disi, ndërsa në segmentin e ndërmarrjeve të mëdha kushtet kanë mbetur të pandryshuara. Për individët, standardet e kreditimit janë lehtësuar vetëm për kredinë konsumatore, ndërkohë që për kredinë për blerje banese kushtet mbetën të pandryshuara. Përqindja neto e bankave që raportuan për një lehtësim të standardeve për kredinë dhënë bizneseve gjatë tremujorit të dytë të 2017 regjistroi nivelin 1.2%, pas një vlerë prej -11.9% në tremujorin e parë të vitit 2017. Përqindja neto e bankave që raportojnë lehtësim për kredinë drejt individëve gjatë tremujorit të dytë të vitit 2017 është 10.6%, nga vlera prej 18.3% e një tremujori më parë.
- Inflacioni gjatë 9-mujorit të parë të 2017-ës shënoi një mesatare prej 2.1%, pas një periudhe të inflacionit të ulët mesatar prej 1.3% përgjatë vitit të mëparshëm .

Një sinjal domethënës sa i takon trendit të aktivitetit ekonomik vjen edhe nga performanca e zërave kryesorë të të ardhurave fiskale. Gjatë 8-mujorit 2017 (Janar-Gusht) të ardhurat nga tatimet e doganat kanë njohur një rritje prej rreth 6.7% kundrejt një viti më parë, ndërsa të ardhurat nga kontributet e Sigurimeve shoqërore janë rritur me rreth 10% kundrejt një viti më parë, duke reflektuar kryesisht përsheptimin e aktivitetit ekonomik në vend dhe së dyti, përmirësimin e administrimit në mbledhjen e e të ardhurave.

Të njëjtën ecuri pozitive paraqesin edhe statistikat e sektorit të jashtëm të ekonomisë. Sipas statistikave të tregtisë së jashtme, eksportet e mallrave gjatë 8-mujorit 2017, rezultojnë me një rritje prej rreth 12.8%. Në të njëjtën kohë importet totale të mallrave kanë rezultuar me një rritje prej 6.3% gjatë tetë muajve të parë të vitit, ku ndikimi më i madh vjen nga importi i produkteve minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike me 16.6%

Referuar statistikave të bilancit të pagesave, balanca tregtare gjatë gjysmës së parë të vitit, njohu një thellim të deficitit, por në të njëjtën kohë kjo u kompensua në një masë të konsiderueshme nga përmirësimi i balancës së shërbimeve, si rrjedhojë e rritjes së eksportit të shërbimeve. Kategoria me kontributin kryesor ishin shërbimet e lidhura përgjithësisht me sektorin e turizmit, të cilat gjatë gjysmës së parë të 2017 (pra pa përfshirë ende tremujorin e tretë, i cili shënon pikun e sezonit turistik) u rritën me rreth 12.8% kundrejt gjysmës së parë të 2016. Në të njëjtën kohë, rreth 99% e deficitit të llogarisë korente gjatë gjysmës së parë të 2017 u financua nga flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte, të cilat janë flukse jo borxh-krijuese për ekonominë. Në tremujorin e parë të vitit, flukset hyrëse të IHD ishin më shumë se tremujori i parë i 2016, ashtu si dhe në tremujorin e dytë të vitit ku IHD shënuan një rritje prej 18% kundrejt të njëjtit tremujor të 2016. Në tërësi Bilanci i Pagesave për gjysmën e parë të vitit ishte thuajse në balancë (me një deficit prej rreth 67 milionë Euro) duke mbajtur thuajse të pandryshuar stokun e rezervave valutore të vendit.

Zhvillimet e fundit makroekonomike dhe analizat tona sinjalizojnë se rritja reale për këtë vit do të jetë në linjë me parashikimet tona fillestare, por lehtësisht mbi parashikimin fillestar. Rritja reale për vitin 2017 në tërësi parashikohet të jetë 3.9%, nga 3.8% që ishte parashikimi fillestar i kryer një vit më parë.

2.2. PERSPEKTIVA AFATMESME 2018-2020

Perspektiva ekonomike pritet të përmirësohet në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike pritet të përshpejtohet në mënyrë të qëndrueshme duke arritur 4.4% në vitin 2020. Përkatësisht për çdo vit rritja parashikohet në 4.2% për vitin 2018; 4.3% në 2019; 4.4% në 2020.

Investimet, veçanërisht ato të Huaja Direkte dhe konsumi, pritet të jenë gjeneratorët kryesorë të rritjes. Eksporti i shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, pritet të kenë një performancë të mirë në afat të mesëm, duke u rritur me një normë vjetore prej 8.9% gjatë vitit 2018. Kërkesa e huaj neto në tërësi pritet të japë kontribut pozitiv përgjatë vitit 2018 dhe gjithashtu kontributi i kërkesës së huaj neto parashikohet të vazhdojnë terren pozitiv edhe përgjatë viteve të tjera 2019-2020.

Politika fiskale do të vazhdojë të orientohet drejt uljes të borxhit publik në periudhën afatmesme, synuar një nivel të investimeve publike prej 5% të PBB-së për vitet 2018-2020. Kjo do të mbështesë krijimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi, e cila është e rëndësishme për të mbajtur nivele relativisht të larta rritjeje, si në afatin e shkurtër, ashtu edhe në afatin e gjatë. Rritja e konsumit privat pritet të vazhdojë të jetë me vlera përshpejtuese pozitive, duke reflektuar besimin e përmirësuar të konsumatorëve. Në të njëjtën kohë, referuar raporteve të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, qëndrimi akomodues i parashikuar i politikës monetare për periudhën afatmesme, për sa kohë që presionet inflacioniste të mbeten në kahun e poshtëm, do të mbështesë gjithashtu konsumin privat dhe investimet dhe do të përbëjë një miks optimal të politikës fiskale konsoliduese nga njëra anë dhe politikës monetare akomoduese nga ana tjetër.

Rritja e konsumit privat përgjatë horizontit të parashikuar pritet të mbështetet edhe nga përmirësimet në tregun e punës, si rrjedhojë e rritjes së qëndrueshme të punësimit dhe politikës së rritjes së pagave. Kjo do të stimulojë rritjen reale të të ardhurave të individëve. Në të njëjtën kohë, edhe rritja e huadhënies për konsum parashikohet në rritje, duke reflektuar si përmirësimin e financave të individëve, ashtu edhe lehtësimin e standardeve të kredidhënies nga sistemi bankar.

Kërkesa e vijueshme për investime pritet të mbështetet nga përmirësimi i normave të shfrytëzimit të kapaciteteve dhe nga vazhdimi i rimëkëmbjes ekonomike gjatë periudhës së projektuar, si në Shqipëri, ashtu edhe në mjedisin e jashtëm.

Kërkesa totale e sektorit publik do të vijojë të jetë disi e kufizuar si rezultat i konsolidimit fiskal. Sidoqoftë, konsolidimi fiskal do të reduktojë ndjeshëm primet e risqeve në periudhën afatmesme dhe do të krijojë më shumë hapësira për zgjerimin dhe përforcimin e sektorit privat.

Në të njëjtën kohë, përbërja e politikave buxhetore të planifikuara në mbështetje të rritjes, pritet të mënjanojnë në një masë të caktuar efektet shtrënguese të konsolidimit fiskal. Më konkretisht, investimet publike afatshkurtër dhe afatmesëm janë ruajtur në nivelin 5% të PBB-së, të cilat kanë një shumëfishim relativisht të lartë në drejtim të kërkesës agregate afatshkurtër dhe janë të rëndësishme për rritjen potenciale në afatmesëm dhe afatgjatë.

Rritja në periudhën afatmesme në vijim do të jetë e orientuar drejt krijimit të vendeve të punës krahasuar me historikun, pasi sektorët e prodhimit më intensiv të forcës së punës pritet të performojnë më mirë se të tjerët. Për këtë arsye, rritja e punësimit total pritet të përshpejtohet gjatë viteve 2018-2020, ndërsa shkalla e papunësisë parashikohet të zbrësë në nivel një shifror në vitin 2021.

3. TREGUESIT KRYESORË TË BUXHETIT PËR VITIN 2018

3.1 TË ARDHURAT E PRITSHME PËR VITIN 2017

Të ardhurat e buxhetit të shtetit në fund të vitit 2017, pritet të jenë 438.4 miliard lekë. Krahasuar me vitin 2016, parashikohet një rritje prej 7.7%, ose 31.3 miliard lekë, duke arritur 28.1% të PBB-së nga 27.6% që ishin në vitin 2016. Rritja me 0.6% e kontributit të të ardhurave të buxhetit të shtetit në raport me Produktin e Brendshëm Bruto për vitin 2017, është tregues i rëndësishëm i përmirësimit të performancës së mbledhjes së të ardhurave në kuadër të reformës së konsolidimit të financave publike. Kjo rritje vjen kryesisht nga impakti i rritjes ekonomike dhe nga përmirësimi në administrimin e taksave.

Të ardhurat që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pritet të realizohen në nivelin 100%, duke shënuar një përmirësim të performancës së të ardhurave krahasuar me periudhat e mëparshme. Kjo vjen si rezultat i përpjekjeve intensive për uljen e informalitetit në ekonomi si edhe e rritjes së nivelit të pajtueshmërisë së tatimpaguesve me ligjin, përmes parimit të vetëkorrigjimit.

Tabela 6: Të ardhurat nga Tatimet dhe Doganat

(në milion lekë)

Tatime dhe Dogana	Buxheti 2017	zyrtar	Vlerësim 2017	Buxheti	Diferenca	Në %
Tatimi mbi vlerën e shtuar	141,200		139,317		-1,883	-1.3%
Tatimi mbi fitimin	29,200		31,700		2,500	8.6%
Akciza	46,700		46,000		-700	-1.5%
Tatimi mbi të ardhurat personale	36,200		34,000		-2,200	-6.1%
Taksa Nacionale dhe të tjera	39,700		41,200		1,500	3.8%
Taksa Doganore	6,400		6,400		0	0.0%
Totali "Tatime dhe Dogana"	299,400		298,617		-783	-0.3%
Kontribute nga DPT	78,250		79,033		783	1.0%
Totali	377,650		377,650		0	0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Pritshmëria e të ardhurave nga Administrata Doganore

Të ardhurat e pritshme për vitin 2017, janë vlerësuar mbi bazën e performancës së të ardhurave në periudhën Janar-Shtator 2017.

Tabela 7: Të ardhurat e pritshme nga Administrata Doganore

(në milion lekë)

Administrata Doganore	Buxheti zyrtar 2017	Vlerësim Buxheti 2017	Diferenca	Në %
Taksa doganore	6,400	6,400	-	0%
Tatimi mbi vlerën e shtuar	101,877	102,677	800	1%

Akciza	46,700	46,000	(700)	-1%
Renta minerare	2,100	2,000	(100)	-5%
Totali	157,077	157,077	-	100%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Performanca e të ardhurave nga TVSH në import është ndikuar në një masë të rëndësishme nga disa faktorë:

- Rritja e prodhimit vendas të karburantit ka ulur importin e këtij produkti dhe si rrjedhojë të ardhurat nga TVSH-ja në import. Karburanti prodhim vendas mbuloi rreth 30.8% të konsumit gjatë 9 muhorit të vitit 2017 krahasuar me 1.5% që ishte ky tregues vitin e kaluar. Efekti negativ për shkak të sasisë, është zbutur nga efekti i çmimeve ndërkombëtare të karburanteve. Ndërkohë rritja e çmimit të karburantit në bursat ndërkombëtare ku kuotohen këto produkte, ka dhënë rezultat pozitiv.
- Rritja e importit të energjisë elektrike si rezultat i rënies së prodhimit vendas dhe disiplinimit të konsumit.

Performanca e të ardhurave nga akciza, është ndikuar nga faktorët e mëposhtëm:

- rritja e importit dhe prodhimi vendas i karburanteve, ku vetëm për periudhën janar-shtator 2017 janë +10.5% ose 40,040 ton më shumë krahasuar me 9 muhorin e vitit 2016.
- rritja e importit të Gazit të Lëngët me 24.1%, importit dhe prodhimit të birrës me 13.7%, importit të pijeve energjike me 15.5%, importit dhe prodhimit të verës me 15.8% dhe importit të cigareve me 3.7%.

Të ardhurat nga Renta Minerare

Realizimi i të ardhurave nga renta për 12- muhorin 2017 pritet të jetë në vlerën 2 miliard lekë, 0.1 miliard lekë më pak se plani. Të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto do të jenë më të ulta për shkak të rënies së sasisë së eksportuar, pasi pjesa më e madhe e prodhimit ka shkuar për përpunim brenda vendit. Për 9-muhorin, efekti negativ për shkak të sasisë (-777 milion lekë) është zbutur nga rritja e çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare (+281 milion lekë). Gjithashtu, rritja e sasisë së minerale të eksportuara me afërsisht 22%, ka ndikuar pozitivisht.

Të ardhurat nga Taksa Doganore

Realizimi i të ardhurave nga taksa doganore parashikohet në masën 6.4 miliard lekë ose në masën 100% ndaj planit. Faktor kryesor në përmirësimin e performancës është rritja e importeve të taksueshme me mbi 5.2%, dhe përmirësimi i kontrollit doganor.

Pritshmëria e të ardhurave nga Administrata Tatimore

Të ardhurat e pritshme për vitin 2017 janë vlerësuar mbi bazën e performancës gjatë periudhës Janar-Shtator 2017.

Tabela 8: Të ardhurat e pritshme nga Administrata Tatimore (në milion lekë)

Administrata Tatimore	Buxheti zyrtar 2017	Vlerësim 2017	Buxheti	Diferenca	Në %
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	39,323	36,640		-2,683	-6.8%
Tatim mbi Fitimin	29,200	31,700		2,500	8.6%
Tatimi mbi të ardhurat personale	36,200	34,000		-2,200	-6.1%

Taksa Nacionale dhe të tjera	37,600	39,200	1,600	4.3%
Totali	142,323	141,540	-783	-0.6%
Kontribute nga DPT	78,250	79,033	783	1.0%
Totali	220,573	220,573	0	100%

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)*

Për periudhën 12-mujore 2017, të ardhurat nga Administrata Tatimore përfshirë kontributet, pritet të realizohen në masën 220.5 miliard lekë, ose në nivelin e planifikuar.

Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar brenda vendit pritet të realizohen në masën 36.6 miliard lekë, pra rreth 2.7 miliard lekë ose -6.8% më pak se plani. Kjo diferencë në planin neto të TVSH-së lidhet me rritjen e nivelit të rimbursimeve krahasuar me parashikimin vjetor. Në periudhën Janar-Shtator 2017, janë rimbursuar 9 miliard lekë, rreth 2.6 miliard lekë ose 39.7% më shumë se 9-mujori i vitit 2016, për shkak të rritjes së intensitetit të punimeve dhe e kërkesave për rimbursim nga investitorët e mëdhenj. Parashikohet që shuma që do të rimbursohet deri në fund të vitit 2017 të jetë mbi 15 miliard lekë ose 5 miliard lekë më shumë se planifikimi fillestar.

Të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin pritet të realizohen në masën 31.7 miliard lekë, pra rreth 2.5 miliard lekë ose 8.6% më shumë se plani. Ndikim kryesor në këtë rezultat ka patur, rritja e ndërgjegjësimit të taksapaguesve për deklarimin real të të ardhurave të realizuara, faza e dytë e betejës kundër informalitetit në ekonomi dhe intensifikimit të komunikimit të Administratës Tatimore me tatimpaguesit.

Tatimi mbi të Ardhurat Personale pritet të realizohen në masën 34 miliard lekë, -6,1 % ose 2.2 miliard lekë më pak se të ardhurat e planifikuara në fillim të vitit. Shkaku kryesor i këtij deficiti lidhet me zgjatjen e afatit të aplikimit të Ligjit të Rivlerësimit të Pasurisë së Paluajtshme me 3 muaj, deri në 31 Maj 2017. Për këtë periudhë 3 mujore, të ardhurat e realizuara nga rivlerësimi janë pasqyruar në zërin e taksave nacionale.

Të ardhurat nga Taksa Nacionale dhe të tjera pritet të realizohen në masën 39.2 miliard lekë, duke shënuar një rritje prej 1.6 miliard lekë ose 4.3% më shumë sesa parashikuar. Faktor kryesor me ndikim në këtë realizim kanë qenë të ardhurat nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme.

Të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore priten të realizohen në masën 79 miliard lekë, duke shënuar një rritje prej 0.8 miliard lekë ose 1% më shumë sesa parashikuar. Realizimi dhe tejkalimi i të ardhurave nga kontributet lidhet me luftën kundër informalitetit, ndërgjegjësimin e punëmarrësve dhe punëdhënësve si dhe me efektet e rritjes së nivelit të pagës.

Krahasimi me vitin 2016 për të Ardhurat Doganore dhe Tatimore

Viti 2017 pritet të mbyllet me performancë pozitive në të ardhura, duke shënuar rritje me 27 miliard lekë, ose +8% kundrejt vitit 2016. Ky është rezultat i rritjes ekonomike, përmirësimit në administrimin e të ardhurave, reformave strukturore të ndërmarra nga Qeveria dhe aksionit për reduktimin e informalitetit në ekonomi:

- Të ardhura nga TVSH-ja pritet të jenë +7.9 miliard lekë ose +6% kundrejt vitit 2016.
- Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin, pritet të jenë +2.5 miliard lekë, ose +8.7% kundrejt vitit 2016.
- Të ardhurat nga akciza pritet të jenë +4.1 miliard lekë ose +9.8% kundrejt vitit 2016.
- Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale, pritet të jenë 2.6 miliard lekë, ose 8.2% më shumë sesa viti i kaluar.

- Të ardhurat nga taksat nacionale pritet të jenë +15% kundrejt vitit 2016, kryesisht si rezultat i të ardhurave të mbledhura nga Rivlerësimi i Pasurive të Paluajtshme me një efekt +3.6 miliard lekë.
- Të ardhurat nga taksa doganore pritet të jenë +0.26 miliard lekë ose +4% kundrejt vitit 2016.
- Të ardhurat nga kontributet që mbliidhen nga DPT pritet të jenë +4 miliard lekë ose +5.5%

Tabela 9: Të ardhurat tatimore dhe doganore krahasuar me 2016

(në milion lekë)

Tatime dhe Dogana	Fakt 2016	Vlerësim 2017	Buxheti	VI 2017/Fakt 2016	Buxh % Buxh 2017/Fakt 2016	VI.
Tatimi mbi vlerën e shtuar	131,390	139,317		7,927	6.0%	
Tatimi mbi fitimin	29,151	31,700		2,549	8.7%	
Akciza	41,896	46,000		4,104	9.8%	
Tatimi mbi të ardhurat personale	31,412	34,000		2,588	8.2%	
Taksa nacionale dhe të tjera	35,794	41,200		5,406	15.1%	
Taksa doganore	6,137	6,400		263	4.3%	
Totali	275,780	298,617		22,837	8.3%	
Kontribute nga DPT	74,947	79,033		4,086	5.5%	
Totali	350,727	377,650		26,923	8%	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

3.2 PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2018

Në programimin e të ardhurave tatimore për vitin 2018, janë marrë në konsideratë efekti i rritjes ekonomike, politikat e kujdesshme fiskale si dhe efektet për rritjen e nivelit të pajtimit me ligjin nga tatimpaguesit.

Metodologjia e programimit të të ardhurave është bazuar në modelet bashkëkohore të programimit dhe në analizën e detajuar të faktorëve që ndikojnë në secilën taksë.

Në planifikim janë kombinuar faktorët makroekonomikë, me treguesit kryesorë që ndikojnë në taksa specifike. Janë vlerësuar sasi të dhe çmimet e mallrave kryesorë të importit dhe prodhimit vendas që mbulojnë mbi 90% të vlerës së të ardhurave totale. Në mënyrë të detajuar treguesit kryesorë për vlerësimin e të ardhurave janë:

- Rritjen nominale të PBB-së.
- Kursin e pritshëm të këmbimit të dy monedhave kryesore: USD dhe EURO me Lekun.
- Çmimet në Bursë që ndikojnë në të ardhurat nga TVSH-ja dhe Renta minerare.
- Sasitë e pritshme të importit të mallrave
- Rritjen e të ardhurave nga akciza për karburantet, cigaret, pijet etj, si rezultat i rritjes së pritshme në sasi të tyre, në përputhje me konsumin. Janë programuar të zhdoganohen +200 ton ose 6.5% më shumë cigare krahasuar me realizimin e pritshëm 2017. Po kështu është parashikuar rritja me 7% e importit të karburanteve bazuar në ecurinë e vitit 2017, konsumit të karburanteve në përputhje me rritjen ekonomike dhe nevojat e tregut
- Rritjen e çmimit të karburanteve me rreth 18%, krahasuar me muajin Gusht 2017, sipas parashikimeve në tregun ndërkombëtar

- Rritjen e të ardhurave nga TVSH-ja në import dhe TVSH-ja brenda vendit, e shoqëruar me programimin e fondeve të nevojshme për rimbursimin në kohë të tatimpaguesve
- Rritjen e të ardhurave nga Tatimi mbi Fitimin, e cila reflekton rritjen e deklarimit dhe qarkullimit të realizuar të operatorëve ekonomikë

Një faktor i rëndësishëm që do të mbështesë dhe garantojë realizimin e programit të të ardhurave të buxhetit për vitin 2018 do të jetë thellimi i Luftës Kundër Informalitetit, e cila do të shoqërohet me një fushatë të të gjerë sgaruese dhe edukuese për tatimpaguesit. Fokusi i luftës Anti-Informalitet do të jetë segment i bizneseve të mëdha, atje ku krijohet vlera e shtuar dhe ku kryhet volumi më i madh i transaksioneve.

Parashikimi i të ardhurave për vitin 2018, synon konsolidimin e mëtejshëm fiskal, forcimin institucional dhe përmirësimin e administrimit fiskal në mbështetje të rritjes ekonomike të qëndrueshme, duke nxitur rritjen e prodhimit dhe eksportet.

Të ardhurat Tatimore për vitin 2018, vlerësohen të arrijnë 424 miliard lekë, me një shtesë prej 23.8 miliard lekë ose 6% më shumë se pritshmëria e vitit 2017. Të ardhurat nga DPT dhe DPD (pa përfshirë kontributet) parashikohet të jenë 317 miliard lekë, me një rritje prej 6.6% ose 20 miliard lekë më shumë se viti 2017.

Tabela 10: Të dhëna krahasuese mbi të ardhurat tatimore dhe doganore

(në milion lekë)

Tatime dhe Dogana	Fakt 2016	Plan 2017	I pritshmi 2017	Diferenca I pritshmi 2017 / Plani 2017	Buxhet 2018	Diferenca buxhet 2018- i pritshmi 2017	Buxhet 2018/ I pritshmi 2017 ne %
TVSH	131,390	141,200	139,317	-1,883	150,734	11,417	8.19%
Tatim fitimi	29,151	29,200	31,700	2,500	33,913	2,213	7.0%
Akciza	41,896	46,700	46,000	-700	49,900	3,900	8.5%
Tatimi mbi të ardhurat personale	31,412	36,200	34,000	-2,200	37,300	3,300	9.71%
Taksa nacionale	35,794	39,700	41,200	1,500	38,340	-2,860	-6.94%
Taksa doganore	6,137	6,400	6,400	0	7,000	600	9.38%
Total të Ardhurat	275,780	299,400	298,617	-783	317,187	18,570	6%
Kontributet nga DPT	74,947	78,250	79,033	783	83,100	4,067	5.15%
Total	350,727	377,650	377,650	0	400,287	22,637	6%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Të ardhurat doganore janë parashikuar duke u bazuar në analizën e trendit historik të 60 grup-produkteve kryesore, për një periudhë tre-vjeçare. Ky parashikim është korrigjuar me efektet e faktorëve të tjerë të jashtëm në secilën taksë. E njëjta procedurë është ndjekur edhe për të ardhurat nga tatimet, duke marrë për bazë modelin statistikor të projeksionit të të ardhurave të pritshme si dhe faktorët ekzogjenë me ndikim në çdo taksë.

Faktorët e jashtëm të marrë në konsideratë të cilët ndikojnë në rritjen e të ardhurave për vitin 2018 janë:

- **Kuadri Makroekonomik**

Rritja nominale e Prodhimit të Brendshëm Bruto e skontuar me Koeficientin e Elasticitetit, është aplikuar duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjeve ndërkombëtare tek taksat ad-valorem si Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Renta minerare dhe Taksa doganore.

Në projektion janë përfshirë, faktorët e mëposhtëm:

- Rritja nominale e PBB-së.
 - Kursi mesatar i këmbimit Euro –Lek dhe USD-Lek.
 - Çmimet Brent të naftës bruto dhe mineraleve të tjera.
-
- **Efektet e politikave fiskale**
1. Rishikimi në ulje i kufirit të regjistrimit në T.V.SH. do të ketë një efekt shtesë në të ardhura me rreth **1-1.5 miliard lekë** në vit. Në fakt qëllimi i rishikimit të këtij pragu nuk është sigurimi i të ardhurave shtesë, pasi shumica e parashikuar e tyre, krahasuar me numrin e bizneseve të vogla është e vogël. Qëllimi madhor i kësaj nisme ka të bëjë kryesisht me formalizimin e tregut dhe verifikimin e zinxhirit të transaksioneve deri tek konsumatori final.
 2. Rritja e akcizës për cigaret në 5,850 lekë për 1000 cigare me qëllim përafrimin e mëtejshëm me Direktivën e BE-së 2011/64. Riskedulimi i rritjes synon ruajtjen e ekuilibrit në nivelin e ngarkesës fiskale me atë të shteteve fqinje, me qëllim shmangien e fenomeneve të kontrabandës dhe tregtisë ilegale në rajonet kufitare. Efekti shtesë në të ardhurat pritet të jetë rreth **1 miliard lekë**.

Parashikimi i të ardhurave sipas zërave për vitin 2018

Të ardhurat nga T.V.SH.-ja parashikohet të jenë në masën 150.7 miliard lekë, 11.4 miliard lekë më shumë se pritshmëria për vitin 2017 ose 8.2 %. Krahas TVSH-së që do të gjenerohet si rezultat i rritjes ekonomike, rritjes së volumit të importeve dhe konjunkturës së çmimeve ndërkombëtare, burimi kryesor i të ardhurave shtesë nga TVSH-ja për vitin 2017, do të jetë përmirësimi i administrimit të këtij tatimi, lufta ndaj informalitetit si dhe kontrolli i zinxhirit të transaksioneve të subjekteve në TVSH.

Të ardhurat nga akciza vlerësohen të jenë 49.5 miliard lekë me një rritje prej 3.9 miliard lekë ose 8.5% më shumë se pritshmëritë për vitin 2017. Faktorët kryesorë që ndikojnë në rritjen e parashikuar të të ardhurave nga akciza, krahas rritjes së importeve të mallrave të akcizës, do të jetë lufta kundër informalitetit, kontrolli më rigoroz i subjekteve të akcizës si dhe disiplinimi i mëtejshëm i procedurave të përfitimit të përjashtimeve dhe rimbursimeve nga kjo taksë.

Të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin vlerësohen me rritje 7% më shumë se viti 2017, duke u realizuar në masën 33.9 miliard lekë. Kjo si rezultat i rritjes së deklarimit dhe qarkullimit të realizuar të operatorëve ekonomikë.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale vlerësohen me rritje 9.7% më shumë se viti 2017, me një realizim në masën 37.3 miliard lekë. Në parashikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale janë marrë në konsideratë rritja e numrit të kontribuesve aktivë bazuar në ecurinë e vitit 2017 dhe pritshmëritë për formalizim të mëtejshëm të të ardhurave nga punësimi.

Të ardhurat nga taksa nacionale dhe të tjera vlerësohen në masën 38 miliard lekë. Parashikimet për këtë taksë për vitin 2018 janë 2.9 miliard lekë më pak se i pritshmi 2017, dhe lidhen me pasqyrimin në vitin 2017 në këtë zë të të ardhurave nga rivlerësimi i pasurisë (one off revenue) për rreth 3,6 miliard lekë, të cilat nuk do të jenë në vitin 2017.

Të ardhurat nga taksa doganore vlerësohen me rritje prej 600 milionë lekë më shumë se viti 2017, me realizim 7 miliard lekë. Ndikim në këtë zë kanë të ardhurat shtesë nga rritja e importeve.

Të ardhurat nga Kontributet për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore vlerësohen me një rritje 5 % më shumë krahasuar me pritshmërinë për vitin 2017, me një realizim në masën rreth 83.1 miliard lekë. Gjenerimi i të ardhurave shtesë për kontributet do të ndikohet nga rritja e performancës kontrolluese të administratës tatimore.

3.3 SHPENZIMET PUBLIKE

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2018 është planifikuar 496.6 miliardë lekë ose 30.1% e PBB.

Shpenzimet e personelit për vitin 2018, reflektojnë koston aktuale të Administratës Publike, politikën e rritjes së pagave dhe ndryshimet strukturore të parashikuara për t'u ndërmarrë. Në këto shpenzime planifikohet buxheti i institucioneve të reja të krijuara për mbështetjen e reformës në sistemin e drejtësisë si dhe kostoja financiare që rrjedh nga zbatimi i legjislacionit për nëpunësit civil si rezultat i procesit të ri-organizimit strukturor të ministrive të linjës. Shpenzimet totale për pagat në Administratën Publike janë planifikuar në masën 79.2 miliardë lekë.

Shpenzimet për interesa parashikohen në nivelin 41.5 miliardë lekë ose 2.5% të PBB, bazuar në pritshmëritë për ecurinë e normave të interesit.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore për vitin 2018 (pa përfshirë shpenzimet që realizohen nga institucione publike, që kanë si burim financimi të ardhurat jashtë limitit), janë parashikuar në masën 41.4 miliardë lekë ose rreth 2.5% e PBB-së.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2018 janë parashikuar në masën 46.1 miliardë lekë ose 2.8% e PBB-së. Në këtë zë është përlogaritur rritja e transfertës së pakushtëzuar për njësitë vendore, dhe e grantit specifik si dhe rritja e të ardhurave të veta. Shpenzimet e buxhetit vendor janë 7.5% më të larta se ato të aktit normativ për vitin 2017. Ky nivel shpenzimesh krahas financimit nga buxheti, parashikohet të mbështetet dhe në rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore në masën 1.3 miliardë lekë, kryesisht si rrjedhojë i përmirësimit të takës mbi pronën.

Shpenzimet e fondeve speciale. Këtu përfshihen shpenzimet totale për Fondet e Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, të cilat kapin një vlerë prej 170.5 miliardë lekë. Niveli i shpenzimeve për Skemën e Sigurimeve Shoqërore për vitin 2018, parashikohet në masën 126.1 miliardë lekë ose 7.6% e PBB, nga e cila për rritjen e pensioneve është parashikuar një fond prej 1.8 miliardë lekë. Ndërsa, shpenzimet e Skemës së Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për vitin 2018 janë parashikuar në masën 40.4 miliardë lekë ose 2.4% e PBB. Së fundi, shpenzimet për Fondin e Kompensimit në vlerë të Pronarëve, parashikohen në total në masën 4 miliardë lekë ose 0.2% e PBB.

Shpenzime të tjera sociale. Këtu përfshihen fondet për pagesën e papunësisë, aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike dhe dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë.

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në nivelin 800 milionë lekë.
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin 20.5 miliardë lekë, në të njëjtin nivel si vitin e kaluar.
- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 2 miliardë lekë ose 0.1% e PBB.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar në masën 2.02 miliardë lekë. Ky fond shkon për të mbuluar reformën e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, një pjesë të shpenzimeve të veprimtarisë hekurudhore, veprimtarinë e shërbimeve qeveritare dhe nxitjen e punësimit.

Niveli i Fondit Rezervë për vitin 2018, parashikohet të jetë në masën 2.7 miliardë lekë, përkatësisht 1.7 miliardë lekë Fond Rezervë i Këshillit të Ministrave dhe 1 miliardë lekë fond kontigjence për ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë.

Investimet Publike. Për vitin 2018 investimet publike janë planifikuar në masën 5.2% e PBB ose 86.1 miliardë lekë. Në planifikimin e investimeve për vitin 2018 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Ashtu, si edhe në vitin 2017, dhe në vitin 2018 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim. Për planifikimin e investimeve janë ndjekur kriteret e mëposhtme:

- *Prioritetet e Programit të Qeverisë për periudhën 2017 – 2021;*
- *Prioritetet e Integritit European;*
- *Projektet në vazhdim.*
- *Mbështetja me kosto lokale dhe TVSH për projektet me financim të huaj;*

Për vitin 2018 janë planifikuar 54.9 miliardë lekë financim i brendshëm dhe 30.5 miliardë lekë financim i huaj.

3.4 DEFICITI BUXHETOR

Deficiti buxhetor për vitin 2018 planifikohet të jetë në nivelin 2.0% të PBB. Për të tretin vit rradhazi balanca primare parashikohet të jetë pozitive në nivelin 0.6% duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse për të dytin vit rradhazi. Rrjedhimisht, niveli i borxhit publik të targetuar, do të ulet me rreth 2.5 pikë përqindje dhe do të vijojë këtë trend rënës në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Financimi i deficitit do të realizohet nëpërmjet burimeve të brendshme në rreth 2.5% të PBB dhe atyre të huaja në rreth -0.6% të PBB. Huamarrja e huaj do të bazohet: a) tek huatë me terma pjesërisht të favorshme në kuadër të financimit të projekteve prioritare të Qeverisë, b) tek huatë me terma të favorshme në kuadër të mbështetjes së politikave zhvillimore të ndërmarra nga Qeveria dhe c) tek huamarrja me terma tregtare në rast se kushtet e tregjeve financiare do të jenë optimale²

² Materializimi i kësaj huamarraje do të shoqërohej me ndryshime në raportet midis financimit të brendshëm dhe atij të huaj në varësi të vlerës së huazuar.

PARIMET DHE RREGULLAT FISKALË

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej Ligjit Organik të Buxhetit nr 57/2016, ligji i buxhetit për vitin 2018, materializon parimet dhe rregullat fiskalë të mëposhtëm:

1. *Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto;*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji vjetor i buxhetit 2018 targeton një nivel të borxhit publik total në 68.8% të PBB nga niveli prej 69.1% e PBB i targetuar për vitin 2017.

2. *Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva ekonomike botërore” (Ërld Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqëruar të ligjit vjetor të buxhetit;*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji vjetor i buxhetit 2018 bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krahasimore kundrejt projeksioneve të raportit “Perspektiva ekonomike botërore” (Ërld Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar më Tetor 2017²:

Parashikimet e PBB nominale të FMN dhe Ministrisë së Financave

<i>në miliard lekë</i>	2014	2015	2016	2017	2018	2019
			<i>Para.</i>	<i>Para.</i>	<i>Para.</i>	<i>Para.</i>
FMN - Perspektiva Ekon. Bot.	1,395	1,428	1,473	1,555	1,650	1,755
Ministria e Financave	1,395	1,428	1,473	1,555	1,650	1,755
Diferenca FMN - MeF (duhet te jete jo më e vogël se zero)	0	0	0	0	0	0

3. *Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0,7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji vjetor i buxhetit 2018 përfshin në një zë të veçantë të tij, emërtuar “Kontingjencë për impaktin në borxhin publik nga luhatjet e normave të interesit, et.j” një kontigjencë prej 4 miliardë lekë ose 0.8% e shpenzimeve totale. Kjo vlerë e përfshirë në buxhet është e papërdorshme për qëllime të tjera përveç pagesës së interesave nëse këto të fundit për të gjithë vitin në tërësi rezultojnë më tepër se sa alokimet respektive në buxhet.

4. *Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji vjetor i buxhetit 2018 nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.

5. *Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – “rregulli i artë”) të LOB deficit i targetuar në këtë ligj vjetor të buxhetit 2018 është 56% më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara direkt për qeverisjen qendrore ose rreth 62% më i ulët se sa shpenzimet kapitale të financuara nga qeverisja qendrore, por të alokuara edhe për FZHR, si dhe për sektorin e energjisë në formë kredie direkte për investime drejt këtij sektori. Rrjedhimisht, balanca korente e tarrëguar është pozitive në nivelin prej rreth 3.2% të PBB, duke shënuar gjithashtu një ndër vlerat më të larta të këtij parametri të rëndësishëm në 25 vite.

¹ *Në vlerë nominale stoku i borxhit total i pritur (vlerësuar) për vitin 2017 është 1,112.7 miliardë lekë, ndërsa ai i targetuar për vitin 2018 është 1,137.6 miliardë lekë. Ndërsa projeksionet (parashikimet) e PBB nominale janë respektivisht 1,555.2 miliardë lekë për vitin 2017 dhe 1,650 miliardë lekë për vitin 2018.*

<http://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2017/09/19/world-economic-outlook-october-2017>

3.5 VEPRIMTARITË POTHUAJSE FISKALE


Stoku i borxhit të garantuar në shtator 2017 arrin në rreth 50.8 miliardë lekë (3.3% e PBB) ose 4.7% e portofolit të borxhit të Qeverisjes Qendrore. Garancitë në tregun e brendshëm përfaqësojnë 59.4% të totalit të stokut të borxhit të garantuar ose 30.2 miliardë lekë, ndërsa garancitë e emetuara në favor të kreditorëve të huaj përfaqësojnë 40.6% të stokut të borxhit të garantuar ose 23.2 miliardë lekë.

Garancitë e brendshme përbëhen nga linja kredie afatshkurtra dhe me norma interesi tregtare, të cilat i janë akorduar Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) nga bankat tregtare vendase. Në dallim nga garancitë e brendshme, garancitë e huaja janë kredi afatgjata të akorduara kryesisht me norma interesi koncesionale.

Krahasuar me fundin e vitit të kaluar, borxhi i garantuar është ulur në vlerë absolute me 2.7 miliardë lekë për shkak të nivelit relativisht më të lartë të ripagesave në raport me disbursimet.

Rreth 83% e totalit të garancive shtetërore i përkasin sektorit të Energjisë. Akumulimi i lartë i garancive në drejtim të këtij sektori është në përputhje me objektivat e Qeverisë për të mbështetur sektorin e Energjisë, me qëllim që të përmirësojë performancën financiare dhe të rrisë efijencën.

Grafiku 1: Garancitë sipas sektorëve ekonomikë (Shtator 2017)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Gjatë vitit 2018, niveli i garancive shtetërore në terma relativ ndaj PBB dhe ndaj totalit të stokut të borxhit pritet të qëndrojë pothuajse në të njëjtat nivele, ndërkohë që pritet të ketë një zhvendosje nga garancitë e brendshme në drejtim të atyre të huaja. Në këtë drejtim do të kontribuojë disbursimi i pjesshëm ose i plotë i Huasë së garantuar me BERZH³, e cila do të mundësojë refinancimin e linjave ekzistuese të *Overdraft-it* që KESH ka me bankat vendase. Refinancimi i linjave të *Overdraft-it* do të shërbejë në uljen e riskut të refinancimit dhe optimizimin e kostove të borxhit të KESH, pasi huaja e ofruar nga BERZH ofron terma ndjeshëm më të favorshme. Borxhi me terma më të buta pritet të përmirësojë aftësinë paguese të KESH dhe njëkohësisht të ulë ekspozimin e Qeverisë ndaj riskut të kreditit që paraqet kjo kompani.

Përveç sa më sipër, gjatë vitit 2018 pritet edhe disbursimi i një pjese të Huasë së garantuar në vlerën 50 milionë Euro, e cila do të mundësojë implementimin e projektit “Linja e transmetimit 400 kV Shqipëri-

³ Huaja e garantuar në vlerën 2018 milion Euro, nënshkruar në korrik 2016.

Maqedoni”. Investimi që do të mundësohet nga kjo kredi pritet që të ketë ndikim pozitiv në aspektin strategjik, si dhe në aspektin e uljes së kostove të gjenerimit të energjisë elektrike.

Në pikëpamjen strategjike projekti synon: i) të përforcojë lidhjet e interkonjeksionit me rajonin, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në Rajon; ii) të zhvillojë rrjetin 400 kV në zonën Jugore të Shqipërisë ku parashikohen të zhvillohen burimet e ardhshme të prodhimit të energjisë elektrike; iii) të krijojë mundësi të mira për lidhje nëpërmjet linjës nënujore me Italinë, si pjesë e infrastrukturës së Korridorit të Tetë Evropian.

Në pikëpamjen e kostos projekti synon: i) të ulë kostot nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve më optimale të rajonit; ii) të krijojë kushtet për lidhje në rrjetin e transmetimit të burimeve të reja të energjisë që mund të rezultojnë me kosto më të ulët (të tilla si: TEC me gaz në zonën e Korçës me përfundimin e projektit TAP, burimeve të rinovueshme diellore, me erë, etj); iii) të reduktojë humbjet e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit. Nga ana tjetër, ulja e kostove do të shoqërohet me zbutjen e detyrimeve të kompanive që operojnë në fushën e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, duke reduktuar ekspozimin e Qeverisë si garantuese dhe si financuese e drejtpërdrejtë, ndaj riskut të kreditit të këtyre entiteteve.

Aktualisht, nga 25 kredi të huaja të garantuara, 5 janë në fazë disbursimi, ndërkohë që nuk ka pasur asnjë emetim garancie të re gjatë 9 muajve të vitit 2017. Në tabelën e mëposhtme paraqitet lista e garancive të emetuara nga Qeveria:

Tabela 11: Garancitë Qeveritare

I. Garanci të Brendshme					
Huamarrësi	Kreditori	Projekti	Data e nënshkrimit	Shuma (në milion Lek)	Stoku më 30.09.2017 (në mil Lek)
KESH	Raiffeisen Bank	Kredi KESH	27.08.2008	4,980.00	4,980.00
	BKT	Kredi KESH	20.12.2011	1,500.00	1,500.00
	BKT	Kredi KESH	28.12.2011	1,600.00	1,600.00
	Raiffeisen Bank	Kredi KESH	16.10.2012	5,610.00	5,610.00
	Raiffeisen Bank	Kredi KESH	19.11.2012	1,390.00	1,390.00
	IntesaSanPaolo	Kredi KESH	14.01.2013	4,200.00	4,200.00
	IntesaSanPaolo	Kredi KESH	03.03.2014	1,000.00	1,000.00
	Societe Generale	Kredi KESH	10.02.2014	802.20	802.20
	Raiffeisen Bank	Kredi KESH	20.11.2014	4,678.16	4,678.16
	Raiffeisen Bank	Kredi KESH	05.02.2015	4,412.10	4,412.10
Totali I				30,172.46	30,172.46
II. Garanci të Huaja					
ATK	KfW, Gjermani	Ndihmë në Mallra II	11.05.1992	491.72	239.94
	KfW, Gjermani	Ndihmë në Mallra III	11.05.1992	351.23	171.58
	KfW, Gjermani	Ndihmë në Mallra IV	04.01.1993	421.48	211.92
	KfW, Gjermani	Sektori Bujqësor Privat I	08.09.1993	545.08	287.24
DPUK/NUK Tiranë	Artigiancassa, Itali	Ujësjetlesi i Tiranës I	10.02.1995	922.43	332.54
	Artigiancassa, Itali	Furnizimi me Ujë i Tiranës II	18.03.1996	1,561.03	675.16
	Artigiancassa, Itali	Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës	11.05.2000	3,774.86	2,233.97
	Artigiancassa, Itali	Rehabilitimi i Rrjetit Hidrik të Tiranës	11.05.2000	482.43	469.47
ALBTELEKOM	Artigiancassa, Itali	Albtelekom	02.10.1995	935.46	354.02
NUK Krujë	KfW, Gjermani	Ujesjellës-Kanalizime Krujë	26.03.1998	147.52	100.49
Hekurudha Durrës	Artigiancassa, Itali	Rehab. i Hekurudhes Tir-Durrës	08.05.1995	425.74	161.12
KESH	OECF	Hidrocentrallet mbi Lumin Drin	28.11.1995	1,753.79	677.71
OST	EBRD	Nënstacioni i Transmetimit të Energjisë	10.10.2006	2,198.24	466.20
	KfW	Projekti i efikasitetit në energji	30.06.2015	5,495.60	12.41
KESH, OST	OECF	Transmetim, Shpërndarje e Energjisë	19.12.1996	3,205.43	1,435.03
	EIB	Transmetim, Shpërndarje e Energjisë	30.10.2001	4,121.70	1,681.54
	EBRD	TEC-i Vlorë	09.07.2004	5,495.60	1,001.64
	EIB	TEC-i Vlorë	06.12.2004	5,495.60	2,840.66
	KfW	Linja e Transmetimit 400 KV Tiranë-Podgoricë II	18.11.2004	4,808.65	935.90
	Exim Bank of Korea	Elektrifikimi i Zonave Rurale	20.10.2004	3,214.89	2,494.89
	KfW	Linja e Transmetimit 400 KV Tiranë-Podgoricë I	18.11.2004	479.24	427.94
	EBRD	Ristrukturimi i KESH	30.06.2016	29,937.94	0.00
Tirana Airport Partners	EBRD	Rruga Tiranë-Rinas	23.03.2005	1,236.51	250.69
Porti i Durrësit	EBRD	Porti i Durrësit	16.05.2007	1,923.46	858.66
RTSH	Deutsche Bank Frankfurt	Radio Televizioni Shqiptar	06.11.2015	2,756.67	2,284.74
Totali II				82,182.29	20,605.44
Totali garancive (I+II)				112,354.75	50,777.91

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

3.6 MINIMIZIMI I RISKUT PËR VEPRIMET EKSTRA-BUXHETORE

Ministria e Financave dhe Ekonomisë vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.

Aktualisht, janë në fuqi 8 kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), të cilat marrin mbështetje buxhetore, si dhe pritet që gjatë vitit 2018 të startojnë dhe 3 kontrata të reja të lidhura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë/Bashkisë Tiranë (bashkëfinancim) sipas detajeve të dhëna në Tabelën 12 të mëposhtme:

Tabela 12: Koncesionet/PPP me mbështetje buxhetore

Ministria e Linjës	Emërtimi i Koncesionit/PPP	Kohëzgjatja	Kosto vjetore viti 2018 (000/lek)
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ofrimi i Shërbimit të Kontrollit Bazë (Check-Up)	10 vjet (2015-2024)	876,080
	Ofrimi i shërbimeve të Integuara për ofrimin e setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, si dhe trajtimin e mbetjeve biologjike dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale	10 vjet (2015-2024)	1,560,300
	Ofrimi i Shërbimit të Dializës	10 vjet (2016-2025)	655,321
	Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore*	10 vjet (2018-2027)	886,300
Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	7 vjet (2015-2022)	752,770
	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	6 vjet (2017-2022)	661,502
	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit*	13 vjet (2018-2030)	0
	Ndërtimi, Operimi dhe Mirembajtja e Rrugës Milot - Morine	2018-2047 (30 vjet)	0
	Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese	5 vjet (2015 – 2019)	1,374,300
Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë / Bashkia Tiranë	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane Tiranë	30 vjet (2018-2047)	1,039,118
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Shërbimi i Skanimit në Dogana	15 vjet (2014-2029)	1,615,918
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë / Bashkia Tiranë	Ndërtimi i Shkollave në Arsimin Parauniversitar në Bashkinë e Tiranës*	8 vjet (2017-2024)	0
TOTALI			9,421,609

*Kërkesa për mbështetje financiare për këto projekte është miratuar nga MoFE dhe pritet që të lidhen kontratat përkatëse në vitin 2018

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Për sa i përket respektimit të nenit 4/2 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ku përcaktohet se "...shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat

(PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.", rezulton se:

- kufiri i lejuar prej 5% i të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës, pra i vitit 2017, është rreth 20 miliardë lekë.
- referuar Tabelës nr.7, pagesat vjetore neto që parashikohen të kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kontratat koncesionare apo PPP, kapin vlerën e 9.4 miliardë lekë për vitin 2018.

Rrjedhimisht, Buxheti 2018 respekton kufizimin ligjor të sipërcituar, pasi vlera e parashikuar prej 9.4 miliardë lekë për pagesat vjetore neto për kontratat koncesionare apo PPP për vitin 2018, përbën rreth 2.4% të totalit të të ardhurave tatimore faktike për vitin 2017.

3.7 BUXHETI VENDOR 2018

Reforma administrativo-territoriale ishte një nga prioritetet e programit të qeverisë për periudhën 2013-2017, duke u konsideruar si një nga reformat më të rëndësishme për të avancuar procesin e decentralizimit dhe fuqizimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Nga të dhënat financiare deri në vitin 2014, rezultonte se mbi 50% e njësive të vetëqeverisjes vendore sipas ndarjes së vjetër territoriale gjeneronin jo më shumë se 10 % të buxhetit nga të ardhurat e veta lokale dhe rreth 63% e njësive të vetëqeverisjes vendore shpenzonin mbi 50% të buxhetit për shpenzime personeli. Shumica e njësive të vetëqeverisjes vendore nuk kryente asnjë investim me të ardhurat e veta duke qënë të varura tërësisht nga transfertat e buxhetit të shtetit. Në këto kushte ndarja e vjetër administrative nuk ofronte as shërbime publike dhe as mundësi zhvillimi.

Me reformën e re administrativo-territoriale, u eliminua problemi madhor i fragmentizimit tepër të lartë të vendit, i cili përveçse nuk reflektonte lëvizjet demografike të dy dekadave të fundit, dhe rrjedhimisht edhe nevojat reale për shërbime dhe shpenzime, shoqërohej me një fragmentizim të skajshëm të burimeve financiare dhe kapaciteteve administrative.

Decentralizimi mbetet një ndër prioritetet e kësaj qeverie, dhe reformat e ndërmarra deri më tani pritet të kenë impaktin më të madh në organizimin e administratës publike si qendrore ashtu edhe atë vendore si dhe në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve vendore. Në katër vitet e ardhshme të qeverisjes do të vazhdojë zbatimi i plotë i reformës administrative pasi ajo garanton përmirësimin e shërbimeve publike për qytetarët si dhe rritjen e efektivitetit të tyre.

Zbatimi i reformës administrativo territoriale, do të shoqërohet me një paketë reformash fiskale dhe ligjesh mbështetëse, si dhe me ngritjen e mekanizmave konkrete për fuqizimin e njësive të reja vendore. Nëpërmjet vazhdimit të zbatimit të kësaj reforme në katër vitet e ardhshme të qeverisjes do të synohet: a) rritja e eficientësisë dhe efikasitetit në ofrimin e shërbimeve për qytetarët si dhe në përmirësimin e cilësisë e të aksesit të qytetarëve në shërbimet publike vendore; b) krijimi i kushteve për zhvillimin ekonomik lokal, c) reduktimi i pabarazive dhe krijimi i kushteve të domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm d) rritja e kapaciteteve të administratës publike vendore, si dhe forcimi i strukturave komunitare në nivel njësie vendore.

Autonomia financiare është thelbi i autonomisë vendore. Duke përkrahur decentralizimin e mëtejshëm të financave publike, qeveria qendrore do të krijojë mundësi që qeveritë vendore të kenë më shumë burime financiare, për të ushtruar funksionet dhe kompetencat në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme.

Megjithatë, për arritjen e objektivave strategjike të këtyre reformave decentralizuese, bashkitë e reja e kanë patur shumë të domosdoshme përgatitjen e një kuadri rregullator më të fortë që do të garantojë qëndrueshmërinë dhe konsolidimin e burimeve të tyre të financimit. Ndryshimi i shpeshtë i burimeve të financimit ndër vite, mungesa e rregullave si për përcaktimin e fondeve totale në dispozicion, e bashkuar me dobësi strukturore në menaxhimin financiar vendor janë shoqëruar me buxhete vendore të dobëta, të pamjaftueshme e të paparashikueshme, të cilat më pas kanë kontribuar edhe në krijimin e problemeve të tjera financiare, si p.sh. të detyrimeve të prapambetura vendore.

Ky është viti i parë i zbatimit të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” Me miratimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore që priten të dalin në zbatim të tij janë hedhur bazat e shendosha të mirëmenaxhimit të financave vendore. Përmes këtij ligji në vitin 2018 do të arrihet rritja e autonomisë fiskale edhe financiare vendore nëpërmjet sigurimit të më shumë burimeve të financimit për njësitë e vetëqeverisjes vendore, të shoqëruara me më shumë parashikueshmëri, stabilitet dhe transparencë. Në të njëjtën kohë, nga ky ligj rregullohet edhe forcimi i rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke siguruar më shumë disiplinë fiskale dhe krijimin e një balance midis autonomisë dhe disiplinës fiskale, në harmoni me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjit për Vetëqeverisjen vendore, dhe Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Rritja e kompetencave dhe fondeve për qeverisjen vendore në fusha dhe sektorë zhvillimorë si bujqësia, pyjet, rrugët, e transformon rrënjësisht konceptin e qeverisjes vendore duke i dhënë një dimension të ri qeverisjes vendore, më shumë mundësi zhvillimi, duke sjellë dukshëm edhe një përmirësim të shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe klimës së të bërit biznes.

Gjatë viteve 2016 dhe 2017 u bënë hapa të mëdha në kuadër të disiplinimit të financave në nivel vendor. Të ardhurat që njësitë e vetëqeverisjes vendore mbledhin në mënyrë të pavarur, pra të ardhurat nga taksat dhe tarifrat vendore janë rritur ndjeshëm (në fund të vitit 2016 ishin 28% më shumë se në krahasim me vitin 2015) dhe kjo rritje e të ardhurave është përkthyer në një rritje të shpenzimeve për investime (në fund të vitit 2016 ishin 26 % më shumë se në vitin 2015). Këto tendenca vijnë edhe në periudhën e nëntëmujorit të parë të vitit 2017 në krahasim me nëntëmujorin e parë të vitit 2016, me të ardhurat nga taksat dhe tarifrat vendore që janë rritur me 3.9 miliardë lekë, ose 53 % dhe shpenzimet për investime janë rritur me mbi 6 miliardë lekë. Për vitin 2018, bashkitë do të përfitojnë edhe nga ndarja e të ardhurave nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale, një instrument i ri i financimit të bashkive, që pritet të rrisë edhe partneritetin në luftën kundër informalitetit.

Buxheti vendor në vitet 2016-2017 ka garantuar kalimin efektiv dhe eficient të kompetencave, përgjegjësisive dhe të gjitha problematikave vendore, në funksion të reformës së re administrativo-territoriale, ndërkohë që buxheti vendor i vitit 2018 do të vijojë me procesin e konsolidimit të financave vendore të nisur me reformat e viteve të mëparshme përmes rritjes së të ardhurave vendore nga transferta e pakushtëzuar, mbështetjes me grantin specifik, si dhe burimeve të tjera të financimit nga të ardhurat e veta.

Fokusi kryesor në katër vitet e ardhshme të qeverisë në funksion të thellimit të zbatimit të reformës administrativo territoriale do të jetë në disa drejtime:

- i) *Garantimi i një sistemi të financave publike vendore që nxit transparencën, përgjegjshmërinë dhe eficiencën në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike.*

- ii) *Planifikim dhe buxhetim eficient dhe i mirë-integruar i shpenzimeve publike në nivel vendor me synim rritjen e efektivitetit dhe përdorimit me ekonomi të fondeve publike.*
- iii) *Përgatitja e një instrumenti financiar, i cili do të përdoret nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, për hartimin e programit buxhetor afatmesëm, duke unifikuar proceset e punës.*
- iv) *Forcimi i disiplinës financiare në nivel vendor, nëpërmjet vendosjes së parimeve, rregullave, proceseve dhe procedurave për hartimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit;*
- v) *Përmirësimi i raportimit dhe monitorimit të performancës financiare në nivel vendor;*
- vi) *Rritja e transparencës në mbledhjen e përdorimit të fondeve publike të pushtetit vendor;*
- vii) *Evidentimi i rasteve të vëshirësive financiare të njësisve të vetëqeverisjes vendore, përcaktimi i kushteve kur një njësi vendore konsiderohet e falimentuar si dhe i autoriteteve të cilat do ta administrojnë njësinë e vetëqeverisjes vendore në këto situata.*

Objektivat kryesore për buxhetin vendor të vitit 2018

Objektivi i buxhetit vendor i vitit 2018, do jetë konsolidimi i Reformës Administrativo – Territoriale për të rritur cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarit në nivel lokal. Në funksion të këtij objektivi transferta e pakushtëzuar së bashku me taksat e veta dhe të ndara do jetë rreth 3 miliardë lekë më e lartë se ajo e vitit 2017 dhe do shkojë tërësisht në rritjen e portofolit të investimeve publike vendore dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Përmes kësaj rritje do të synohet forcimi i decentralizimit fiskal, konsolidimi fiskal dhe financiar dhe orjentimi i qeverisjes vendore brenda një kuadri të qartë qëndrueshmërie dhe zhvillimor. Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet buxhetit të vitit 2018 për qeverisjen vendore janë si më poshtë:

- *Forcimi i autonomisë financiare vendore, që do të arrihet nëpërmjet vazhdimit të rritjes së konsiderueshme, së të ardhurave në dispozicion të bashkive nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, e cila do të jetë jo më pak se 1% e Produktit të Brendshëm Bruto, duke rritur gjatë vitit buxhetor 2018 në mënyrë të ndjeshme të ardhurat dhe stabilitetin e fondeve të disponueshme për qeverisjen vendore;*
- *Rregullimi i dobësisë strukturore të sistemit të financave ndërqeveritare, nëpërmjet lidhjes së transfertës së pakushtëzuar me një variabël makroekonomik; Kjo do të rrisë transparencën, parashikueshmërinë dhe stabilitetin e transfertës së pakushtëzuar. Ky rregull i munguar të paktën prej vitit 2000, e sjell Shqipërinë në linjë me praktikën më të mira ndërkombëtare të financave vendore dhe i jep fund praktikës së uljes së burimit kryesor të financimit për shumicën e bashkive. Jo vetëm që fondet nuk do të ulen, por do të rriten nga viti në vit në harmoni me rritjen ekonomike;*
- *Forcimi i disiplinës fiskale, duke vendosur rregulla dhe parime të qarta për hartimin, konsultimin, miratimin, zbatimin, raportimin dhe auditimin e buxheteve vendore, duke synuar një menaxhim të shëndoshë financiar dhe rritje të llogaridhënies. Njësitë e vetëqeverisjes vendore do të kenë të përcaktuar në mënyrë transparente fondet buxhetore të miratuara me ligj, si dhe kuadrin rregullator i cili përcaktohet përmes akteve nënligjore që do të dalin në zbatim të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;*
- *Sigurimi i mjaftueshmërisë së burimeve financiare në dispozicion të njësisve të vetëqeverisjes vendore, për financimin e funksioneve dhe kompetencave të tyre. Përmes buxhetit të vitit 2018, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të sigurojnë më shumë të ardhura në formën e granteve dhe transfertave, një pjesë të të ardhurave nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale si dhe nga taksa e automjeteve që do të rritet. Si rrjedhim, do të kenë në dispozicion më shumë burime financimi për të përcjellë sa më afër qytetarëve shërbimet me standartin e merituar;*

- *Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, social dhe territorial*, nëpërmjet shpërndarjes së drejtë të transfertave buxhetore dhe mbulimin e plotë me fonde buxhetore për funksionet e transferuara;
- *Forcimi i dialogut ndërqeveritar*, nëpërmjet përcaktimit të proceseve dhe instrumenteve për konsultimin dhe dialogun ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vendore, për transferimin e kompetencave dhe funksioneve, burimet e financimit dhe marrëdhëniet fiskale ndërqeveritare në përgjithësi;
- *Rritja e autonomisë fiskale dhe e kapacitetit të të ardhurave të njësisve të vetëqeverisjes vendore*, për të përmbushur nevojat financiare për ofrimin e më shumë shërbimeve;
- *Përmirësimi i qëndrueshmërisë, thjeshtësisë dhe barazisë* në sistemin e transfertave, së bashku me rritjen e transparencës dhe administrimin e financave publike në nivel vendor;

Transferta e pakushtëzuar 2018 dhe formula e shpërndarjes së saj


Ndarja e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2018, bazohet në një formulë të përmirësuar me karakteristikat e mëposhtme:

- E thjeshtë për t'u kuptuar dhe zbatuar;
- E bazuar në kritere që garantojnë funksionimin normal të njësisve të qeverisjes vendore;
- Garanton një sistem më të drejtë ekualizimi fiskal duke ndihmuar bashkitë me kapacitet më të ulët fiskal;
- Mekanizmi i shpërndarjes së transfertës është i përshtatur në funksion të reformës administrativo-territoriale;
- Ndarja e grantit bazohet plotësisht në formulë, pa përfshirë fondet për konviktet, shërbimet sociale, fondet e rrugëve rurale dhe rajonale.

Formula identifikon nevojat për shpenzime duke u bazuar në popullsinë relative, dendësinë e popullsisë dhe numrin e nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme. Përveç ekualizimit të kostove, i cili realizohet nëpërmjet komponentit të dendësisë dhe taksave të ndara, formula sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim fitimi i thjeshtuar i biznesit të vogël, taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa mbi transferimin e pasurisë, për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridikë.

Në buxhetin e vitit 2018, shuma e transfertës së pakushtëzuar e shpërndarë me anë të formulës rritet në 16.5 miliardë lekë, nga 13.5 miliardë lekë që ishte në buxhetin e vitit 2017, pra 3 miliardë lekë më shumë (ose rreth 22 % më e lartë) se në vitin 2017. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2018, krahasuar me vitin 2013, është 4.4 miliardë lekë më shumë ose rreth 36.6 për qind më e lartë (sic paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm). Rritja e konsiderueshme e transfertës së pakushtëzuar krahasuar me një vit më parë, tregon rëndësinë që ky buxhet i kushton procesit të decentralizimit dhe efikasitetit të qeverisjes vendore në zbatim të Reformës Administrativo - Territoriale.

Grafiku 2: Transferta e pakushtëzuar 2013-2018



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Transferta e pakushtëzuar do t'i sigurojë njësitë të vetëqeverisjes vendore mbulimin e diferencës mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur.

Transferta specifike

Në buxhetin e vitit 2018 do të vazhdojnë të financohen nëpërmjet transfertës specifike funksionet të cilat iu transferuan bashkive në vitin buxhetor 2016:

- Personeli edukativ dhe mbështetës në arsimin parashkollor,
- Personeli mbështetës i arsimit parauniversitar,
- Rrugët rurale rajonale,
- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri,
- Shërbimi pyjor,
- Ujitja dhe kullimi,
- Ofrimi i shërbimeve sociale.

Funksionet e transferuara, për vitet 2016-2017 dhe në vitin 2018, do të financohen nëpërmjet transfertës specifike të përcaktuar individualisht për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, sipas funksioneve. Kalimi i këtyre funksioneve së bashku me burimet e financimeve përkatëse do ketë një efekt pozitiv në buxhetin vendor të vitit 2018, në vlerën rreth 7.4 miliardë lekë. Buxheti i vitit 2018 lidhur me funksionet e transferuara në njësitë të vetëqeverisjes vendore do të shoqërohet me efektet e mëposhtme:

- Për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi janë transferuar në nivel vendor 174 punonjës, shoqëruar me një faturë financiare prej 141 milionë lekë, për të financuar shtesën e 10 stacioneve të reja zjarrfikëse, si dhe për të plotësuar standartin ligjor lidhur me numrin e punonjësve për stacionet ekzistuese për disa njësi vendore.
- Për funksionin e arsimit, janë transferuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në njësitë të vetëqeverisjes vendore 63 punonjës (nga të cilët 45 të arsimit parashkollor dhe arsimit të mesëm, si dhe 18 punonjës për shtimin e personelit edukativ, si rrjedhojë e hapjes së kopshteve të reja për disa bashki). Efekti financiar shtesë për këtë funksion në buxhetin e vitit 2018 është në vlerën e rreth 52 milion lekë.
- Fondi për rritjen e pagave, për të financuar funksionet e reja të transferuara në nivel vendor, me një vlerë rreth 500 milion lekë;
- Fondi prej 50 milionë lekë për investime në mjetet dhe pajisjet e stacioneve zjarrfikëse.

- Për funksionin e administrimit të pyjeve, është shtuar fondi prej 100 milionë lekë, për plotësimin e standartit ligjor (raporti midis një nëpunësi të bashkisë me sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor që ai mbulon) me qëllim administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullosor brenda kufijve territorialë administrative.
- Është shtuar fondi për mirëmbajtjen e kanaleve ujitëse dhe kulluese, dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të zjarrëfikseve.

Në një aneks të veçantë të ligjit të buxhetit të vitit 2018 janë përcaktuar masat e nevojshme, rolet dhe detyrat përkatëse për kryerjen e këtyre funksioneve.

Detyrimet e prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore


Detyrimet e njësive të vetëqeverisjes vendore janë krijuar në vite, si rrjedhojë e keqmenaxhimit të financave publike në nivel vendor, si dhe parashikimit optimist të të ardhurave. Detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për njësitë e vetëqeverisjes vendore deri në qershor të vitit 2017, arrijnë në vlerën **9.5 miliardë lekë** (kryesisht investime, shpenzime për mallra dhe shërbime dhe vendime gjyqësore). Në tremujorin e dytë të vitit 2017, janë krijuar detyrime që kapin vlerën **3.2 miliardë lekë** (kryesisht investime, shpenzime për mallra dhe shërbime). Një pjesë e detyrimeve të krijuara deri në qershor 2017 janë likuiduar dhe ndërkohë pritet likuidimi i plotë i tyre në periudhën në vazhdim. Në tremujorin e dytë të vitit 2017 janë likuiduar rreth **3.9 miliardë lekë** dhe vlera e mbetur e cila parashikohet të shlyhet në vitin në vazhdim, është rreth **9.1 miliardë lekë**.

Ligji i ri për financat e vetëqeverisjes vendore do të forcojë disiplinën financiare për të parandaluar akumulimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen, që mund të kthehen në një risk serioz potencial për këto njësi, me impakt negativ edhe në ekonominë e vendit në tërësi. Në këtë kuadër, qeveria po i kushton një fokus të posaçëm shlyerjes së detyrimeve të prapambetura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore ka hartuar një plan veprimi për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, i cili ka filluar të zbatohet nga ana e tyre, duke filluar nga viti 2016 dhe në vazhdim. Në vitin 2018 do të vazhdojë të monitorohet periodikisht zbatimi i planit të shlyerjes së detyrimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Treguesit Fiskal e Buxhetorë të Pushtetit Vendor (2014 -2018)

Buxheti vendor i vitit 2018, së bashku me të gjithë komponentët e tij (transferta e pakushtëzuar, transfertat specifike, renta minerare dhe të ardhurat e veta), është rreth 7.5 për qind më i lartë se në vitin 2017. Gjithashtu, ky buxhet për vitin 2018 do të jetë 2.8 për qind e PBB-së dhe krahasuar me vitin 2014, një vit para fillimit të zbatimit të reformës administrativo-territoriale buxheti vendor i vitit 2018 parashikohet me një rritje të ndjeshme me rreth 40 për qind. Me buxhetin e vitit 2018, do të financohen funksionet e transferuara në 61 bashkitë, në vlerën rreth 7.4 miliardë lekë, ndërsa Transferta specifike do të shërbejë vetëm për financimin e funksioneve të reja të transferuara tek njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Grafiku 3: Buxheti Vendor 2014-2018




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2018, janë parashikuar në masën 46.1 miliardë lekë ose 2.8 për qind e PBB-së. Në këtë zë është përlogaritur rritja e transfertës së pakushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, rritja financimit të funksioneve të reja, të cilat janë transferuar në nivel vendor si dhe rritja e të ardhurave të veta.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2018, parashikohet të kenë një rritje rreth 2 miliardë lekë më shumë se sa në 2017 ose e thënë ndryshe me një rritje prej 7.9 %, ndërkohë krahasuar me vitin 2014 të ardhurat vendore parashikohen me një rritje të konsiderueshme me rreth 50 për qind. Kjo rritje e nivelit të të ardhurave do të vazhdojë si rrjedhojë e reformimit të tarifave të shërbimeve publike, ndarjes më të drejtë dhe transparente të financave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmirësimit të vazhdueshëm të skemës së financimit të funksioneve të veta. Gjithashtu, ndryshimet që po përgatiten në taksën e pronës dhe kadastrën fiskale parashikohen të mbajnë peshën më të madhe të rritjes të ardhurave në buxhetin vendor.

Në vitet 2015, 2016 dhe 2017 ka patur një prirje rritëse të buxhetit vendor, respektivisht me 2.96 për qind të PBB-së në 2016 dhe 2.76 për qind të PBB-së në vitin 2017. Po ashtu tendenca e rritjes vazhdon edhe në projektbuxhetin e vitit 2018 (Grafiku 4). Kjo ka ardhur si rezultat i zbatimit të Reformës Administrativo - Territoriale, rritjes së transfertave qeveritare nga buxheti i shtetit, si dhe politikës së re të decentralizimit fiskal.


Grafiku 4: Shpenzimet dhe të ardhurat e NJVQV-ve



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Rritja e të ardhurave të mbledhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë viteve 2014-2018, evidentohet edhe në rritjen e peshës që zënë këto të ardhura si ndaj të ardhurave totale të buxhetit të shtetit, ashtu edhe ndaj Produktit të Brendshëm Bruto, sikurse shihet edhe në grafikun e mëposhtëm. Kjo tregon qartazi suksesin e reformës administrativo-territoriale në drejtim të mbledhjes së më shumë të ardhurave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Grafiku 5: Peshë specifike e të ardhurave të buxhetit vendor ndaj të ardhurave të buxhetit të shtetit dhe PBB-së




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017);

Rritja e shpenzimeve të realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, gjatë viteve 2014-2017, konstatohet edhe në rritjen e peshës që zënë këto shpenzime si ndaj shpenzimeve buxhetore në total, ashtu edhe ndaj Produktit të Brendshëm Bruto. Peshë specifike e shpenzimeve të buxhetit vendor ndaj buxhetit

të shtetit është rritur ndjeshëm për periudhën 2016 – 2018 (9.5 për qind), krahasuar me periudhën 2014-2015, ku shpenzimet e buxhetit vendor zinin vetëm 7.5 për qind të shpenzimeve të buxhetit qendror. Ndërkohë, siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm, për vitet 2017 - 2018, pesha specifike e buxhetit vendor ndaj Produktit të Brendshëm Bruto është rritur ndjeshëm me rreth 1 për qind më shumë se pesha që zinte në vitet 2013-2015.

Grafiku 6: Pesha specifike e shpenzimeve të buxhetit vendor ndaj shpenzimeve të buxhetit të shtetit dhe PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Në buxhetin e vitit 2018, konstatohet se ka një ndryshim të strukturës së shpenzimeve në favor të rritjes së shpenzimeve kapitale, gjithashtu ka tendencë në uljen reale të shpenzimeve administrative duke e krahasuar me buxhetin vendor të vitit 2014.

Reforma administrativo-territoriale mundësoi rritjen e aftësive fiskale për më shumë të ardhura dhe përqendroi buxhetin vendor te investimet duke shmangur fragmentimin e tij në mikroprojekte. Tendencat në rritje të shpenzimeve për investime është tregues i rëndësishëm që njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë filluar të mendojnë dhe punojnë me plane zhvillimore për komunitetet e tyre. Rritja e kompetencave dhe hapësirës administrative ka bërë që tashmë njësitë e vetëqeverisjes vendore të rrisin përgjegjësinë, transparencën dhe konsultimin publik në përdorimin e financave publike vendore.

4. POLITIKAT SEKTORIALE DHE PËRFITIMET PËR QYTETARIN

SHËNDETËSIA

Arritjet për vitin 2017

- U shtua me 20% numri i ambulancave aktive;
- U shtua 1 helikopter në Shërbimin e Urgjencës;
- Filloi funksionimi i Urgjencës Kardiake 24/7 dhe Urgjencës cerebrale në QSUT;
- Funksionon shërbimi i urgjencës në pikat turistike gjatë sezonit.

- Është ngritur Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore, qendra e komandë-kontrollit, e cila prej 3 prillit i shërben 680 mijë banorëve të kryeqytetit;
- Mbi 300,000 qytetarë, pjestarë të 80 mijë familjeve të varfëra ose me të ardhura të pakta përfitojnë kujdes mjekësor falas nga mjeku i familjes;
- U ulën ndjeshëm tarifat për vizita dhe trajtime tek mjekët specialistë për personat e pasiguruar; 600,000 qytetarë të pasiguruar përfitojnë nga vizitat falas tek mjeku i familjes dhe tarifat e ulura në kujdesin shëndetësor të specializuar, si edhe nga skema e rimbursimit falas për sëmundshmërinë kronike;
- Shërbimi parandalues dhe diagnostikimi i hershëm i sëmundjeve për të paktën 480,000 persona që do të kryejnë kontroll mjekësor bazë periodik;
- Ofrimi i shërbimit parësor nëpërmjet zgjerimit të skemës së medikamenteve nga 489 në vitin 2015 në 500 në mbyllje të këtij viti;
- Rikonstruksion dhe pajisje të reja për 5 poliklinika në Tiranë, Korçë, Gjirokastrë, etj;
- Rritja e aksesit të pacientëve për shërbimin e dializës nëpërmjet ofrimit në 5 qendra të reja;
- Reduktimi i vazhdueshëm i numrit të shpërthimeve epidemike me burim ndotjen e ujit në jo më shumë se 2 herë në vit për 2017, krahasuar me mesatarisht me 4 herë në vit për 2012-2013;
- Koha e përgjigjes së urgjencë është ulur në:
 - Nga 20 minuta në 2016 në 18 minuta këtë vit në zonat urbane;
 - Nga 45 min në 2016 në 43 min këtë vit në zonat interurbane;
- Sigurimi i qëndrueshmërisë së mbulesës vaksinale për vaksinat e kalendarit të vaksinimit në masën 95%;

Prioritetet për vitin 2018

- Synohet të ulet koha e reagimit të urgjencave mjekësore ndaj qytetarit për zonat urbane nga 18 minuta në vitin 2017 në 16 minuta në vitin 2018 dhe për zonat interurbane nga 43 minuta në vitin 2017 në 40 minuta në vitin 2018.
- Kohëpritja për angiografinë synohet të ulet nga 55 ditë në 2017 në 30 ditë në vitin 2018 duke vënë në funksionim hemodinamikën në Fier.
- Ulja e kohës së pritjes për rezonancën magnetike dhe skanerin në të gjitha spitalet.
- Zgjerimi i paketave të shërbimeve të hartuara për trajtim mjekësor të specializuar për pacientët ditorë (autizmi, sindroma Down, kujdesi paliativ, kataraktit, kirurgjisë vazale, etj).
- Përmirësim i ofrimit të shërbimit parësor nëpërmjet zgjerimit të skemës së medikamenteve në 520 në vitin 2018 për të gjithë popullatën e siguruar ose jo.
- Synohet realizimi i ndërhyrjeve konkrete për investime në infrastrukturën e shëndetit parësor dhe atë spitalor si:
 - Pediatria dhe qendra e informacionit në QSUT;

- Ndërtesa e mjekësisë interne (CEB). Ndërtesa (rreth 9000 m²) do të ketë 185 shtretër si edhe 20 shtretër terapi intensive. Do të ofrohen hapësira të mjaftueshme për shërbimet: 2 kate kardiologji, gastro-hepatologji, endokrinologji, hematologji, nefrologji dhe dializë;
- Përfundimi i punimeve të ndërtimit dhe kompletimi me pajisje i kirurgjisë së Përgjithshme në QSUT (CEB) (7 Salla operacioni dhe 32 reparte të kirurgjisë së përgjithshme me nga 30 shtretër secili, laborator histologjik dhe 11 shtretër për terapinë intensive. Këto salla do të mbulojnë rreth 20,000 operacione në vit);
- Godina e re e Farmacisë në QSUT;
- Klimatizimi i godinës qendrore në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi” (rreth 7000 pacientë në vit);
- Rikonstruksioni i Poliklinikës Dibër (Kooperacioni Italian);
- Rikonstruksion i Godinës së Qendrës Kombëtare të Shëndetit Mendor;
- Rikonstruksion i Dispancerisë. Kjo qendër e rëndësishme e kujdesit shëndetësor në Tiranë ofron shërbime për rreth 20,000 pacientë në vit;
- Kompletimi i Shërbimit Kombëtar të Urgjencave;
- Spitali Sarandë: mbyllja e punimeve të ndërtimit për kirurgjinë dhe maternitetin shoqëruar edhe me blerjen e pajisjeve mjekësore dhe të hotelerise kirurgjikale;
- Spitali Korçë: përfundimi brenda vitit 2018 i rikonstruksionit dhe një shtesë për maternitetin shoqëruar me 80 milion lekë pajisje mjekësore dhe hotelerie;
- Rikonstruksioni i Poliklinikës Gjirokastrë (Kooperacioni Italian);
- Finalizimi i procedurave për ndërtimin e spitalit Rajonal Fier si një qendër ekselence shërbimesh;
- Plotësimi i nevojave për mjek specialistë në rrethe nëpërmjet një plani të strukturuar i cili do të përfshijë rritjen e pagesës së mjekëve specialist të cilët do të pranojnë të punojnë në rrethe;
- Përgatitja e studimit për ndërtimin e 8 Qendrave të reja shëndetësore;

MBROJTJA SOCIALE

Arritjet për vitin 2017

Ndihma Ekonomike

- Ndhimë ekonomike të plotë dhe jo të pjesshme, sipas numrit të individëve të çdo familje. 32.441 familje do të paguhen dyfish/trefish më shumë se aktualisht.
- Rritje e fondit nga 3% në 6% për pushtetin vendor për të trajtuar rastet që nuk mund të përfitojnë nga sistemi elektronik;
- Dy dhe trefishim i masës së ndihmës ekonomike që përfitojnë familjet në nevojë, krahasuar me 2013;
- Pagesë shtesë për fëmijët që ndjekin shkollën dhe vaksinohen;
- Shpërblime për 80 mijë familje në nevojë për festat e fundvitit;

- Program ri-integrimi social që lidh skemën e Ndhmës Ekonomike me skemat aktive të Punësimit/Riintegrimit Social.
- Regjistër Elektronik Kombëtar me infrastrukturë elektronike të zhvilluar në të gjithë vendin që siguron menaxhim dhe kontroll më të mirë mbi përdorimin e fondeve të ndihmës ekonomike dhe shmang abuzivitetin.
- Shmangia e abuzivitetit në skemën e ndihmës ekonomike në masën 23% të skemës krahasuar me 2013;

Aftësia e Kufizuar

- Indeksi i përfitimeve me nivelin e inflacionit;
- Skemë e re vlerësimi për aftësinë e kufizuar bazuar në modelin bio-psiko-social sipas standardeve ndërkombëtare të OBSH-së;
- Përgatitja e kriterëve të reja të vlerësimi të aftësisë së kufizuar që i përgjigjet më mirë nevojave të individëve;
- Regjistër Elektronik Kombëtar dhe Arkivë Elektronike e ngritur për të shmangur vonesat e shkaktuara procedurale të individëve përgjatë procedurës së komisionimit;
- Përfituan pagesa të plota dhe në kohë 66.557 persona me aftësi të kufizuar, 18.311 kujdestarë të tyre si dhe, 71.528 invalid pune, ndryshe nga praktika e qeverisjes së kaluar.
- Praktikë e re në katër vite qeverisje, personat me aftësi të kufizuara kanë përfituar edhe pagesë shtesë në fund të çdo viti.
- Për herë të parë që nga viti 2014, skema e aftësisë së kufizuar tërësisht e audituar dhe ulur abuzivizmi me 8,7% (8,079 PAK).
- Që prej vitit 2014 personi me aftësi të kufizuara punësohet dhe pagesa e aftësisë së kufizuar nuk i ndërpritet për shkak të punësimit (për 4 vite);
- 900 paraplegjikë dhe tetraplegjikë kanë përfituar pajisje asistive falas në sajë të partneritetit me shoqërinë civile.

Shërbimet Sociale

- Paketë ligjore e plotë për Shërbimet e kujdesit Shoqëror, hap konkret drejt decentralizimit të shërbimeve shoqërore, krijimit të fondit social dhe zgjerimit të hartës së shërbimeve;
- Ligj “Për ndërmarrjet Sociale në RSH” me qëllim integrim dhe riintegrim i personave të përjashtuar nga tregu i punës;
- Ofrim i shërbimeve sociale nga figura profesionale, përmes rregullimit të profesioneve të psikologut dhe punonjësit social;
- Ngritur përgjatë tre viteve 15 shërbime të reja të përkujdesit social;
- Ngritur Regjistër Elektronik Kombëtar për Shërbimet Sociale i Integruar për të menaxhuar në kohë reale dhe efektive rastet e individëve në nevojë;
- 61 Pakte Sociale me 61 Bashki të vendit - angazhim konkret për të zgjeruar hartën e shërbimeve me 70 shërbimeve të domosdoshme në territorin e tyre;

- Rritur me 40% kthimi i fëmijëve nga institucionet e përkujdesit social rezidencial publik në familje në krahasim me vitin 2013.
- Rritur me 300% numri i fëmijëve në familje kujdestare duke garantuar rritjen e fëmijëve në familje në vend të institucioneve.

Prioritetet për vitin 2018

- Rritja e efikasitetit dhe transparencës së skemës të Ndhmës Ekonomike nëpërmjet administrimit të regjistrimit elektronik kombëtar dhe përdorimit të sistemit të pikëzimit. Qëllimi është rritja e shenjëstrimit dhe mbulimit të familjeve të varfra, krijimi i një sistemi të paanshëm dhe transparent, duke ulur subjektivitetin në vendim-marrje, si dhe rritja e efikasitetit në administrimin e skemës. Targetimi i më të varfërve do të bëjë të mundur “pastrimin” e skemës nga abuzuesit dhe futjen në skemë të familjeve më në nevojë. Brenda vitit 2018, do të shtrihet skema në nivel kombëtar duke përdorur kritere të reja gjithëpërfshirëse.
- Rritja e kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndhmës Ekonomike dhe përmirësimi i shërbimeve të kontrollit/auditit për të reduktuar numrin e abuzimeve.
- Transformimi i programit të Ndhmës Ekonomike në skemë aktive riintegrimi nëpërmjet krijimit të paketës për krijimin e mundësive për punësim, duke rritur përfshirjen në politikat aktive të tregut të punës në 5% të përfituesve të Ndhmës Ekonomike.
- Për vitin 2018 janë parashikuar të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike 79,891 familje. Synojmë targetimin më të mirë të familjeve në nevojë. Me skemën e re janë rishikuar masat e pagesës mujore, është hequr ndihma ekonomike e pjeshme dhe është rritur masa mesatare mujore në 5,600 lekë në muaj.
- Vënia në zbatim e sistemit të ri të vlerësimit sipas modelit bio-psiko-social duke rritur me 4.5% numrin e përfituesve që realisht u takon dhe duke ulur me 10% rastet abuzive. Objektivi lidhet me krijimin e një sistemi vlerësimi që ofron monitorim, nxit përgjegjshmërinë, nxit rritjen e kapaciteteve profesionale dhe realizon marrëdhëniet ndër-institucionale, duke krijuar një sistem koherent të vlerësimit të aftësisë së kufizuar; dhe një sistem integral të sigurimit të cilësisë dhe inspektimit, me qëllim parandalimin e abuzimeve.
- Rritja e transparencës së skemës së aftësisë së kufizuar nëpërmjet ngritjes dhe vënies në funksionim të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të integruar për skemën e pagesave të aftësisë së kufizuar duke përfshirë edhe një arkivë elektronike.
- Për vitin 2018 janë parashikuar të trajtohen me pagesa të aftësisë së kufizuar 164,410 persona (persona me aftësi të kufizuar, kujdestarë të PAK dhe invalidët e punës).

POLITIKA E JASHTME

Arritjet për vitin 2017

- Avancimi në procesin e Integritit European, pjesëmarrja aktive në NATO si dhe konsolidim i marrëdhënieve dy dhe shumë palëshe me focus të veçantë dimensionet ekonomiko-tregtare;
- Hapja në Tiranë e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor;

- Rritja e gamës së shërbimeve të ofruara në konsullata dhe zvogëlimi i kohës së dhënies së shërbimeve;

Prioritetet për vitin 2018

- Hapja e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Europian.
- Zhvillimi i mëtejshëm i marrdhënieve me prioritet partneriteti strategjik.
- Vazhdimi i angazhimeve për njohjen e mëtesjshme ndërkombëtare të shtetit të Kosovës për pjesëmarrje dhe anëtarësimin e saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare.
- Funksionalizimi dhe mbështetja e punës së dy nismave rajonale me seli në Tiranë: Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor dhe Fondi i Ballkanit Perendimor si dhe në tërësi pjesëmarrjes aktive në bashkëpunimet shumëpalëshe rajonale.
- Kryesimi i disa nismave rajonale dhe organizatave ndërkombëtare.
- Pjesëmarrje aktive dhe realizimi i kontributit të RSH në kuadër të NATO-s.
- Zbatimi i detyrimeve të anëtarësimit në organizata dhe forumme shumëpalëshe.
- Plotësimi i bazës ligjore të bashkëpunimit me vendet e tjera.
- Forcimi dhe rritja e rolit të diplomacisë publike ekonomike dhe diasporës, në shërbim të interesave ekonomike të Shqipërisë, promovimit dhe potencialit për investime, tregti dhe bashkëpunim ekonomik, tregtar dhe kulturor me partneret tanë ndërkombëtarë dy dhe shumë palësh.
- Realizimi i shërbimit konsullor mbështetur në profesionalizëm , efikasitet , transparencë dhe përgjegjshmëri.
- Regjistrimi i adresave të shtetasve Shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë.

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMIT RURAL

Arritjet për vitin 2017

Ujitja dhe Kullimi

- Rehabilitimi i kanaleve të kullimit me qëllim kullimin dhe mirëmbajtjen e 3000 ha tokë
- Sipërfaqja e ujitshme nga 155,000 ha, është rritur në 160,354 ha, duke futur në ujitje për herë të parë 5,000 ha;
- Janë mirëmbajtur dhe vazhdon 172 km kanale kryesore kulluese;
- Janë pastruar nga depozitimet e dherave dhe bimësia rreth 191 km rrjet i kanaleve kryesore ujitës;
- Janë ndërtuar argjinatura të reja përgjatë lumenjëve rreth 4.2 km, ndërkohë argjinatura të rehabilituara rreth 5.2 km;
- Është bërë e mundur me anë të shërbimit të kullimit ngritje mekanike me hidrovor në sasinë 600 milionë m³ ;
- Janë rikonstruktura dhe përshtatur 25 hidrovorë;

Siguria Ushqimore

- Janë vaksinuar kundër sëmundjes së plasjes 321,500 gjedhë dhe kundër sëmundjes së brucelozës janë vaksinuar rreth 590,000 të imëta;
- Janë çertifikuar dhe testuar rreth 5300 lloje të ndryshme farash dhe fidanësh;
- Janë regjistruar 10,000 njësi vreshti dhe ullishte;
- Janë regjistruar në sistemin e informacionit LIS dhe integrimi GIS në rreth 61,000 ha tokë;

Prioritetet për vitin 2018:

Zhvillimi Rural

- Rajonizimi i prodhimit bujqësor dhe blegtoral mbi bazën e potencialeve specifike sipas rajoneve, duke sjellë për pasojë rritjen e efektivitetit të mbështetjes financiare;
- Rritja e skemës së mbështetjes për afërsisht rreth 14 000 përfitues;

Siguria Ushqimore

- Ruajtja e situates epizootike te vendit nepermjet imunizimit te bagetive te imëta dhe gjurmimit të sëmundjes së brucelozës në gjedhë në 10% të krerëve;
- Reduktim në masën 10% të parazitëve karantinor me qëllim ruajtjen e sipërfaqeve të mbjella;
- Rritja e biodiversitetit nëpërmjet subvencionimit në masën 100% të racave në rrezik zhdukje;
- Vaksinimi i kafshëve të imta prej 3 milion për të mundësuar eksportin e tyre në vendet e Bashkimit European;
- Krijimi dhe mbajtja e kadastrës së vreshtarisë dhe verës dhe të ullirit të cilat do të mbulojnë identifikimin, regjistrimin, hedhjen e të dhënave në system sipas qarqeve (në nivel fshati);

Ujitja dhe Kullimi

- Pastrimi i 266 km të rrjetit të kanaleve kryesore kulluese, rindërtimi i 128 km tokë;
- Rehabilitim i kanaleve të kullimit me qëllim kullimin dhe mirëmbajtjen e 280 ha tokë;
- Përfundimi i projektit ekzistues të Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes të Bankës Botërore me rehabilitimit të ujitjes në 25 ha;
- Vazhdimi i rehabilitimit të rrjetit kryesorë të kanaleve të kullimit për fushën e Torroviçës në Lezhë dhe Fushën e Mliqit në Korçë;
- Përfundimin e rehabilitimit të kanaleve kryesore ujitëse në administrim të 4 bordeve rajonale të kullimit;
- Rehabilitimin e argjinaturave mbrojtëse të tokave bujqësore në zonat më të rrezikuara;
- Ofrimi dhe përmirësimi i sistemeve kryesore të kullimit, për rreth 45000 ha më shumë;
- Ndërtimi dhe rehabilitimi i 18 km argjinatura përgjatë lumenjëve;
- Sigurimi i shërbimeve të sigurta dhe të qëndrueshme të kullimit me ngritje mekanika me pompa (27 hidrovorë) për 70000 ha tokë bujqësore;

Këshillimi dhe Informacioni Bujqësor

- Rritja e numrit të fermerëve të kontaktuar dhe këshilluar nga shërbimi këshillimor publik në 12 qarqet në 75,000 në vitin 2018;
- Përfshirja me madhe e pedagogeve të Universitetit bujqësor, për trajnimin e ekstensionistëve sidomos për aspektet e menaxhimit ekonomik dhe financiar të fermave, marketingut dhe përpunimit të produkteve do të ndikojë në plotësimin e boshllëqeve që kanë ekstensionistet për njohuri të tilla;

ARSIMI

Arritjet për 2017

- U rrit me 20% numri i klasave përgatitore dhe 25% e tyre punojnë me kurrikulën e re bazuar në kompetenca, një kurrikul që shkon në të njëjtën linjë me atë të arsimit bazë dhe të mesëm të lartë;
- U hartua Korniza Kurrikulare të Arsimit Parashkollor dhe Standardet e Zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç;
- U zbatua kurrikulën e re në të gjitha klasat e dyta, të shtata dhe të dhjeta, e pilotuam atë në 26 klasa të treta dhe të teta, në 13 DAR dhe vazhdon zbatimi i kurrikulës së re në klasat e treta, të teta dhe të njëmbëdhjeta;
- U trainuan 1 302 drejtorë shkollash, në të gjitha DAR/ZA-të, për Standardet e performancës dhe kriteret e vlerësimit për drejtorët e shkollave;
- U trainuan 1 346 drejtues shkollash për udhëzuesin e arsimit të mesëm të ulët; 482 mësues të shkollave pilot për klasat IV dhe IX; 5000 mësues për zbatimin e kurrikulës së re në klasën XI dhe 500 mësues për vlerësimin e teksteve shkollore të reja;
- U renditën 5000 mësues sipas meritës në portalin “Mësues për Shqipërinë”;
- U zbatuan standardet e mësuesit sipas profileve lëndore;
- U ndërtua një skemë të re transparente për akreditimin e programeve të trajnimit të punonjësve mësues në sistemin arsimor parauniversitar, mbështetur në nevojat e identifikuara;
- U hartuan 22 programe të reja sipas kurrikulës së re për pakicat kombëtare;
- U standartizua testimi në nivel kombëtar të arritjeve të nxënësve edhe për arsimin fillor (klasa V), në arsimin parauniversitar;
- Në bashkëpunim me Këshillin e Europës, u hartua Profili Arsimor Gjuhësor të Shqipërisë;
- U mbështet zhvillimi profesional të mësuesve të gjuhës së huaj: MASR, ambasadat përkatëse dhe shoqatat e mësuesve të gjuhëve të huaja trajnuan rreth 1 000 mësues të gjuhëve të huaja italiane, frënge, angleze dhe gjermane;
- Pilotimi në 32 shkolla të 17 DAR/ZA, PISA-n 2018, me pjesëmarrjen e 2 147 nxënësve 15 vjeç. Ky pilotim u zhvillua në formatin “computer based”, sipas të cilit do të zhvillohet dhe PISA 2018;
- Klasat II, III, VII, VIII, X dhe XI zhvillojnë mësim me tekste të reja sipas standardeve më të mira;
- U siguruan tekste shkollore falas për 100 000 nxënës të sistemit parauniversitar;
- Ofrimi i transportit falas për 30 000 nxënës dhe 11 000 mësues;

- U rrit numri i mësuesve ndihmës për fëmijët me AK, nga 66 mësues në 2015, në 310 mësues në 2017;
- U trainuan, në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 195 mësues të lëndëve “Qytetari”, “Edukim për shoqërinë”, “Histori”, “Gjeografi”, si dhe 60 psikologë dhe punonjës sociale të DAR-ve Vlorë, Fier dhe Berat;
- U çertifikuan 216 drejtues shkollash sipas projektit “Shkolla e Drejtorëve”;
- Siguroam tekste shkollore falas për 3 444 nxënës romë dhe 5 833 nxënës egjiptianë. Gjithashtu, siguroam transportin falas për të gjithë fëmijët dhe nxënësit romë dhe egjiptianë në kopshite e shkolla që udhëtojnë në largësinë mbi 2 km nga shtëpia;
- MASR, KE dhe BE realizuan studimin kombëtar mbi bulizmin në sistemin arsimor parauniversitar shqiptar. Pas realizimit të këtij studimi, ka nisur pilotimi në 21 shkolla;
- MASR, KE, KQZ realizuan ndërgjegjësimin e maturantë votues për herë të parë të 365 shkollave të mesme;
- U hartua plani i veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020 dhe janë ngritur task-forcat institucionale për zbatimin e tij;
- U zgjerua rrjeti “Shkolla qendër komunitare” nga 66 shkolla në vitin 2013, në 225 shkolla në vitin 2016;
- Akreditimi institucional i të gjitha IAL-ve nga ekspertë të një agjencie anëtare e ENQA;
- Janë mbështetur 20 sportistë elitare nëpërmjet Federateve;
- Janë rritur kapacitetet akademike duke garantuar standardin 5-8 m² për student sipas nevojave të programeve të studimit;
- Realizimi i plotë online i proceseve të pranimit të studentëve në IAL;

Prioritetet për periudhën 2018-2020

Arsimi Parashkollor

- Në 2018 të sigurohet aksesin i fëmijëve në arsimin parashkollor në nivelin 85-86% për grupmoshën 3-6 vjeç.
- Në 2020 do të sigurohet në nivelin 95-100% aksesin i fëmijëve te grupmoshës 3-6 vjeç në arsimin parashkollor.
- Në vitin 2018, do të sigurohen falas tekstet mësimore për rreth 33 mijë nxënësit e arsimit parashkollor, nga klasa e parë deri në klasën e pestë.

Arsimi Parauniversitar

- Në vitin 2020, synohet të ketë jo më shumë se 28 - 30 nxënës për klasë në zonën urbane, e cila do të mundësohet përmes investimeve në infrastrukturën shkollore;
- Në vitin 2020, synohet të reduktohet braktisja shkollore në arsimin bazë, duke synuar drejt braktisjes 0 nga 0.57% që është aktualisht;

- Deri në vitin 2020 synohet të përmirësohet rezultati dhe renditja e Shqipërisë në vlerësimin ndërkombëtar PISA;
- Deri në 2020, i gjithë sistemi arsimor parauniversitar do të punojë me kurrikulat dhe tekstet e reja, të njëjta me kurrikulat analoge të BE;
- Në vitin 2018 do të rritet me 20% numri i Shkollave Qendër Komunitare;
- Në 2020, në arsimin bazë synohet të dyfishohet numri i psikologeve dhe punonjësve sociale;
- Deri në 2020 çdo shkollë e mesme do të ketë një psikolog dhe/ose një punonjës social;
- Deri në 2020, 100% e shkollave do të kenë shërbimin e internetit, nga 85% që e ofrojnë aktualisht;
- Deri në 2020 do të sigurohet një trajnimi dhe kualifikimi i të gjithë mësuesëve ku çdo mësues do të trajnohet dhe kualifikohet sipas nevojave të identifikuara;
- Do të realizohet monitorim online dhe inspektim në terren i cilësisë të trajnimeve të ofruara nga agjencitë e akredituara për ofrimin e këtij shërbimi.

Arsimi Gjithëpërfshirës

- Do të sigurohet arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës më synim 100% e fëmijëve të grupmoshës 6-16 vjeç të ndjekin arsimin 9-vjeçar;
- Rritja e treguesit të regjistrimit me 10-15% ose 350-500 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 10% për nxënësit me aftësi të Kufizuar;
- Në 2020, synohet dyfishimi i mësuesëve ndihmës për fëmijët me AK, nga 310 mësues që janë aktualisht;

Arsimi i Lartë dhe Kërkimi Shkencor

- 100% e IAL të sigurojnë akreditim Institucional e akreditim program studimi në vitin 2020;
- 100% të IAL- me kurrikula dhe programe të reformuara K E K në 2018;
- Të sigurohet standardi një vend pune për dy studentë në laborator kërkimorë shkencorë;
- Të sigurohet standardi 5-8 m² për student sipas natyrës së programit të studimeve;
- Rritja e përputhshmërisë së kurrikulave në tregun e punës me 100% në 2020;
- 100% e të dhënave të stafit akademik, të studentëve, të karrierës akademike, diplomimit, janë në regjistrin EK;
- 95% e doktorantëve janë pjesë e stafëve me kohë të plotë e departamenteve në 2020;
- 30% e financimit për kërkimin shkencor në IAL vjen nga ente private në 2020;
- Rritja e mobilitetit të stafit dhe studentëve me 20% në 2018 dhe 40% në 2019 dhe 60% në vitin 2020;
- 100% e studenteve ekselente, studente ne nevojë të perfitojnë bursa e kredi studentore në 2020;

ARSIMI PROFESIONAL DHE PUNËSIMI

Arritjet për vitin 2017

- Gjatë vitit 2017 arriti në 36% niveli i nxënësve të cilët vazhdojnë arsimin e mesëm në drejtimin e arsimit profesional;
- Rritje me 5% e investimeve në AFP-të në laboratorë, pajisje, kurrikulat, material mësimor etj, rritja me 25% në krahasim me 1 vit më parë të nxënësve që regjistrohen në shkollat AP;
- U krijua Këshilli kombëtar i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe komiteteve sektoriale me përfaqësim të partnerëve sociale dhe me një minimum përfaqësimi të femrave në masën 30%
- Shndërrimi i ofruesve vnë nivel rajonal (21) në qendra polifunksionale, në funksion të optimizimit të rrjetit të ofruesve, promovimi i një sistemi modern dhe gjithpërfshirës;
- Fondet e Nxitjes së Punësimit janë shumëfishuar vit pas viti. Kështu, fondet e nxitjes së punësimit janë pesëfishuar, në krahasim me 5 vite më parë duke arritur vlerën e 490 milionë lekë në vitin 2017. Me këtë financim është arritur që:
 - Numri i punëkërkuessve të papunë që trajtohen nga skemat e nxitjes së punësimit ka një rritje të konsiderueshme në mbi 7000 në vitin 2017.
 - Janë zgjeruar fushat e zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit deri në vitin 2017 në fusha të tilla si: industria prodhuese, industria e turizmit, teknologjia e informacionit, aktivitete të lidhura me bujqësinë dhe blektorinë, dhe industrinë të tjera prioritare.

Prioritetet për vitin 2018

- Prioritet në AFP do të mbetet cilësia nëpërmjet investimeve në infrastrukturë, programe dhe në zhvillimin profesional të mësimeve të nxënësve;
- Rritja e marrëdhënies me partnerët socialë (biznesin), duke krijuar gjithnjë e më tepër mundësi që nxënësit të kualifikohen profesionalisht pranë biznesit;
- Zhvillimi i procesit të futjes së elementeve të sistemit dual të arsimit profesional;
- Do të vijojë fuqizimi i ofruesve të AFP-së nëpërmjet një shkalle më të lartë autonomie të krijuar me legjislativën e ri;
- Modernizimi i kuadrit ligjor për AFP-në (mbi formimin bazë në AFP dhe për të rriturit), në zbatim të ligjit të ri të AFP-së do të ngrihen struktura të posaçme për monitorimin dhe inspektimin e ofruesve në AFP si mekanizma të domosdoshëm për garantimin e cilësisë;
- Zhvillimi i kompetencave të mësuesve të AFP-së, si dhe i trajnerëve të mësuesve (trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm profesional);
- Përpunimi dhe zbatimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
- Çertifikimi i 18.000 personave në qendrat e formimit profesional
- Përmirësimi i cilësisë dhe i ndjeshmërisë gjinore, kur flitet për informacionin në tregun e punës dhe sigurimi i përdorimit të tij për një qeverisje më të barabartë dhe më efektive, duke përfshirë edhe financimet;
- Synimi për të ndërtuar 6 shkolla të reja me kapacitet 600-800 nxënës për shkollë:
 - Tre shkolla do të ndërtohen në Bashkinë e Tiranës në drejtimet Megatronik, TIK, dhe Bujqësi;
 - Një shkollë në qytetin e Bashkisë Durrës me drejtim TIK;
 - Një shkollë e Turizmit në Bashkinë Vlorë dhe

- Një shkollë TIK në Bashkinë Korçë shkolle TIK

INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA

Arritjet për vitin 2017

Energjia

- Brenda vitit 2017 do të arrihet në vlerën 22 % përdorimi i energjisë së rinovuar, më shumë krahasuar me vitin 2009;
- Reduktimi i humbjeve të energjisë elektrike (teknike dhe joteknike) në rreth 21% deri në fund të vitit, krahasuar me 31.34% që ishte në 2015;
- Promovimi i mineraleve të rinj dhe kërkime teknologjike dhe mjedisore. Vlerësimi sasior dhe cilësor i rezervave minerare për vendbanime specifike;
- Vazhdimi i mbylljes së minierave të shfrytëzuara dhe joefektive, privatizimi i aseteve, për të mundësuar monitorimin e fenomeneve të post shfrytëzimit;

Infrastruktura

- Projekti i Bankës Boterore për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore 2015-2020, (afërsisht 130 milion USD, bashkëfinancimi Qeverisë Shqiptare dhe Bankës Botërore). Koncepti i mirëmbajtjes sipas këtij projekti do të jetë ai me Bazë-performance, (output and performance based).
- Hartimi i Paketës së Projekteve Prioritare për sektorin e transportit, (Single Sector Project Pipeline-SSPP), me 29 projekte të identifikuar, nga të cilat 16 janë projekte të infrastrukturës së rrugëve primare, (në vazhdim të reja), si dhe projekte për rrugët sekondare.
- Strategjia për Tarifat Rrugore (STRR) dhe Plani i Transportit të Qendrushëm Shqiptar, projekte të financuara nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).
- Instalimi i sistemit WEB-GIS në Autoritetin Rrugor Shqiptar.
- Koncesioni i Rrugës Kombit (Milot-Morinë).

Prioritetet për Vitin 2018

Energjia

- Për vitin 2018 synohet që të rritet e prodhimit vendas i energjisë dhe të ulen nivelet e humbjeve teknike dhe jo-teknike të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e sasisë së energjisë së importuar për përmbushjen e kërkesës me energji elektrike për vendin tone.
- Niveli i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes (teknike dhe jo-teknike) synon të ulet në nivelin 22%.
- Rritja e nivelit të arkëtimeve të faturave të energjisë elektrike.
- Vijimi i financimit të ndërtimit të linjës së Interkoneksionit 400kv Shqipëri-Maqedoni me një vlerë investimi prej 70 milion Euro, e cila, së bashku me linjën 400kv të Kosovës, e rrit me afërsisht 80% kapacitetet e transmetimit ndërkombëtar të energjisë elektrike;
- Do të përfundojë zbatimi i projektit të financuar nga Kooperacioni Italian me qëllim përmirësimin dhe fuqizimin e rrjetit shpërndarës të zonës Dhërmi-Sarandë, duke synuar rritjen e sigurisë së

furnizimit me energji elektrike për gjithë zonën e bregdetit Jon, me një fond të parashikuar rreth 16 milion Euro.

Infrastruktura

Për vitin 2018 është parashikuar hapja e projekteve të reja :

- Ndërtimi i Rrugës së Arbrit, si pjesë e projektit “1 Billion”
- Ndërtim rruga Thumanë – Vorë (pjesë e aksit kombëtar rrugor Durrës – Kukës – Morinë)
- Unaza e Madhe e Tiranës (vazhdim/kompletim)

Me buxhetin e 2018 është parashikuar të mbulohen totalisht me financim dhe të përfundojnë 10 segmente rrugore. Të detajuar këto segmente paraqiten si më poshtë:

- Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti 2 (dy viadukte) dublimi
- Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti 2 (dy viadukte) dublimi (shtesë punimesh)
- Përmirësimi i shtresave rrugore dhe i sinjalistikës segmenti rrugor Fushë Krujë - Thumanë. (Shtesë kontrate)
- Ndërtim rruga By pass Plepa-Kavaje-Rrogozhinë Loti 10 (shtesë punimesh)
- Riveshje Sistemim asfaltim rruga Elbasan-Banjë Loti 1
- Riveshje Sistemim asfaltim rruga Elbasan-Banjë Loti 1(shtesë punimesh).
- Riveshje Sistemim asfaltim rruga Elbasan-Banjë Loti 3 (shtesë punimesh).
- Riveshje dhe Sistemim Asfaltim, masa inxhinierike rruga Këlcyrë-Përmet Loti 3 (shtesë punimesh).
- Rikonstruksion segmenti rrugor Kodër-Kamëz - Tapizë.
- Rikonstruksion segmenti rrugor Kodër-Kamëz - Tapizë (shtesë punimesh)

Me buxhetin e vitit 2018 nga financimi i huaj financohen objektet si më poshtë:

- Projekti i ri i mirëmbajtjes Bankës Botërore për mirëmbajtjen dhe sigurinë rrugore.
- Ndërtim By pass i Fierit
- Ndërtim By pass i Vlorës
- Segmenti Tiranë - Elbasan
- Segmenti Qukës - Qafë- Ploçë

Për sinjalistikën dhe siguri rrugore, në projektbuxhetin të vitit 2018 janë parashikuar 202,5 milionë lekë investime në sigurinë rrugore, janë mbështetur me financim të gjithë objektet që janë në vazhdim nga viti 2017 dhe është parashikuar financimi total i tyre.

ZHVILLIMI EKONOMIK

Arritjet për vitin 2017

Lehtësimi i tregtisë:

- Krijimi i Komitetit Kombëtar për politikën tregtare dhe lehtësimin e tregtisë, krijuar me Urdhër Kryeministri, si një platformë e përbashkët diskutimi midis institucioneve shtetërore dhe biznesit për të gjitha politikat e hapjes së tregut dhe të lehtësimit të tregtisë.
- Miratimi i planit kombëtar për lehtësimin e tregtisë 2017-2020 dhe ndërtimi i faqes zyrtare të komitetit me informacion për rregullat e tregtisë dhe aktivitetit të komitetit.
- Vlerësimi i hapësirave për marrëveshje të reja të tregtisë së lirë me vendet e Magrebit. Është në përfundim analiza e plotë e impaktit tregtar

Integrimi rajonal:

- Finalizimi i procesit të miratimit të Protokollit Shtesë 5 për lehtësimin tregtisë në kuadër të marrëveshjes CEFTA. Protokollin është dërguar në KM për të vijuar me procesin e ratifikimit
- Finalizimi i negociatave teknike për Protokollin Shtesë 6, liberalizmi i tregtisë së shërbimeve në kuadër të CEFTA. Në proces për gatitja për firmosje
- Finalizimi i planit shumëvjeçar për krijimin e Zonës Ekonomike Rajonale, pjesa e tregtisë dhe investimeve,

Si rezultat, edhe të dhënat tregtare janë optimiste:

- 26,2 % rritje të eksporteve me vendet CEFTA, rritja më e lartë krahasuar me partnerët e tjerë referuar 8 mujorit 2017 dhe 8 mujorit 2016.
- 77% të eksporteve e zënë eksportet drejt vendet e BE-së. BE rikonfirmohet edhe për këtë vit partneri kryesor i Shqipërisë.
- 9% rritje të eksporteve me vendet e BE-së është shënuar gjatë 8 mujorit të 2017 krahasuar me 2016.
- 4% rritje ka shënuar eksporti fason gjatë 3 mujorit të dytë 2017 krahasuar me të njëjtën periudhë 2016.

Mbështetja e Biznesit

- 6 Kompani të financuara nga Fondi i Konkurrueshmërisë
- 12 Kompani të financuara nga Fondi i Start-Up
- 5 Kompani të financuara nga Fondi i Inovacionit

Mbikqyrja e Tregut

- Ulja e praktikave të padrejta tregtare me mospërputhje ligjore,
- Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të konsumatorëve dhe operatorëve në lidhje me kuadrin e ri rregullator të sigurisë së produkteve dhe të mbrojtjes së konsumatorëve.
- Rritja e nivelit të cilësisë të shërbimeve metrologjike, duke minimizuar matjet e pasakta në fusha të ndryshme të metrologjisë që ndikojnë direkt në mbrojtjen e konsumatorit
- Adoptimi i standardeve të publikuara nga IEC në masën 19% dhe i atyre të publikuara nga ISO në masën 22%.
- Hartimi i rregullave teknik të sigurisë së produkteve joushqimore në treg
- Realizimi i gjurmueshmërisë së matjeve në nivelin më të lartë ndërkombëtar
- Akreditimi i laboratoreve (në këto fusha: Presion, masës, volum dhe forca).
- Plotësimi i kërkesave të operatorëve ekonomikë vendas në fushën e telekomunikacionit për standardet e kësaj fushe, të cilat përdoren edhe në tregun evropian.

Prioritetet për vitin 2018

Bashkëpunimi Ekonomik

- Thellimi i bashkëpunimit dhe integritit rajonal nëpërmjet zbatimit të Planit shumëvjeçar për krijimin e Zonës Ekonomike Rajonale.
- Miratimi në Kuvend i Protokollit Shtesë 5 dhe Protokollit Shtesë 6 në kuadër të CEFTA për lehtësimin e tregtisë dhe hapjen e tregut të shërbimeve në rajon.
- Njohja reciproke e programeve AEO në kuadër të CEFTA si dhe e dokumenteve të kufirit, duke i dhënë një dimension të ri integritit rajonal,
- Përgatitja e dokumentit të politikave për mundësinë e marrëveshjeve të reja të tregtisë së lirë me vendet e Magrebit.
- Ndjekja e procedurave të negociimit teknik të disa marrëveshjeve të nxitjes dhe mbrojtjes së investimeve, specifikisht me Sllovakinë, Iranin, Islandën dhe Kanadanë;
- Ndjekja e procedurave të negociimit teknik të disa projekt-marrëveshjeve të bashkëpunimit ekonomik, specifikisht me Bosnjë-Hercegovinën, Algjerinë dhe Ukrainën;
- Ndjekja e procedurave të zhvillimit të Sesioneve të Komisioneve të Përbashkëta Ndërqeveritare “Për bashkëpunimin ekonomik” specifikisht me: Kinën, Rusinë, Hungarinë, Kroacinë e vende të ndryshme me synimin e nxitjes së bashkëpunimit ekonomik e tregtar në spektrin dypalësh.

Mbështetja e Biznesit

- 20 Kompani të financuara nga Fondi i Konkurrueshmërisë
- 13 Kompani të financuara nga Fondi i Start-Up
- 42 Kompani të financuara nga Fondi i Inovacionit
- 20 Biznese të Artizanatit të financuara nga fondi i Biznesit Kreativ
- 20 Sipërmarrje të mbështetura nga Fondi për mbështetjen e Turizmit

Mbikqyrja e Tregut

- Përmirësimi i legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve, nëpërmjet amendimit të Ligjit “Për Mbrojtjen e konsumatorëve” duke fuqizuar pozitën e konsumatorit në TREG
- Përmirësimi i transparencës së tregut në praktikën tregtare dhe bashkëpunimit midis operatorëve dhe konsumatorëve;
- Përmirësimi i i transparencës së tregut për praktikën tregtare në fushën e arsimit të lartë;
- Rritja e besueshmërisë së produkteve dhe shërbimeve në treg dhe rritja e eksporteve është prioritet i Qeverisë Shqiptare për zhvillimin ekonomik të vendit;
- Krijimi i kushteve sa më të mira dhe sa më të sakta, në paisjen e laboratorëve të kalibrimit dhe të verifikimit me paisje laboratorike;
- Rritja e sigurisë e produkteve jo-ushqimore të vendosura në treg dhe për të ndihmuar në funksionimin e një tregu të lirë konkures.

RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Arritjet për vitin 2017

- Zbatimi i “Planit Kombëtar Kundër Kultivimit të Kanabisit (P.K.K.K.) 2017-2021”:
 - Në bashkëpunim me agjencive ligjzbatuese në vend, me mbwshtetjen e partnerwve e veçanwrisht tw Guardia di Finanza-s, u sekuestrua rreth 60 ton lëndë narkotike.
 - Me rreth 32 mijë bimë kanabis të asgjësuar në periudhën janar-tetor 2017, Shqipëria shënoi minimumin historik të kultivimit të Kanabisit në 10 vitet e fundit, në përpjekjen e saj për të dalë nga lista e vendeve kultivuese të bimës narkotike duke rimarrë kontroll të plotë të territorit.
- Policia e Shtetit për periudhën janar – shtator 2017 ka sekuestruar 34.390.462 Euro, nga të cilat 3.230.462 Euro në formën e “llogarisë bankare” dhe 31.160.000 Euro si “pasuri”;
- Viti 2017 shënon minimumin historik të krimit ndaj personit, me vetëm 41 viktima vrasjeje kundrejt viteve të mëparshme me 54 vrasje. Ky fakt dëshmon një rritje të luftës kundër kriminalitetit, e posaçërisht të masave të marra për parandalimin e krimeve të rënda që shkaktojnë humbje të jetës së shtetasve;
- Ndryshimet në legjislacion lidhur me forcimin e penalteteve në Kodin Rrugor, kryesisht për drejtuesit e mjetit që përdorin telefonat celularë, nuk lidhin rripin e sigurimit ose kanë konsumuar pije alkoolike, kanë disiplinuar përdoruesit e mjeteve dhe ndërgjegjësuar qytetarët për rregullat e qarkullimit rrugor, ku rezulton:
 - 35 aksidente fatale më pak se 2016;
 - 55 shtetas të plagosur rëndë më pak se vitit 2016;
 - 17 aksidente në total janë më pak se viti 2016;
 - 27 mijë gjoba më pak se viti 2016;
 - 80 shtetas gjithsej, të arrestuar për ryshfete ndaj punonjësve të policisë rrugore;
 - 1827 arreste gjithsej, për pije alkoolike apo mungesë leje drejtimi (patente);
 - 10 mijë leje drejtimi të hequra për shkak të shkeljes së rregullave të qarkullimit ose shkelje të tjera të Kodit Rrugor.
- Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Zjarrfikës në Ministrinë e Brendshme kanë drejtuar dhe koordinuar operacionet për të bërë të mundur fikjen përfundimtare të zjarreve, ku u shënuan 900 vatra në total, nga të cilat 280 raste me rrezikshmëri për jetët njerëzore, pasuri e mjedis;
- Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit përballuan me sukses mbarëvajtje pa incidente serioze të procesit zgjedhor.
- Gjendja Civile hartoi listat të pakontestuarra zgjedhore. Ndërkohë po kryhet regjistrimi i plotë i adresave në gjithë vendin.
- Gjatë 9-mujorit të parë të vitit 2017, përmes verifikimit nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA), janë arrestuar 46 persona, nga të cilat 8 shtetas dhe 38 punonjës policie.
- Procesi i vetingut në Polici do të paraprihet nga një analizë e gjendjes aktuale dhe një paketë ligjore, e cila është premtuar të jetë gati në fund të vitit. I gjithë ky proces do të asistohet nga misioni “Pameca V” i Bashkimit Europian dhe ai ICITAP i Shteteve të Bashkuara tw Amerikws për të ndihmuar në zhvillimin e një proces teknik sa më profesional, transparent dhe të besueshëm.
- U realizua heqja e certifikatave personale dhe familjare dhe ofrimi i tyre online.

Prioritetet për vitin 2018

- **Institucione të forta, profesionistë me integritet:** Angazhimi ynë është të japim një kontribut në krijimin e një shteti më të sigurt, në të cilin mbizotëron respektimi i të drejtave të individëve të garantuara kushtetuta dhe ligjet, në krijimin e institucioneve ligj-zbatuese të forta dhe të qëndrueshme, sipas standardeve evropiane.
- **Institucione në shërbim të qytetarit:** Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe garantimi i sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, janë prioritet absolut për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, e cila do të ketë si toqfjalësh kyç në veprimtarinë e saj, ‘kontrollin e territorit’ dhe ‘policimin në komunitet’, të realizuara në praktikë përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor, në funksion të një kontrolli më efektiv të tij dhe transformimin rënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit
- **Lufta kundër krimit të organizuar – sfidë madhore:** Lufta pa kompromis dhe ndëshkimi i ashpër penal ndaj grupeve dhe/ose organizatave kriminale të ndryshme si dhe i grupeve me axhenda ekstremiste të dhunshme dhe terroriste duke shënjestruar, sekuestruar dhe konfiskuar çdo aset ekonomik të paligjshëm të tyre përbën një prioritet absolut për qeverinë shqiptare
- **Siguri publike dhe shërbime efikase ndaj qytetarëve:** Përmes forcimit dhe përsosjes së sistemit të policimit në komunitet dhe përmirësimit rënjësor të sistemit të kontroleve dhe inspektimeve në territor, ne synojmë të forcojmë Sigurinë Publike ndaj qytetarëve. Kufij të sigurtë – menaxhim i integruar i tyre. Forcimi i kontrollit në kufi dhe përmirësimi i shërbimit në pikat e kalimit kufitar, mbetet prioritet për qeverinë, si kusht për të garantuar lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave
- **Beteja kundër kultivimit dhe trafikimit të drogës:** Shqetësimet serioze të shkaktuara nga kultivimi, trafikimi dhe konsumi i drogave, na bëjnë ne të vendosur për të vazhduar më tej betejën pa kompromis kundër këtij fenomeni të paligjshëm dhe kriminal. Ne rikonfirmojmë zotimin e qeverisë shqiptare për të kthyer në një realitet të konsoliduar atë çfarë arritëm gjatë vitit 2017 - heqjen e vendit tonë nga harta e vendeve kultivuese të kanabisit.
- **Lufta kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave:** Angazhohemi për një luftë totale ndaj korrupsionit dhe pastrimit të parave në bashkëpunim me Prokurorinë, strukturat e Hetimit Tatimor dhe Doganor, Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave.
- **Siguria rrugore:** Angazhim maksimal për përmirësimin rënjësor të sistemit të kontrollit rrugor, duke synuar krijimin e një kulture të re në qarkullimin e mjeteve dhe të qytetarëve dhe sidomos në menaxhimin e sigurisë rrugore. Do të implementohen sisteme të avancuara teknologjike të mbikëqyrjes së qarkullimit rrugor dhe të evidentimit të saktë dhe në kohë reale të shkeljeve të dispozitave të kodit rrugor, si dhe një sistem i automatizuar dhe i perfeksionuar për vendosjen dhe mbledhjen e gjobave.
- **Inteligjenca dhe informacioni:** Fuqizimi i kapaciteteve të shërbimeve të inteligjencës dhe informacionit përbën një domosdoshmëri përballë sfidave ndaj rendit dhe sigurisë publike dhe sidomos veprimtarive të organizuara kriminale, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Udhëheqja nga Inteligjenca e veprimtarisë së strukturave të policisë gjyqësore në tërësi dhe asaj kriminale në veçanti, përbën një model modern policimi të karakterizuar nga një qasje pro-aktive hetimore dhe rezultate efikase. Aplikimi me sukses i shërbimeve të inteligjencës dhe informacionit është kusht për përmbushjen e shumë prej prioritetëve të paraqitura në këtë dokument.

- **Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar:** Prioritetet e mësipërme kërkojnë si domosdoshmëri konsolidimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me organizatat e specializuara në luftën kundër krimit përfshi dhe asistencën direkte në territorin tonë nga institucionet ndërkombëtare dhe/ose nga shërbimet policore partnere në luftë kundër krimit, kryesisht atij të organizuar.

MBROJTJA

Arritjet për vitin 2017

- Ministria e Mbrojtjes ka shënuar arritje cilësore në gjithë veprimtarinë dhe angazhimet e saj, të cilat janë produkt i përpjekjeve të përbashkëta të gjithë strukturave dhe lidhshimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH);
- Lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimit të korrupsionit në Forcat e Armatosura.
- Nënshkrimi i 19 marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të partneritetit mes vendeve, rritjes së sigurisë në rajon e më gjerë, duke implementuar në mënyrë cileor detyrimet që rrjedhin nga pjesëmarrja dhe anëtarësia në organizma të niveleve të larta ndërkombëtare si: NATO, EAPC, RACVIAC, Karta e Atlantikut, etj;
- Modernizimi me armatim të lehtë dhe municioni për FA-së, sistemet e mbështetjes për zjarr;
- Vendosja e kamerave Infra të Kuqe stacionare të integruara me sistemin SIVHD

Prioritetet për vitin 2018

- Rritja e operacionalitetit të FARSH në përmbushje të angazhimeve në kuadër të Aleancës. Më konkretisht:
 - Do të vijojë pjesëmarrja në operacionet e NATO-s duke rritur nivelin e angazhimit të FA, në operacionet e Aleancës në Afganistan dhe Kosovë apo në operacionet e BE-së në Bosnjë-Hercegovinë dhe Malin e Zi, si dhe pjesëmarrja në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndërmarrë, në Irak/Detin Egje, etj.
- Modernizimi i kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA dhe rritja e dinjitetit dhe mbështetjes për ushtarakët. Më konkretisht synohet:
 - Zhvillimi i kapaciteteve të FA në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit;
 - Vijimi i modernizimit dhe pajisjes së Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët në NATO;
 - Investime në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake;
 - Modernizimi i pajisjeve dhe sistemeve kompjuterike.
- Zhvillimi dhe mbajtja në gatishmëri të kapaciteteve të FARSH për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave, si dhe kapacitetet për përballimin e Emergjencave Civile, dhenien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-se dhe BE-se
- Rritja e përkujdesjes dhe mbështetjes për ushtarakët

TURIZMI DHE MJEDISI

Arritjet për vitin 2017

- TVSH për turizmin u ul në 6% për vitin 2017 duke krijuar lehtësira dhe rritur të ardhurat për operatorët e turizmit;
- Është rehabilituar plotësisht vend-depozitimi ekzistues i mbetjeve në Elbasan, si dhe është ndërtuar një landfill i ri modern bashkë me impiantin e parë për prodhim energjie elektrike dhe termike. Krahas sa më sipër, menaxhimi i mbetjeve përmes landfilleve është shtrirë dhe në qarqe të tjera:
- Vazhdon puna për ndërtimin e impiantit të dytë në vend për prodhim energjie nga mbetjet në Qarkun e Fierit;
- Ka filluar ndërtimi i landfillit në Maliq, për qarkun e Korçës dhe në Vlorë, fal mbështetjes së donatorëve;
- Ka përfunduar ndërtimi i Landfillit të Bajkajt kryesisht për zonën e Himarës dhe Sarandës;
- Është ndërtuar impianti i parë modern për grumbullimin e mbetjeve në grykëderdhjen e Shkumbinit dhe pritet të realizohet një projekt i tillë dhe në grykëderdhjen e Ishmit.
- U ngrit Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. Kjo agjenci ka për qëllim menaxhimin, mbrojtjen, zhvillimin, zgjerimin dhe funksionimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura në vendin tonë, që përbëjnë sot rreth 16.61% të territorit të Shqipërisë. Kjo agjenci krahas rritjes së shkallës së ruajtjes së zonave të mbrojtura, është në proces për të zgjeruar shtrirjen e tyre dhe në dy zona: (i) zona e mbrojtur detare e Porto Palermos dhe (ii) Parku Kombëtar i Alpeve (i cili përfshin zonën e Vermoshit, PK Theth, PK Lugina e Valbonës).
- Krijimi i Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, ka mundur pajisjen me leje mjedisore të 95% të subjekteve. Për të siguruar mbrojtjen kundër zjarreve në pyje dhe kullota, Inspektoriatit ka investuar duke vendosur mbi 240 kamera monitoruese (24 orë) dhe 24 kamera termike në mbarë vendin, duke kontrolluar situatën në terren në kohë reale.
- Është përmirësuar cilësia e ajrit në mjedisin urban duke ju afruar standardeve të Bashkimit Europian;
- Është ulur niveli i zhurmave nga 3 herë mbi mestaren urbane, në 2 herë me mesataren e ndotjes së zhurmave në nivel evropian.

Prioritetet për vitin 2018

Turizmi

- Promovimi i investimeve në zonat me prioritet zhvillimin e turizmit, duke bashkëpunuar me institucionet e tjera publike të nxitjes së investimeve në vend;
- Përmirësimi i infrastruktures turistike në zonen bregdetare me sinjalistike dhe rivitalizimi i Via Egnatias;

- Zhvillimin e destinacioneve turistike dhe burimeve per të ofruar produkte konkurruese në katër destinacione për turizmin e natyrës, 6 për turizmin kulturor dhe 4 destinacione për turizmin e bregdetit;
- Promovimi i agroturizmit duke përfshirë zonat rurale në zhvillimin e turizmit;
- Përmirësimi i identitetit shqiptar të turizmit në rajon e më gjerë nëpërmjet një strategjie të re marketingu për turizmin, duke synuar rritjen e numrit total të turistëve 10% krahasuar me vitin 2017;
- Vendosja e infopoint të ndryshëm për marrjen e informacionit nga turistët;

Mbrojtja e Mjedisit

- Përmirësimi i Cilësisë së Ajrit të Mjedisit Urban;
- Monitorimi i Cilësisë së Ujrave;
- Hartimi dhe përmirësimi i legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës në kuadër të përafrimit ligjor të Bashkimit Europian;
- Edukimi i brezave të rinj për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes;
- Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe administrimit të pyjeve;
- Nxitja e partneritetit publik-privat;
- Integrimi i ndryshimeve klimatike në sektorët e energjisë, ujrave, bujqësisë, zhvillimit urban dhe infrastrukturës;
- Mbrojtja dhe përmirësimi i menaxhimit të Zonave të Mbrojtura;

Administrimi i Pyjeve

- Hartimi i Inventarit Kombëtar të Pyjeve;
- Regjistri Unik Kadastral Kombëtar;
- Pyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara nëpërmjet riciklimit në destinacion të të ardhurave nga fondi pyjor, dhe detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor;
- Zbatimi i skemës së granteve konkurruese;
- Hartimi i metodologjisë dhe implementimi i saj për sekuestrimin e karbonit;
- Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit dhe eliminimi i gjuetisë së paligjshme.

KULTURA

Arritjet për vitin 2017

Arti dhe Kultura

- Përfundon ndërtimi i Qendrës “Skena e Reme një vlerë projekti prej 465,4 milion lekë, e cila do të ketë dy salla për shfaqje me kapacitet respektivisht për 400 persona dhe 250 persona. Kjo godinë do të krijojë kushte shumë të mira për aktorët, për publikun dhe do të jetë e pajisur me mjedise multifunktionale artistike të mbyllura dhe të hapura.

- Përfundon rikonstruksioni i Teatrit A.Z.Cajupi Korçë ku vlera e projektit ka qënë 119 milion leke (50% MK dhe 50% Bashkia Korçë). Ndërhyrja në këtë institucion të kulturës nxjerr në pah vlerat e nje qyteti që krijoi historinë e Teatrit Shqiptar;
- Përfundon rikonstruksioni i Teatrit Migjeni në Shkodër me vlerë projekti 58 milion leke fond i cili u mbështet totalisht nga ana e MK;
- Përfundon investimi ne Muzeun e Gjethit me një vlerë prej 48.5 milion lekë, muze që ka shtuar vizitueshmërine gjatë këtyre muajve, si dhe është nje aset i vlefshëm për qytetin e Tiranës si dhe një stacion i rëndësishëm për projektin “Rrugët e Kujtesës”;
- Dixhitalizimi i pasurive kulturore kombëtare në qendrat e regjistrimit fizik dhe online me një fond ne vlerën 40.5 milion lekë përfundoi gjatë këtij viti. Ky proces krijon kushte të inventarizimit digjital të të gjitha pasurive kulturore të vendit;
- Përfundon ndërtimi i shtëpisë së flamurit në Korçë me një vlerë prej 25.1 milion leke, godinë e cila u ndërtua nga e para pas shkatërimit të pësuar gjatë viteve 2012-2013;
- Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2017, nisi rikonstruksioni i godinës së ish-Lidhjes Shkrimtarëve e cila u krye në një kohe rekord për t’u përshtatur në godinë për organet e “Vetting-ut”. Vlera e këtij rikonstruksioni është 192,7 milion leke;
- Ministria e Kulturës për vitin 2017, ka mbështetur 128 projekte në art, kulturë dhe trashëgimi kulturore, të realizuara këto nga subjekte, organizata, shoqata kulturore dhe individë që shprehin ide novatore, garantojnë cilësi profesionalizëm në realizim, qëndrueshmëri dhe vazhdimësi, apo mundësi për rritjen profesionale të artistit;
- Janë mbështetur 5 botime të autorëve të rinj; 14 përkthime në gjuhën shqipe; 5 përkthime nga gjuha shqipe.
- Është krijuar fondi për rijetëzimin e Bibliotekave Publike, me të cilin janë mbështetur me 500 libra disa biblioteka publike;
- Për programin Edukimi përmes Kulturës në zbatim te fushatës Kombëtare të Leximit “Takohemi për një libër” 2017:
 - 20 bashki të vendit jane perfshire ne kete projekt nepermjet ngritjes se bibliotekave publike;
 - rrjeti kombëtar i klubeve të leximit ngritur nga MK: 15 qendra në të gjithë vendin;
 - 17 projekte për librin dhe leximin.
- Për promovimin e letrave shqipe jashtë vendit, është siguruar pjesëmarrja në dy aktivitete ndërkombëtare: Panairi i Lajpcigut dhe Panairi i Milanos;
- Është miratuar kuadri ligjor në zbatim të ligjit 35/2016 për të dhe u krijua sporteli unik;

Trashëgimia Kulturore

- Është kryer restaurimi i dhe rehabilitimi i Manastiri i Shën Mërisë dhe peizazhit kulturor i Parkut Arkeologjik të Apolonisë - Vlera 780.000 euro e financuar nga Delegacioni Evropian;
- Janë restauruar 6 blloqe objektivësh në Pazarin Gjirokastër. Vlera 221 823 550 lekë, financim i AADF;
- Mirëmbajtje monumenteve të kultit me vlerë 12,3 milionë lekë nga buxheti i MK;

- Është kryer ndërhyrje restauruese në *Kishën Fjetja e Shën Mërisë* në Labovën e Kryqit, Gjirokastër”, në fshatin Labovë, Gjirokastër;
- Është Restauruar objekti “*Xhamia e Gjin Aleksit*”, në Rusan Delvinë;
- Është restauruar Kisha “*Fjetja e Shën Mërisë*”, në fshatin Sopik, Gjirokastër;
- Është ndërhyrë në mënyrë emergjente për stabilizimin e godinave të Burgut të Spaçit”;
- Në drejtim të ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimise jomateriale dhe diversitetit kulturor do të realizohen 29 aktivitete (deri tani realizuar 25) nga projekte me thirrje në fushën e trashëgimise jomateriale që Ministria e Kulturës shpall çdo muaj dhjetor;
- Janë realizuar 11 aktivitete në drejtim të promovimit të trashëgimise jomateriale;
- Janë realizuar 2 aktivitete kombëtare të trashëgimise jomateriale si dhe një 4 aktivitete të tjera që kanë të bëjnë me kujtimin e figurave të trashëgimise jomateriale dhe programit “Edukimi përmes Kulturës”. Në muajin nëntor 2017 QKVF do të organizojë me rastin e 105 vjetori të Pavarësisë Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar të Iso-Polifonie në qytetin e Vlores;
- Deri tani në 36 aktivitete të trashëgimise jomateriale të zhvilluara të TJ kanë marrë pjesë 5800 artiste nga të cilët rreth 1000 femijë dhe të rinj dhe janë ndjekur nga rreth 20.000 spektatore vendas dhe të huaj. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë 4 grupe popullore folklorike nga Kosova me 100 artiste pjesëmarrës edhe në kuadrin e Bashkëpunimit midis dy vendeve;
- Në nismën “Miku i Monumentit” kanë marrë pjesë në rang vendi 13.300 nxënës dhe 171 shkolla;
- Në programin “Edukimi përmes kulturës” janë zhvilluar deri tani 15 projekte të dedikuara për këtë program me pjesëmarrjen e 1800 fëmijëve kryesisht në fushat e mësimin të vllës popullore dhe këngës polifonike;

Prioritetet për vitin 2018

Arti dhe Kultura

- Rikonstruksion dhe rikonceptim të funksionit të Bibliotekës Kombëtare;
- Ngritja e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit (QKLL), e cila do të nxisë kulturën e leximit dhe do të mbështesë krijuesit, do të promovojë vlerat më të mira të letrave shqipe dhe të përkthimit të librit të huaj, duke rentabilizuar fondet publike kushtuar librit dhe duke gjeneruar financime nga burime të treta;
- Rishikimi i ligjit për librin;

Trashëgimia Kulturore

- Do të synohet rritja me 30% e pjesëmarrjes së femijëve dhe të rinjve në programin “Edukimi përmes kulturës”, në krahasim me të dhënat e vitit 2017. Ky program gjatë vitit 2018 do të kthehet me një edukim masiv me art, kulturë e trashëgimi kulturore duke përfshirë që nga ndërhyrjen në kurrikulat shkollore e deri tek përfshirja e të gjitha institucioneve artistike dhe kulturore me programe të detajuara edukative;
- Në nismën “Miku i Monumenteve”, gjatë vitit 2018 do të synohet një rritje me 20 % e pjesëmarrjes së nxënësve në këto nisme duke rritur bashkëpunimin e DRKK me DAR;

- Në aktivitete ne drejtim te ruajtjes, mbrojtjes dhe promovimit te Trashegimise Joamteriale dhe Diversitetit Kulturo, gjate vitit 2018, do të synohet një rritje prej 5 % te financimit te aktiviteteve te kesaj fushe, sidomos atyre qe do te zhvillohet prane objekteve te trashegimise kulturore si Kala, Qendra Historike, Parqe Arkeologjike, etj. per promovimin edhe te vlerave te ketyre objekteve tek spektatoret vendas dhe te huaj, ne kuarin edhe te turizmit kulturore;
- Në kuadrin e Vitit Mbarekombetar të Gj.K. Skënderbeut do të organizohen disa aktivitete te trashegimise jomateriale sipas nje Kalendarit qe do te pergatitet ku deri tani jane propozura 10 aktivitete ne fushen e trashegimise jomateriale.
- Gjatë vitit 2018 në kuader te vitit kulturor Austri-Shqiperi do te realizohen disa aktivitete te trashegimise jomateriale sipas Kalendarit te perbashket qe do te miratohet ku jane propozuar 2 aktivitete ne fushen e trashegimise jo-materiale.
- Në kuader te Vitit European te Trashegimise Kulturore do te zhvillohen nje sere aktivitete ne fushen e trashegimise jomateriale sipas nje Kalendarit te detajuar jane propozuar 5 aktivitete.
- Do të hartohet Kalendarit i aktiviteteve trashegimise jomateriale ne kuadrin e turizmit kulturor, ku do te perfshihen te gjitha qytetet bregdetare jane propozuar 6 aktivitete te trashegimise jametriaie;
- Restaurimi dhe mirëmbajtja e 135 monumenteve të kulturës me vlerë investimi 21 % më shumë krahasuar me 2017;
- Restaurimi i monumenteve të Kultit, Kisha e Shën Mërisë së Leshnicë, Kisha e Shën Kollit Mesopotam;
- Restaurimi i pikturës murale të Onufrit në kishat e Shelcanit dhe Valshit, Elbasan;
- Restaurimi i Qendrës Historike të Vuno, Dhërmi , Vlorë;
- Do të miratohet ligji i ri për trashëgiminë kulturore;
- Do të zhvillohet Bialja e arkitekturës 2018;
- Hartimi i platformës së re muzeore, projekt idesë dhe projekt zbatimit për Muzeun Historik Kombëtar;
- Përmirësimi i standardeve të cilësisë së shërbimeve të ofruara në muzetë kombëtar dhe parqet arkeologjike duke rritur numrin e vizitorëve me 30 % krahasuar me 2017.

DREJTËSIA

Arritjet për vitin 2017

- Ndërtimi dhe rritja e kapaciteteve të disa burgjeve në vend, p.sh Burgut 313 me standardet e BE-së. Ky është një projekt kompleks i cili do të ulë mbipopullimin dhe do të sjellë përmirësim të ndjeshëm të kushteve të jetesës dhe sigurisë nëpër burgje;
- Kryerja e 42 inspektimesh në kuadër të transparencës dhe forcimit të rolit të drejtësisë dhe rritjes së besueshmërisë së institucioneve të drejtësisë;
- Rritja e numrit të rasteve të asistencës juridike për institucionet shtetërore nëpërmjet këshillit dhe përfaqësimit në Gjykatat Kombëtare dhe Ndërkombëtare. 12,040 raste;
- Ndërtimi i databazës për bashkëpunim ndërgjyqësor me jashtë (sistem të dhënash);

- Forcimi i sistemit të të drejtave të pronësisë dhe mbrojtjes së tyre, mbikëqyrja dhe monitorimi i veprimtarisë së ATP;
- Në kuadër të transparencës, publikimi në kohë reale dhe përmirësimi i aksesit nga qytetarët për dokumentat dhe aktet ligjore e nënligjore, që janë tagër i publikimit nga Ministria e Drejtësisë dhe institucionet e saj të varësisë.
- Realizimi i anëtarësimit në Shoqatën Evropiane të Burgjeve;
- Informatizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sistem informatizimi i kartave të të dënuarve;
- Trajtimi human i të dënuarve dhe të paraburgosurve, nëpërmjet mbajtjes së normës ushqimore për të dënuarit e papunësuar dhe të miturit në 2615 kalori;
- Realizimi i 34 birësimeve brenda dhe jashtë vendit;
- Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës elektronike të gjykatave, në funksion të rritjes së cilësisë dhe transparencës së procesit gjyqësor shërbimit ndaj publikut, me plotësimin e 93% të gjykatave, me 100% të pajisjeve;

Prioritetet për vitin 2018

- Përmirësimi i kushteve të jetesës të të dënuarve në institucionet e vuajtjes së dënimit për arritjen e standardeve evropiane në trajtimin e këtyre kategorive.
- Rritja e aksesit të publikut në legjislacionin e konsoliduar, përmes përmirësimit të procesit të publikimit dhe njohjes së legjislacionit Shqiptar dhe Njoftimeve Zyrtare Shqiptare.
- Përmirësimi i cilësisë së legjislacionit, përmes dhënies së mendimit të specializuar për përmbajtjen e projekteve të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave.
- Realizimi dhe bashkërendimi i veprimtarive në fushën e drejtësisë për të miturit, për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga ana e tyre, si dhe për ushtrimin e shërbimeve ndaj të miturve, nga strukturat përkatëse të sistemit të drejtësisë.
- Mbështetja e veprimtarive shkencore në fushën e drejtësisë dhe përhapjen e edukatës juridike.
- Realizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale dhe civile dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ku shteti shqiptar është palë, realizimin e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet kompetente të shteteve të tjera, si dhe me organizma ndërkombëtarë.
- Ndërmarrja e masave me qëllim konsolidimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror në shërbim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të tij;
- Forcimi dhe përmirësimi i kontrollit dhe monitorimit të ekzekutimit të titujve ekzekutive, përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.
- Rritja e efikasitetit të zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve, përmes rritjes së kapaciteteve institucionale dhe përmirësimit të kuadrit ligjor.
- Trajtimi i të miturve në sistemin e vuajtjes së dënimit, në përputhje me legjislacionin evropian, si dhe në respektim të politikave të BE-së për trajtimin e të miturve në sistemin e vuajtjes së dënimit. Rritja e kapaciteteve të stafeve të IEVP-ve mbi instrumentet e punës për përgatitjen për ri-integrim

të fëmijëve në konflikt me ligjin. Hartim i kurikulave për trajtimin e të miturve në shkolla riedukimi.

- Mbështetja e zbatimit të Reformës në Drejtësi, e cila prek drejtpërdrejt sistemin gjyqësor dhe kompetencat e Ministrisë së Drejtësisë në funksionimin dhe organizimin e këtij sistemi.

5. REFORMAT NË BUXHETIN 2018

5.1 REFORMA NË SEKTORIN E UJIT

Synimet kryesore të reformës janë:

- Mirëadministrimi i burimeve ujore;
- Rritja e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm në vlerën 2-3%;
- Rritja e numrit të orëve të shërbimit;
- Reduktimi i humbjeve fizike në rrjet;
- Rikuperimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes;
- Qendrueshmëria financiare e ndërmarrjeve;
- Ekzistenca e tarifave të drejta kundrejt shërbimit.

Arritjet konkrete për vitin 2017

- Plani i investimeve në këtë sektor për vitin 2017 është 3.533.000.000 lekë, ndërsa me financim të huaj është 4.987.000.000 lekë;

Ujësjetës:

- Në territorin urban mbulohet me shërbim ujësjetës në masën 90%;
- Në territorin rural mbulohet me shërbim ujësjetës në masën 62.3%;
- Në gjithë territorin (urban+rural) mbulohet me shërbim ujësjetës në masën 79.4%;

Kanalizime:

- Niveli i shërbimit vetëm K.U.Z;
- Në territorin urban mbulohet me shërbim KUZ në masën 70.2%;
- Në territorin rural mbulohet me shërbim KUZ në masën 6.6%;
- Në gjithë territorin (urban+rural) mbulohet me shërbim KUZ në masën 50.6%;
- Niveli i shërbimit të Trajtimit të Ujrave të Ndotura në masën 13%;
- Furnizimi me ujë në rang republike (mesatarisht) është me 12.04 orë/ditë;

- Norma e arkëtimit (mesatarisht) është në masën 89.51%.

Prioritetet për vitin 2018

Si rezultat i investimeve dhe mirëmenaxhimit (aksionit për ujin), pritshmëritë deri në fund të vitit 2018 janë:

- Shtimi i 200 mijë lidhjeve/kontratave për ujin e pijshëm;
- Shtimi i 100 mijë lidhjeve në sistemin e kanalizimeve;
- Zgjatja e orarit të furnizimit me ujë nga 12 orë/ditë – 14 orë/ditë;
- Norma e arkëtimit 95% nga 91%;
- Raporti i mbulimit të Kostove të Operimit (KTO) me të ardhurat 90% nga 81.2% .

5.2 REFORMA NË DREJTËSI

Reforma në Drejtësi ka synim të përgjithshëm krijimin e një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, i cili të gëzojë besimin e publikut, të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit dhe të mundësojë integrimin e tij në familjen evropiane.

Reforma në drejtësi është një ndër prioritetet kyçe të Qeverisë Shqiptare dhe një ndër çështjet më të përshtatshme që duhen trajtuar në kudër të pesë përparësive kyçe për hapjen e negociatave të anëtarësimit me BE-në.

Këto sfida reflektohen gjithashtu në përqasjen e qeverisë ndaj çështjeve përkatëse për trajtimin e pesë përparësive kyçe për hapjen e procesit të anëtarësimit me BE-në dhe lidhen me reformën e gjyqësorit dhe luftën kundër korrupsionit.

Synimet e Reformës në Drejtësi në periudhën afatmesme/afatgjatë

- Të forcojë llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe të luftojë korrupsionin brenda sistemit të drejtësisë;
- Të demonstrojë progres të mëtjshëm me synim krijimin e precedentëve solidë të hetimeve, ndjekjes penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në të gjitha nivelet;
- Të përmirësojë mekanizmat institucionale për të nxitur përpjekjet për ta sjellë legjislacionin ekzistues për drejtësinë për të mitur në përputhje me standarde ndërkombëtare; të bëjë progres të mëtjshëm me zbatimin e strategjisë 2012-2020 për të drejtat e pronësisë dhe proceset e regjistrimit, kthimit dhe kompensimit të pronave.

Objektiva strategjike të nivelit të lartë:

- **Objektivi 1:** Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.

- **Objektivi 2:** Konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit, si dhe specializimi i magistratëve dhe personelit të gjykatave.
- **Objektivi 3:** Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen e tij në përputhje me standardet evropiane.
- **Objektivi 4:** Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor penal dhe masave antikorrupsion përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.
- **Objektivi 5:** Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar sisteme moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar.
- **Objektivi 6:** Shtimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin ndëshkimor.
- **Objektivi 7:** Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj vartëse.
- **Objektivi 8:** Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe vendosja e një kuadri ligjor për arbitrazhin.

Arritjet për vitin 2017

Gjatë vitit 2017, Parlamenti i Shqipërisë ka miratuar një sërë ligjesh si frut i bashkëpunimit të aktorëve për ndryshimet ligjore si pasojë e reformimit të Sistemit të Drejtësisë. Në vijim, parashtrahet lista e ligjeve të miratuara:

- Ligji nr. 7905, datë 21/03/1995 për “ Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë **(miratuar 30 Mars 2017; Hyrja në fuqi 1 gusht 2017)**
- Ligji nr. 7491, datë 29/04/1991 “Kodi i procedurës civile i Republikës së Shqipërisë, **(miratuar më 30 Mars 2017; Hyrja në fuqi 5 Nëntor 2017)**
- Kodi i drejtësisë për të miturit i Republikës së Shqipërisë **(miratuar më 30 Mars 2017; hyn në fuqi më 1 Janar 2018)**
- Ligji n. 7895, datë 27/01/1995 “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë” **(miratuar më 30 Mars 2017; hyn në fuqi 20 Maj 2017)**
- Ligji nr. 9049, datë 10/4/2003 “Ligji për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” **(miratuar më 6 prill; hyn në fuqi më 6 Maj 2017)**
- Ligji nr. 9157 datë 4.12.2003 “Për përgjimin e komunikimeve elektronike”, **(miratuar më 27 prill 2017; hyn në fuqi 6 qershor 2017)**
- Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative në Republikën e Shqipërisë” **(miratuar më 30 Mars 2017; hyn në fuqi më 6 Maj 2017)**
- Ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil”, **(miratuar më 30 Mars 2017; hyri në fuqi më 6 Maj 2017)**
- Ligji nr. 8678, datë 14/05/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, **(miratuar më 30 Mars 2017; hyri në fuqi më 6 Maj 2017)**

- Ligji nr. 10192/2014 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (ligji Antimafia) (**miratuar më 27 prill 2017; hyri në fuqi më 22 qershor 2017**)
- Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009 Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar (**miratuar më 30 Mars 2017; hyri në fuqi më 1 gusht 2017**)
- Ligji nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar” (**miratuar më 6 prill 2017; hyri në fuqi më 6 Maj 2017**)
- Ligji Nr. 157 datë 10.10.2013 “Për Masat kundër Financimit të Terrorizmit” (**miratuar më 6 prill 2017; hyri në fuqi më 6 Maj 2017**)

Po në vijim gjatë viti 2017, strukturat përkatëse (*Kuvendi/Sekretari Përgjithshëm i Kuvendit etj*) kanë zgjedhur të gjithë organet e rivlerësimit kalimtar (në vijim të ndryshimeve Kushtetuese) :

- Anëtarë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimeve
- Komisionerët Publikë
- Anëtarët e Komisionit të Posaçëm të Apelimit

Gjatë vitit 2017, Qeveria Shqiptare ka realizuar rikonstruktimin e ndërtesës së ish “Lidhjes së Shkrimtareve”, godine e cila do të shërbejë për akomodimin e stafit sipas strukturës përkatëse të dy Komisioneve Kushtetues për procesin e Rivlerësimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë (Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisioni Posaçëm i Apelimit). Po gjatë këtij viti, ka filluar procesi i rekrutimit të stafit.

Gjatë viti 2017, Kuvendi është akoma duke përzgjedhur anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Për më tej, Kuvendi, për shkak të mungesës së numrit minimal të kandidaturave, ka rishpallur thirrjen.

Objektivat që synohen të arrihen në 2018:

- Forcimi i statusit të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjitha niveleve, përfshirë ndihmësmagjistratët /këshilltarët ligjorë në përputhje me standardet evropiane që sigurojnë emërim dhe zhvillim të karrierës që janë të bazuara në meritë.
- Krijimi i një inspektorati të vetëm të pavarur përgjegjës për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për të zhvilluar shërbime të tjera inspektimi në gjykata dhe prokurori në përputhje me standardet evropiane.
- Rritja e funksionimit të KLGJ dhe zgjerimi i objektit të kompetencave të tij, duke i bërë gjykatat më të larta pjesë të objektit të saj dhe duke zgjeruar funksionet, p.sh. në lidhje me IT, buxhetin gjyqësor, administrimin e gjykatave, raportimin dhe marrëdhëniet me publikun në bazë të standardeve Evropiane dhe ndërkombëtare.
- Krijimi i KLP dhe ngritja e kapaciteteve në bazë të standardeve moderne evropiane dhe zbatimi i ndryshimeve të fundit ligjore.
- Krijimi i një strukture të specializuar anti-korrupsion në nivel kombëtar, të përbërë nga policia, prokuroria dhe gjykata.
- Krijimi i një platforme të IT për funksionimin e sistemeve elektronike të gjyqësorit.
- Vendorsja e sistemit të menaxhimit të çështjeve të gjykatave (ICMIS), në efikasitet të plotë.

- Krijimi i sistemit të menaxhimit të çështjeve për procesimin e çështjeve MLA me Ministria e Drejtësisë (në vazhdim)./ Përfshirja e Prokurorisë së Përgjithshme në sistemin e mësipërm të menaxhimit të çështjeve. Kosto përfshin 80,000 euro të financuara nga projekti LURIS.
- Përmirësimi i ndërlidhjeve ndërmjet ALBIS dhe sistemeve të tjera elektronike të gjyqësorit.
- Ndërtimi i një ndërtese të re të përshtatshme për trajtimin e të ndaluarve me probleme të shëndetit mendor.
- Thellimi dhe zgjerimi i objektit të aktiviteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me:
 - Trajnimin fillestar të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë (specializim, profesionalizëm më i thellë, dhe më shumë profesionalizëm dhe etikë).
 - Trajnimi i vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët, përfshirë ligjin e BE-së.
- Ndërtimi i ambienteve të reja për Shkollën e Magjistraturës, përfshirë mobilimin.
- Rritja e kapaciteteve të Departamentit të Kodifikimit në MD duke komanduar gjyqtarë dhe prokurorë në departamentin e kodifikimit dhe duke shtuar ekspertizë të jashtme për projekt ligje të ndryshme.
- Projektimi dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit, aktiviteteve operacionale dhe të kontrollit dhe funksionimi financiar i MD dhe institucioneve të tjera (KLGJ, KLP, Inspektoriati i ri, Këshilli i Emërimeve) për të mundësuar që ato të menaxhojnë procesin e reformës.

5.3 REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Strategjia Ndërsëktoriale e Reformës së Administratës Publike 2015-2020 fokusohet mbi zhvillimin dhe zbatimin e procedurave transparente dhe të paanshme të rekrutimit, menaxhimit e burimeve njerëzore, zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, trajnimin e vazhdueshëm, promovimin e etikës në administratën publike, si dhe garantimin e qeverisjes elektronike. Zbatimi i kësaj strategjie, ka sjellë nevojën për reformimin e një sërë fushash të lidhura me administratën publike:

- *Sistemit të politikbërjes dhe cilësisë së legjislacionit;*
- *Mënyrës së organizimit të administratës publike;*
- *Shërbimit Civil dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;*
- *Procedurave administrative dhe mbikëqyrjes.*

Arritjet për vitin 2017

- Riorganizimi strukturor i aparateve të ministrive të linjës, si rezultat i formimit të kabinetit të ri qeveritar dhe krijimit të 11 ministrive të linjës dhe 2 ministrave të shtetit. Riorganizimi strukturor i aparateve të ministrive të linjës u mbështet në një qasje të re dhe sistematike, që fokusohet jo thjesht në elementë të caktuar të sistemit të qeverisjes apo në bashkime dhe ndryshime mekanike, por në një qasje funksionale që merr në konsideratë ndërveprimin e elementëve me njëri-tjetrin dhe ndërveprimin e sistemit me realitetin shqiptar e nevojën e qytetarëve të saj;
- Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) përmban aktualisht 36400 pozicione pune dhe dosjet personale për mbi 17800 punonjës. Në një hark kohor një vjeçar janë

trajnuar mbi 300 punonjës në njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, duke përfshirë këtu institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore;

- Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së përshkrimeve të punës dhe standartizimit të tyre, janë përgatitur përshkrime pune të unifikuara për ato grupe pozicionesh (funksionet horizontale) që janë të njëjta në të gjithë institucionet e administratës shtetërore (8 grupe të ndryshme);
- Procesi i rekrutimit në shërbimin civil është përmirësuar në funksion të sigurimit dhe përdorimit të mekanizmave që garantojnë transparencë në çdo fazë të këtij procesi. Gjenerimi automatik i tezave me shkrim, garantimi i anonimatit, vlerësimi i automatizuar i tezave që përmbajnë pyetje me alternativa, rregjistrimi audio i intervistës me gojë, janë të gjithë elementë që synojnë shmangien e vlerësimit subjektiv të kandidatëve dhe transparencë në procesin e vlerësimit të tyre. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2017, janë zhvilluar disa trajnime, ëorkshops, seminare me asistencën e projekteve të financuara nga BE. Deri më tani, sipas të dhënave për vitin 2017 (referuar periudhës 5 mujore Shkurt-Qershor 2017), janë plotësuar 427 vende vakante në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil, ku ndër to 160 pozicione janë plotësuar me kandidatë brenda shërbimit civil, pra lëvizje paralele ose ngritje në detyrë. Pra, në total përqindja e plotësimit të vakancave në raport me shpalljet në faqen zyrtare të DAP është 68.29%;
- Zhvillimi i karrierës është i përcaktuar qartë në legjislacion ndërkohë që zbatohet edhe në praktikë. Trendi i mobilitetit brenda shërbimit civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë është rritur, sic tregohet qartë në raportet vjetore të DAP. Gjatë vitit 2015 ka patur 75 lëvizje paralele dhe 101 ngritje në detyrë, ndërsa gjatë vitit 2016 ka patur 146 lëvizje paralele dhe 188 ngritje në detyrë. Për vitin 2017, përgjatë periudhës 5 mujore Shkurt-Qershor, ka patur 95 lëvizje paralele dhe 65 ngritje në detyrë;
- Në shifra konkrete, kemi një ulje të vazhdueshme të numrit të largimeve nga shërbimi civil për shkak të masave disiplinore; kështu në 2015 ka patur 97 vendime me masë disiplinore “largim nga shërbimin civil, 55 të tilla përgjatë vitit 2016 dhe 20 masa disiplinore “largim nga shërbimi civil” deri në gjysmën e parë të vitit 2017. Kjo vjen edhe si pasojë e njohjes së legjislacionit të shërbimit civil dhe punës së vazhdueshme të përfaqësuesve të DAP në këto komisione, për ndërgjegjësimin e anëtarëve të komisioneve disiplinore për respektimin e të gjithë elementëve të procedurës formale të këtij procesi, si dhe të trajnimeve të zhvilluara nga DAP dhe ASPA në këtë drejtim;

Në kuadër të zbatimit të Ligjit të ri për Shërbimin Civil janë arritur këto rezultate:

- Metodologjia për zhvillimin e testeve me shkrim bazuar në kompetencat e kërkuara;
- Testet e integritetit për rekrutimin në shërbimin civil;
- Rishikimi i përshkrimeve të punës; u propozuan 15 grupime (familje), u përgatitën 28 përshkrime të përgjithshme të punës;
- Seti me indikatorët për DAP dhe Ligjin për Shërbimin Civil;
- Kuadri raportues për performancën e DAP-it;
- Kompetencat bazë për Menaxherët e Nivelit të Lartë;
- Manuali për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Udhëzues praktik për nëpunësit e rinj civilë;
- Plan komunikimi për Reformën në Administratën Publike;
- Udhëzime për zbatimin e parimeve kryesore dhe standardeve për nëpunësit publikë;

- Fushatë informuese për procesin e rekrutimit në tërësi (përfshirë hartimin dhe shpërndarjen e materialeve orientuese- *procesi i aplikimit; vendet vakante dhe kriteret, etj.*)
- Fushatë informuese për progresin e reformës në administratën publike;

Në kuadër të zbatimit të Kodit të Procedurave Administrative (KPA) janë arritur këto rezultate:

- 14 ligje të vlerësuara përsa i përket përpunueshmërisë së tyre me KPA-në e ri dhe ofrimi i rekomandimeve;
- Metodologjia për vlerësimin e ligjeve specifike përkundrejt pajtueshmërisë së tyre me KPA-në e ri;
- Plani i zbatimit për Agjendën Dixhitale për Shqipërinë (kuadri institucional, ligjor, financiar);
- Metodologjia për të përcaktuar standardet e cilësisë për ofrimin e shërbimeve publike;
- 4 materiale orientuese lidhur me dispozitat e Kodit të Ri të Procedurave Administrative, duke patur si synim publikun e gjerë;
- Udhëzime për përdorimin e delegimit të pushtetit vendimmarrës;
- Modele dhe forma standarde për përdorim nga qytetarët dhe administrata publike;
- Prezantimi dhe zhvillimi i disa çështjeve ndërkombëtare ligjore për zbatimin e disa neneve specifike.

Në kuadër të forcimit të Kapaciteteve për Menaxhimin e Shërbimit Civil (ASPA) janë arritur këto rezultate:

- Rishikimi funksional i ASPA-s;
- Manuali i procedurës për ASPA-n;
- Plani i veprimit për trajnimin e stafit të ASPA-s si dhe trajnimi i tyre;
- Katalogu i përgjithshëm i trajnimeve të ASPA;
- Katalogu i për modulin e trajnimit për MBNJ;
- Katalogu për modulin e trajnimit për KPA;
- Katalogu i trajnimit për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues (TND).

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike ka vijuar me zhvillimin e trajnimeve të nëpunësve civil në fusha të ndryshme, duke përfshirë Reformën në Administratën Publike. Gjithashtu ASPA ka vazhduar në përmbushjen e objektivave të saj në organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve të detyrueshme të nëpunësve civil në njësitë e qeverisjes vendore. Me mbështetjen e Këshillit të Evropës, ASPA ka hartuar planin e trajnimeve për njësitë e qeverisjes vendore duke u bazuar në Vlerësimin e Nevojave për Trajnim. Gjatë vitit 2017, janë zhvilluar 134 kurse trajnimi për 524 ditë trajnimi, ku janë trajnuar në total 2760 nëpunës civilë.

Gjithashtu, janë përgatitur kurrikulat për Programin e Trajnimit të Nivelit të Lartë të Drejtues dhe gjatë vitit 2017 janë pilotuar dy nga pesë kurrikulat e trajnimit. Ndërkohë, e-library është funksionale me mbi 30 kurrikula.

Synimet për vitin 2018

Përcaktimi i Planit të ri të Veprimit të SNRAP dhe aktivitetëve për periudhën 2018-2020 është një ndër synimet e tre-mujorit të parë të vitit 2018. Nëpërmjet vlerësimit afat-mesëm të Strategjisë (proces ky i kryer gjatë vitit 2016) do të shërbejë si një bazë për të bërë një vlerësim më të saktë të nevojave financiare për zbatimin e strategjisë për periudhën e ardhshme 3-vjecare, duke orientuar kështu nevojat financiare në kuadër të Programit Buxhetor Afatmesëm. Gjithashtu, synohet vlerësimi i rëndësisë së objektivave të strategjisë dhe të “*gjendjes aktuale*” me qëllim që Plani i Ri i Veprimit të reflektojë ndryshime të mundshme të aktivitetëve të cilat kërkojnë vemendje të veçantë dhe që nuk janë mbuluar siç duhet në strategji. Ky vlerësim ka një rëndësi të veçantë edhe në kuadër të rishikimit të atyre aktivitetëve të cilat kanë shënuar vonesa në implementimin apo që nuk kanë një produkt final të qartë. Ndër të tjera, Plani i Ri i Veprimit duhet të marrë në konsideratë prioritetet e reja të qeverisë dhe të hartohet edhe në përputhje me to. Vemendje e veçantë do t’i kushtohet afateve kohore dhe burimeve të financimit për realizimin e masave.

Ndjekja e procesit të reformimit dhe ristrukturimit të institucioneve të varësisë, në kuadër të projektit për bashkëqeverisjen me qytetarët. Ky proces parashikon rishikimin e funksioneve të të gjithë institucioneve të varësisë, përfshirë inspektoratet dhe agjencitë, me qëllim riorganizimin e tyre për të rritur frytshmërinë dhe efikasitetin në punë. Gjithashtu ky proces synon ndërtimin e institucioneve qendrore të administratës shtetërore, me qëllim:

- Pozicionimin e duhur të institucioneve pranë sistemeve të reja ministrore, bazuar mbi funksionet e tyre dhe fushat e përgjegjësisë të ministrive të reja;
- Rajonalizimin dhe decentralizmin: Organizimi mbi bazë rajonesh (rajonalizimi) i institucioneve monitoruese. Këtu bëhet fjalë për degët e ministrive në territor (psh. drejtoritë arsimore rajonale), pa përfshirë zyrat e shërbimit të cilat do të vazhdojnë të jenë të shpërndara në të gjithë territorin, etj.;
- Orientimin me në qendër qytetarin;
- Thjeshtimin e ndërveprimit me qytetarët dhe bizneset, duke organizuar ndarjen e punës brenda institucioneve, de-rregullimin dhe ristrukturimin;
- Shpërndarjen në nivel vendor të qendrave të ofrimit të shërbimeve me qëllim rritjen e aksesit ndaj shërbimeve.
- Forcimin e menaxhimit dhe ekzekutimit më tepër në nivel agjencie dhe fuqizimin me qasje në bazë të performancës.

Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së përshkrimeve të punës, duke tentuar një unifikim të përmbajtjes së tyre, për punë të ngjashme në institucione të ndryshme, duke përmirësuar dhe formuluar qartë misionin, qëllimin, objektivat, detyrat dhe kriteret e çdo pozicioni, njësie organizative të punës, në institucionet qendrore të administratës shtetërore, në kuadër edhe të reformës strukturore që po realizohet aktualisht. Për herë të parë do të synohet të hartohen krahas strukturës edhe Manuali Operacional i Përshkrimeve të Punës për çdo pozicion duke lidhur në mënyrë të integruar gjithë zinxhirin hierarkik nga Ministri deri tek specialisti më i fundit në strukturë. Ky Manual synon të integrojë jo vetëm punën në ministri por edhe marrëdhënien dhe ndërveprimin e saj me ministrinë e tjera dhe institucionin e Kryeministrit.

Përmirësimi i procesit të përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve që konkurojnë për t’u bërë pjesë e administratës shtetërore:

- rritja e kapaciteteve vlerësuese të anëtarëve të komiteteve të pranimit;

- përmirësimi i cilësisë së pyetjeve në testimet me shkrim, nëpërmjet zhvillimit dhe pasurimit të mëtejshëm të bankës së pyetjeve;
- përmirësimi i cilësisë së intervistës me gojë, nëpërmjet përfshirjes së pyetjeve që vlerësojnë aftësitë individuale të kandidatëve si dhe integritetin e tyre.

Forcimi i kapaciteteve të DAP dhe njësive të burimeve njerëzore në institucionet e administratës shtetërore, për të çuar përpara reformën në shërbimin civil, nëpërmjet trainimeve të vazhdueshme për kuptimin e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, ndërlihdjen dhe efektet e tyre. Fokus i veçantë do të kushtohet planifikimit të burimeve njerëzore në shërbimin civil.

Zbatimi i mekanizmave ligjorë për të testuar dhe verifikuar paraprakisht integritetin e kandidatëve për vende pune dhe në vijimësi integritetin e punonjësve, në administratën publike, nëpërmjet:

- (i) përdorimit të pyetjeve që vlerësojnë integritetin e kandidatëve, duke bërë pjesë të procesit të përzgjedhjes testimin e elementëve që lidhen me ndershmërinë dhe integritetin e individëve, të cilët punësohen në sektorin publik si parakusht për parandalimin e korrupsionit;
- (ii) verifikimit paraprak të të gjithë punonjësve që emërohen në pozicione të shërbimit civil, trupin diplomatik, si dhe në çdo nivel drejtues në administratën publike, bazuar në ligjin 138/2015.

Vlerësimi i performancës së nëpunësve civilë si dhe i kapaciteteve ekzistuese, nëpërmjet:

- përcaktimit të saktë të objektivave për periudhën e vlerësimit;
- përcaktimit të saktë të indikatorëve për matjen e realizimit të objektivave;
- trajnimit të zyrtarëve të ngarkuar me këtë proces, në lidhje me të gjithë hapat e procesit të vlerësimit.

Zbatimi i mëtejshëm i vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe rikthimi në detyrë i nëpunësve civilë gjyqfitues. Zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë i cili lidhet edhe me detyrimin për rikthim në punë të nëpunësve civilë gjyqfitues, mbetet ende një ndër çështjet që kërkon vëmendje të shtuar nga DAP dhe institucionet e administratës shtetërore. Kjo për faktin se zbatimi i këtyre vendimeve është një proces jo shterues, në këndvështrim të detyrimit ligjor që DAP-i ka si njësi përgjegjëse. Në këtë aspekt fokusi do të jetë në:

- (i) rritjen e cilësisë së administrimit të dokumentacionit të nevojshëm (dosjeve personale të nëpunësve të larguar), me qëllim zbatimin e saktë të detyrimeve ligjore që burojnë nga këto vendime;
- (ii) vlerësimin rast pas rasti të secilit vendim dhe detyrimeve që burojnë prej tij
- (iii) përmirësimin e mëtejshëm të sistemit online të raportimit të të dhënave gjyqësore, nga institucionet e administratës shtetërore.

Zhvillimi i mëtejshëm i metodave inovative për të përmirësuar dhe lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin mes institucioneve publike dhe qytetarëve, nëpërmjet:

- (i) transformimit të faqes zyrtare të DAP në një portal për të gjithë administratën publike, ku informacioni të jetë i thjeshtë për t'u aksesuar dhe i lehtë për t'u kuptuar nga të gjithë, qofshin këta qytetarë, nëpunës civilë apo kandidatë potencialë;
- (ii) forcimit të mekanizmave raportues online mes institucioneve, me qëllim përmirësimin e shkëmbimit të informacionit për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Zhvillimin e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SMIBNJ/HRMIS) duke e shtrirë në të gjithë institucionet e administratës shtetërore si dhe finalizimin e bashkërendimit të këtij sistemi me sistemin e thesarit.

Forcimi i vazhdueshëm dhe fuqizimi i ASPA si institucioni qendror i trajnimit dhe kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve në fushën e administratës publike. Do të punohet në drejtim të -rritjes së cilësisë së trainimeve të ofruara, zhvillimit të metodologjisë së trajnimit në kombinimin e përjasjes klasike në klasë dhe në vendin e punës, me përjasjen inovative nëpërmjet platformave të e-learning dhe e-training dhe krijimin e një njësie të dedikuar për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në nivel vendor, e cila do të jetë përgjegjëse për zhvillimin e kurrikulave dhe programeve të trajnimit të përshtatura me nevojat e administratës në nivel vendor.

5.4 REFORMA E MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE

Strategjia e “Menaxhimit të Financave Publike (MFP) për periudhën 2014-2020” është një dokument, i cili reflekton angazhimin e Qeverisë Shqiptare ndaj qytetarëve për zbatimin e një sërë reformave të rëndësishme për mirëmenaxhimin e financave publike.

❖ Arritjet për vitin 2017

Gjatë vitit 2017, Qeveria ka bërë progres për përmbushjen e kësaj reforme, ku arritjet kryesore veçohen si më poshtë:

- Miratimi i Ligjit nr. 68, date 27.04.2017 "*Për Financat Vendore*", i cili synon rritjen e autonomisë fiskale dhe sigurimin e një menaxhimi financiar efektiv dhe eficient në njësitë e qeverisjes vendore;
- Miratimi i Ligjit nr. 47 date 13.04.2017 "*Për Prokurimet Publike*", i ndryshuar i cili synon të sigurojë Pavarësinë e Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet emërimit të antarëve KPP-së nga Parlamenti pas një procedure konkurruese përzgjedhëse. Gjithashtu janë duke u përgatitur aktet nënligjore për ndjekjen e procedurës së përzgjedhjes nga Kryeministria për kandidatët që do të paraqiten për miratim në Kuvend.
- Në Janar 2017 INSTAT ka përpiluar dhe transmetuar në EUROSTAT, dy tabela të të dhënave të SFQ-së sipas kërkesave të Standarteve Europiane të Kontabilitetit 2010, duke vijuar me përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së të dhënave të nevojshme të Statistikave Financiare Qeveritare (SFQ) dhe Sistemit të Llogarive Europiane (ESA) 2010. Gjithashtu tabelat periodike dyvjeçare të EDP-së janë raportuar në Prill 2017 në EUROSTAT me të dhënat e periudhës 2013-2016.
- Më 1 Qershor 2017 hyri në fuqi Kodi i Ri Doganor i miratuar me ligjin "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*", datë 31.07.2014, i cili synon harmonizimin me standardet e BE-së dhe përshtatjen me mjedisin e sotëm tregtar. Risitë e Kodit të Ri doganor lidhen me: (i) zhvillimin e teknologjive të reja; (ii) procedurat pa letër; (iii) përmirësimin, thjeshtimin e rregullave dhe procedurave doganore; (iv) uljen e kostove; (v) rritjen e sigurisë ligjore për operatorët ekonomikë dhe (vi) vetëvlerësimin, zhdoganimin e centralizuar etj.;
- Në ndjekje të Planit Strategjik për periudhën 2017-2021, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka ndërmarrë shumë aktivitete ndërgjegjësimi me qëllim garantimin e asistencës për përmbushjen

vullnetare si: krijimi i një faqe interneti të re informative për të gjitha kategoritë e taksapaguesve, krijimi i një shërbimi të ri të ndihmës së tatimpaguesit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe në qendrat ADISA në Fier, Gjirokastrë, Krujë dhe Kavajë; si dhe krijimi i një qendre telefonike funksionale; dizenjimi i broshurave informative etj.;

- Gjatë vitit 2017 është bërë rishikimi i Instrumentit të Planifikimit Financiar për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për njësitë e qeverisjes vendore. Qëllimi kryesor i këtij mjeti është t'i shërbejë njësive të qeverisjes vendore si një udhëzues për përgatitjen e PBA-së. Përveç kësaj është krijuar një Manual mbi Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT) dhe "Help Desk" është bërë funksional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të ndihmuar bashkitë që ta impletojnë këtë instrument dhe të plotesojnë saktësisht formatet që lidhen me planifikimin. Për më tepër për herë të parë u përgatit dhe u publikua Programi Buxhetor Afat-Mesëm për Njësitë e Qeverisjes Vendore;
- Përmirësimi i komunikimit midis Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) dhe aktorëve kyç si Parlamenti, media dhe publiku i gjerë në kuadër të Transparencës dhe Përgjegjshmërisë së qeverisë.
- Monitorimi i performancës së sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësive publike (16 institucione të monitoruara për vitin 2017), duke analizuar në detaje elementët e kontrollit të brendshëm që ndikojnë në menaxhimin e fondeve buxhetore;
- Zhvillimi i trajnimeve të vijueshme profesionale për audituesit e brendshëm në bashkëpunim me ASPA, ka dhënë impaktin pozitiv në rritjen profesionale të audituesve për të kryer vlerësime, analiza si dhe dhënë këshilla e rekomandimeve të vlefshme për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe arritjen e objektivave të njësive publike.
- Organizimi i një procesi të ri certifikimi për sezonin 2016-2017 për të fituar titullin "Auditues i Brendshëm në sektorin publik" me mbështetjen e ekspertëve të SIGMA. Ky proces i fokusuar tërësisht në marrjen e njohurive bashkëkohore në fushën e auditimit të brendshëm, do të ndikojë pozitivisht në kryerjen e detyrës me profesionalizëm nga ana e audituesve duke rrjedhur kështu rekomandime sa më vlefshme për drejtuesit në kuadër edhe të menaxhimit të fondeve buxhetore.

❖ **Prioritetet për vitin 2018**

Për vitin 2018, synohet progres i mëtijshëm në realizimin e objektivave të cilat janë pjesë e shtyllave të strategjisë si:

- Forcimi i kapaciteteve të Institutit të Statistikave në fushën e llogarive kombëtare të qeverisë duke synuar përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së të dhënave të nevojshme të Statistikave Financiare Qeveritare (SFQ) dhe transmetimin e tabelave të reja me të dhënat e SFQ-së në EUROSTAT sipas kërkesave të Standarteve Europiane të Kontabilitetit 2010;
- Rishikimi dhe përditësimi i SKZHI-së gjithëpërfshirëse dhe strategjive sektoriale në procesin e PBA-së. Gjithastu, përmirësimi i procesit të planifikimit të investimeve kapitale, vlerësimit dhe përfshirjes në buxhet. Finalizimi dhe miratimi i udhëzimeve dhe kriterëve që do të përdoren për vlerësimin teknik të projekteve të mëdha.
- Miratimi i akteve nënligjore të ligjit nr.68, datë 27 Prill 2017 "*Për Financat Vendore*" për të siguruar forcimin e zbatimit të ligjit mbi financat vendore dhe praktikave të Menaxhimit të Financave Vendore duke miratuar aktet nënligjore, përmirësimin dhe unifikimin e formateve të buxhetit në qeverisjen lokale

- Ngritja e kadastrës fiskale, fillimisht për 2018 pritet të bëhet funksionale kadastra për katër bashki (Tiranë, Durrës, Fier dhe Korçë) vetëm mbi taksimin e ndërtesave. Në vijim, në 2019 synohet realizimi i një databazë kombëtare të centralizuar për të gjitha pronat dhe mbulim tërësisht të territorit të Shqipërisë. Synimi i këtij plani është ngritja e një sistemi të integruar të të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme. Ky sistem do të shërbejë për të përmirësuar administrimin dhe performancën e taksimit të pasurisë si dhe krijimin e bazës së nevojshme për të kaluar në një metodologji moderne llogaritje të taksës kalimin në sistemin e taksimit ku baza e taksës te jete vlera e pronës.
- Rishikimi i metodologjisë dhe udhëzimeve standarde për përgatitjen e PBA-së duke synuar forcimin e rolit udhëheqës të dokumentit të PBA-së dhe cilësinë e procesit strategjik të përgatitjes së buxhetit; përmirësimin dhe asistimin në përgatitjen e metodologjive të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor; si dhe pilotimin e metodologjive të avancuara të PBA-së dhe të buxhetimit në Ministrinë e Linjës të përzgjedhura;
- Forcimi i sistemit të rishikimit të Prokurimeve Publike, me qëllim shqyrtimin të ankesave nga Komisioni i Prokurimit Publik brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj;
- Forcimi i kapaciteteve të KLSH-së dhe përdorimi i teknologjisë së informacionit për futjen e qasjeve të reja të auditimit si edhe ndryshimet e Manualit të Auditimit për të përfshirë aktivitetet për zbulimin e korrupsionit dhe mashtrimin.
- Në kuadër të hartimit të projektbuxhetit për vitin 2018, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik me qëllimin kryesor mirëmenaxhimit të fondeve publike, do të monitorojë në vazhdimësi veprimtarinë e institucioneve mbi bazë performante; do të zhvillojë në vijim kapacitetet e administratës publike, lidhur me përcaktimin dhe matjen e indikatorëve të sipërpërmendur, përmes trajnimeve të ndryshme të organizuara në bashkëpunim me ASPA-n.
- Implementimi i një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit në 6 institucione pilot të përzgjedhura, bazuar në përvojën e fituar nga projekti i mëparshëm.
- Monitorimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike i veprimtarisë së auditimit të brendshëm, për përputhjen me standardet ndërkombëtare të pranura të auditimit si dhe ngritja e vazhdueshme profesionale e audituesve të brendshëm të sektorit publik përmes organizimit të trajnimeve të vijueshme profesionale.

5.5 REFORMA ADMINISTRATIVE DHE TERRITORIALE

Buxheti vendor i vitit 2018, do të shoqërohet me një model të ndryshimit të financimit dhe menaxhimit financiar në qeverisjen vendore, në funksion të thellimit të zbatimit të reformës administrativo-territoriale. Arritjet kryesore të kësaj reforme të shoqëruara me efekte pozitive në buxhetin vendor, do të jenë në drejtim të:

- *Rritjes së transfertës së pakushtëzuar në 16.5 miliardë lekë, nga 13.5 miliardë lekë që ishte në buxhetin e vitit 2017, pra 3 miliardë lekë më shumë (ose rreth 22 % më e lartë) se në vitin 2017.*
- *Rritjes së të ardhurave nga burimet e veta vendore me rreth 2 miliardë lekë më shumë se plani i vitit 2017.*
- *Reformimit të taksës së pronës nëpërmjet një taksimi sa më të drejtë me objektiv rritjen e të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore.*

- Rritjes së buxhetit në tërësi për pushtetin vendor, nga **2.1 për qind** të PBB-së që zinte para reformës në **2.8 për qind** të PBB-së në projekt-buxhetin e vitit 2018.
- Uljes së kostove për qytetarët, duke qenë se fragmentarizimi i njësisve vendore kishte një kosto të konsiderueshme. Këto kursime do të rrisin fondin për investime publike.
- Përmirësimin të procesit të decentralizimit të financave publike;
- Rritjes së eficiencës në ofrimin e shërbimeve publike në nivel vendor, duke patur administrim dhe qeverisje më të mirë.
- Zhvillimit ekonomik lokal dhe në uljen e pabarazive midis njësive të vetëqeverisjes vendore.
- Nxitjes së zhvillimit vendor, ndërkohë që ndarja territoriale para reformës shoqërohej me një ngadalësim në zhvillimin vendor, për shkak të varësisë së njësive të vetëqeverisjes vendore ndaj të ardhurave nga buxheti i shtetit.
- Rritjes së cilësisë dhe modernizimit të shërbimeve publike në nivel të qeverisjes vendore, bazuar në standardet evropiane;
- Rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin;
- Menaxhimit më të mirë të shpenzimeve administrative me qëllim ofrimin e më shumë shërbimeve publike cilësore me një kosto sa më të ulët.
- Forcimit të rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke siguruar më shumë disiplinë fiskale dhe krijimin e një balance midis autonomisë dhe disiplinës fiskale.

6. POLITIKAT E TAKSAVE PËR VITIN 2018

6.1 PAKETA E RE FISKALE

Paketa Fiskale 2018 parashikon disa ndryshime në legjislacionin Fiskal. Ndër ndryshimet kryesore renditen:

1. Ligji Nr. 92/2014 “Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar”.

- Propozohet ulja e pragut të regjistrimit në skemën e TVSH-së. Ky ndryshim pritet të japë një efekt prej +1-1.5 Miliard Lekë për vitin 2018. Argumentat që mbështesin këtë propozim kanë të bëjnë kryesisht me formalizimin dhe kontrollin e zinxhirit të transaksioneve nga kompanitë e mëdha tek biznesi i vogël, duke synuar formalizim të qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve dhe një mbulim tërësor të TVSH. Kjo vjen në frymën e krijimit të një mjedisi sa më të ndershëm dhe konkurses të të bërit biznes.

2. Ligji për Akcizat në Republikën e Shqipërisë nr. 61/2012, i ndryshuar.

- Propozohet për vitin 2018 rritja e akcizës së cigareve të bëhet me 350 lekë për 1000 cigare nga 250 lekë për cigare që është planifikuar në kalendarin aktual. Ky ndryshim parashikon një efekt me + 1 Miliard Lekë. Ky propozim bazohet në argumentat e mëposhtëm:
 - Nevojën e ekuilibrit të ngarkesës fiskale të cigareve me vendet e rajonit, për të shmangur tregtinë ilegale të tyre.
 - Përafrimin e mëtejshëm me Direktivën e BE 2011/64 e cila përcakton se nga 1 janar 2014 niveli minimal i akcizës për cigaret do të jetë të paktën 60% e çmimit mesatar të ponderuar të shitjes për cigaret.

3. Ligji Nr.9632/2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore”, Të Ndryshuar

- Propozohet amendim në ligjin aktual me qëllim ndryshimin e metodologjisë për llogaritjen e taksës së pronës, duke kaluar nga taksimi i sipërfaqes me nje kuotë fikse, në taksimin e vlerës së pronës sipas sistemit ad valorem. Ky propozim bazohet në argumentat e mëposhtëm:
 - Taksa mbi pasurinë duhet të reformohet. Ky fakt është konstatuar dhe kërkuar edhe nga Misionet e FMN-së në mënyrë të vazhdueshme. Taksimi i pasurisë bazuar në vlerën e saj, është metoda më e drejtë e taksimit. Pasuritë e paluajtshme kanë vlera të ndryshme, e për pasojë taksimi mbi bazën e vlerës gjykohet më i drejti. Referuar vendeve të rajonit, Shqipëria është i vetmi vend në Ballkan që takson ende mbi bazën e sipërfaqes.
 - Të ardhurat nga taksa e pasurisë në vendin tonë, janë më të ultat në Rajon. Shqipëria arkëton 0.2% të PBB-së nga taksa e pronës, ndërkohë që vendet përreth nesh arkëtojnë të paktën dyfishin.
 - Kalimi në sistemin e taksimit të vlerës së pronës do të krijojë Kadastrën Fiskale, një element i domosdoshëm jo vetëm për financat publike të një shteti por edhe më gjerë.
 - Pushtetet vendore do të kenë mundësinë që të menaxhojnë vetë të ardhurat nga kjo taksë, duke rritur njëkohësisht përfitimet dhe shërbimet për pagesit e taksës, qofshin qytetarët apo bizneset.

1.

2.

3.

4.

5.

6.

6.1.

6.2 PËRJASHTIMET NGA TAKSAT (“TAX EXPENDITURES”)

Përrjashtimet e taksave, apo “tax expenditures” konsiderohen humbje nga të ardhurat fiskale të parashikuara në legjislacionin fiskal në fuqi, si rezultat i lehtësirave fiskale ose normave preferenciale të vendosura për kategori të caktuara taksapaguesish ose aktiviteteve.

“Përrjashtimet e taksave” janë vlerësuar duke përdorur metodën “Të ardhura të munguara”. Analiza e përrjashtimeve ligjore dhe përrcaktimi i benchmark-ut (përrjashtime që janë normë në të gjithë vendet) u krye me asistencë të FMN-së.

Për vlerësimin dhe matjen e “përrjashtimeve nga taksat” janë marrë në konsideratë tatimet dhe taksat e mëposhtme:

- Tatimi mbi vlerën e shtuar, përrkatësisht në Ligjin nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar” në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

- Tatimi mbi të ardhurat, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar.
- Akciza, përkatësisht në Ligjin nr. 61/2012 "Për Akcizën në Republikën e Shqipërisë"
- Taksat Doganore, përkatësisht në Ligjin nr.102/2014, "Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë".

Janë identifikuar në total për TVSH-në, 78 përjashtime, ku ndër këto 35 përjashtime të veprimtarive me interes të përgjithshëm, 42 përjashtime në import dhe 2 përjashtime të tjera. Për T.V.SH.-në në import janë identifikuar 23 përjashtime si pjesë e benchmark-ut, në vlerën 1,856 milion lekë dhe 19 përjashtime janë përcaktuar si Tax Expenditure, me vlerën 10,728 milion lekë. Për T.V.SH.-në brenda vendit janë llogaritur si pjesë e benchmark-ut shërbimet financiare dhe ndërmjetësime të tjera financiare, me vlerën 5.6 miliard lekë. Ndërkohë sipas sektorëve është llogaritur "Tax Expenditure", me vlerën 6.8 miliard lekë.

Bazuar në Ligjin e të Ardhurave Personale janë identifikuar 13 përjashtime në të ardhurat personale dhe 10 përjashtime nga tatimi mbi fitimin e korporatës, në vlerën 303 milion lekë. Në ligjin mbi akcizën, janë identifikuar 16 përjashtime nga akciza, 9 janë pjesë e benchmark, me vlerën 210 milion lekë dhe 4 përjashtime janë identifikuar si Tax Expenditure, në vlerën 304 milion lekë. Në Kodin Doganor, janë identifikuar 34 përjashtime nga taksat doganore. 9 janë pjesë e benchmark, me vlerën 86 milionë lekë dhe 21 janë identifikuar si Tax Expenditure, me vlerën 73 milionë lekë

Tabela e mëposhtme pasqyron një përmbledhje të përjashtimeve të taksave, si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto, bazuar në të dhënat e marra nga Administrata Tatimore dhe Administrata Doganore për vitin 2016.

Tabela 13: Përmbledhje e përjashtimit të taksave (në milion lekë)

LLOJI I TAKSËS	TAX EXPENDITURE (në milion lekë)	Në % GDP
TVSH	17,611	1.2%
<i>a)TVSH Brenda Vendit</i>	6,883	0.5%
<i>b)TVSH ne Import</i>	10,728	0.7%
Tatim Fitim 15%	303	0.1%
Tatim mbi te Ardhurat Personale* (nëse 23%)	698	0.0%
Taksa Doganore	75	0.0%
Akciza	304	0.0%
Totali	18,641	1.2%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

6.3 RISQET FISKALE DHE MASAT MBROJTËSE

Në krahun e të ardhurave buxhetore risqet fiskale për vitin 2017 konsistojnë në:

- Rritja me rreth 18% i çmimit të karburanteve. Parashikimet e agjencive të specializuara ndërkombëtare minimizojnë mundësitë që kjo rritje të mos ndodhë në këtë nivel. Në planifikimin e të ardhurave, është vlerësuar kompensimi i ndonjë oshilacioni të mundshëm të çmimeve, nëpërmjet disiplinimit maksimal të rasteve të përjashtimeve dhe rimbursimeve përtej normave ligjore dhe parashikimeve.

- Është parashikuar një rritje me 200 ton e importit të cigareve me një efekt në të ardhura nga TVSH, Akciza dhe Taksa Doganore prej 1.8 miliard lekë, bazuar në performancën e vitit 2017. Ky parashikim mund të mos realizohet në 100% të tij dhe mund të ketë riskun e rritjes së importit të cigareve me 100 ton dhe jo me 200 ton sa është parashikuar, me një efekt negativ rreth 0.4 miliard lekë.
- Është parashikuar rritje e importit dhe Prodhimit vendas të karburantit me 7% bazuar në performancën e vitit 2017. Në rast se nuk verifikohet kjo rritje mund të shkojë në 5% me një efekt negativ në të ardhurat me -0.5 miliard lekë.

Tabela 14: Kategoritë e Risqeve sipas llojit të taksës

Risqet	Efektet negative në të ardhurat			
	Akcizë	Taksë Doganore	TVSH	Total
Rritja e cmimeve Brend jo 18% sipas parashikimit por 10%			(400)	(400)
Rritja e Import +Prodhim vendi të karburantit jo me 7% sipas ecurisë 2017 por 5%	(289)		(213)	(502)
Rritja e importit të cigareve jo me 200 ton sipas parashikimit por +100 ton	(274)	(11)	(76)	(362)
Total	(563)	(11)	(689)	(1,263)

Në krahun e shpenzimeve buxhetore, risqet kryesore konsistojnë në:

- **Ngjarjet e karakterizuara nga forca madhore** (fatkeqësitë natyrore), me impakt të konsiderueshëm dhe të paparashikueshëm në buxhetin e shtetit, të tilla si: përmbytje masive, zjarre, tërmete, etj. Për të përballuar të tilla raste, në buxhetin e vitit 2018 është parashikuar një fond prej rreth 130 milionë lekë në programin “Emergjencat Civile” në Ministrinë e Brendshme, si dhe Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit në shumën 1.5 miliardë lekë.
- **Mos-ofrimi në kohë dhe konform standardeve të shërbimeve publike**, të domosdoshme për qytetarin, nga ana e ndërmarrjeve publike me kapital shtetëror (KESH, OST, OSHEE, Ndërmarrjet e Ujësjetës Kanalizimeve, etj). Konkretisht:
 - Për sektorin e Furnizimit me Ujë të pijshëm, në këtë Projektbuxhet është planifikuar subvencionimi i ndërmarrjeve të këtij sektori në masën 1 miliardë lekë, me qëllim garantimin e ofrimit të shërbimit konform standardeve.
 - Për sektorin e Energjisë janë planifikuar 50.8 miliardë lekë në formën e garancisë shtetërore për çdo kredi të mundshme që ndërmarrjet publike të këtij sektori mund të marrin nga institucionet kredituese financiare. Kjo garanci ka formën e një detyrimi kontigjent, për të parandaluar risqet eventuale të mospagesës së kredisë. Ndërkohë, përse i përket probabilitetit të materializimit gjatë vitit 2018 të risqeve eventuale që lidhen me sektorin e Energjisë, ai kushtëzohet gjerësisht nga karakteristikat e situatës financiare të operatorëve të sektorit, dhe përkatësisht:
 - *Situata e pafavorshme financiare e OSHEE sh.a gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017, kushtëzuar nga kushtet e vështira klimaterike të thatësirës së tejzgjatur, e cila mund të rishfaqet gjatë vitit 2018.*

- Për rrjedhojë, pozicioni i pafavorshëm financiar i OSHEE sh.a ndikon edhe në situatën e kompanive të tjera të sektorit, sidomos të KESH sh.a, përmes pamundësisë së arkëtimit të detyrimeve të kësaj të fundit nga OSHEE sh.a.
- Nga ana tjetër, edhe KESH sh.a, në vijim të një situatë hidrike problematike të vitit 2017 që ka kushtëzuar rënien e prodhimit të energjisë në vend, nuk mund t'i sigurojë OSHEE sh.a sasinë e nevojshme të energjisë duke e detyruar këtë të fundit që t'i drejtohet importit të energjisë me çmimin e tregut, logjikisht më i shtrenjtë se sa ai i prodhimit vendas.

Për pasojë, vunerabiliteti i sektorit të Energjisë nga situata meteorologjike në vend, përbën faktorin kryesor të riskut. Në rastet e një situatë ndjeshëm negative, ky vunerabilitet efektiv shkakton një efekt domino në të gjithë operatorët e sektorit, me një impakt të ndjeshëm në situatën financiare të secilës prej kompanive, duke vënë në kësisoj në pikëpyetje ecurinë e masave të ndërmarra në kuadër të reformës për rimëkëmbjen energjitike.

- **Vendimet gjyqësore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe konkretisht:**

- Vendimet gjyqësore administrative të formës së prerë, kryesisht për largime të padrejta nga puna të ish-punonjësve, proçese gjyqësore me karakter shpronësimi, etj, implikojnë kosto buxhetore të paparashikuara dhe shpeshherë në masë të konsiderueshme. Planifikimi në buxhetin e vitit 2018 i fondeve të nevojshme për shlyerjen e këtyre detyrimeve është realizuar brenda buxheteve respektive të institucioneve buxhetore përgjegjëse. Sidoqoftë, për t'i paraprirë një stoku eventual të akumulimit të tyre në kohë, kushtëzuar nga fatura financiare relativisht të larta, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vazhdimisht i është apeluar aftësisë menaxhuese të vetë institucioneve buxhetore, përmes aplikimit për këtë qëllim të kësteve apo instrumentave të tjerë zbutës në kohë të barrës së tyre buxhetore.
- Vendimet e formës së prerë të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ), ku historiku i çështjeve dhe vendimeve që i përkasin shtetasve shqiptarë ka treguar se ato janë kryesisht çështje dhe vendime që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët. Risqeve financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së, sipas Avokaturës së Shtetit që është edhe institucioni përgjegjës, kanë qenë dhe mbeten të karakterizuara nga një aftësi e dobët parashikuese, përse kohë që kjo Gjykatë nuk funksionon me një kalendar të përcaktuar për komunikimin e çështjeve dhe nxjerrjen e vendimeve. Për rrjedhojë, me qëllim minimizimin e riskut buxhetor që ato mbartin e duke konsideruar paparashikueshmërinë e natyrës së tyre, edhe në buxhetin e vitit 2018 kjo kosto financiare eventuale do të përballohet në kuadër të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit për vitin 2018.
- Vendimet e formës së prerë të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, që kanë të bëjnë me zgjidhjen e konflikteve në marrëveshjet dy apo shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar, përbëjnë gjithashtu një risk real për buxhetin e shtetit. Në pjesën më të madhe, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballuar nga buxheti i vetë institucioneve buxhetore (kryesisht ministri linje) që kanë përfaqësuar Qeverinë shqiptare, por nuk kanë munguar as rastet kur është nevojitur përdorimi i Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit për këtë qëllim. Kjo për dy arsye kryesore, vlera e konsiderueshme monetare që i karakterizon (shoqëruar shpesh me një kamatvonesë të lartë), si edhe karakteri i paparashikueshëm në kohë i materializimit të tyre, që në të dy rastet jo rrallëherë ka vënë në vështirësi serioze institucionet buxhetore respektive.

Deklarata e Risqeve Fiskale (DRF) – Instrument për parashikimin dhe parandalimin e tyre:

Me qëllim ndjekjen intensive të performancës së zbatimit të buxhetit të shtetit, duke monitoruar dhe raportuar risqet që shoqërojnë zbatimin e tij, në fund të vitit 2017 do të prezantohet dhe publikohet “Deklarata e Risqeve Fiskale (DRF)”. Ky do të jetë një dokument vjetor i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë i cili ka për qëllim që, në bazë të analizave të thelluara, të zbusë dhe/apo parandalojë risqet fiskale, pasuar nga një vendimarrje koherente. Fokusi i DRF është të sigurojë që të gjitha risqet kryesore fiskale janë identifikuar, vlerësuar dhe raportuar në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse, gjë që do të realizohet përmes mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave fiskale të besueshme. Në vija të përgjithshme, risqet të cilat do të identifikohen dhe raportohen në këtë deklaratë janë të natyrës:

- “Explicite”, apo risqet të cilat kanë lidhje me supozimet dhe zhvillimet makroekonomike, të ardhurat e qeverisë, shpenzimet dhe menaxhimi i borxhit, etj.
- “Implicite”, apo detyrimet kontingjente, PPP-të, ato të vetëqeverisjes vendore, ndërmarrjet publike me kapital shtetëror, risqe të tjera si vendime gjyqësore, fatkeqësi natyrore dhe sektori financiar apo risqet afatgjata.

7.

7. MONITORIMI I DETYRIMEVE TE REJA TË PRAPAMBETURA

Një nga çështjet problematike në sistemin tonë buxhetor, u vërtetua se ishte akumulimi i detyrimeve të prapambetura të krijuara përpara vitit 2014. Qeveria jo vetëm e adresoi me prioritet çështjen e shlyerjes së tyre, por me angazhimin maksimal si të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ashtu edhe të institucioneve buxhetore të përfshira në këtë proces, u arrit që brenda dy viteve (2014-2015) të shlyen të gjitha detyrimet e prapambetura të raportuara, në vlerën 67 miliardë lekë.

Ndërkohë që, përsa i përket procesit follow-up të monitorimit dhe raportimit të detyrimeve të reja të prapambetura (new arrears), vlen për t’u theksuar këtu se tashmë ky është një proces i konsoliduar në kohë dhe cilësi. Duke nisur nga janari 2016 është kryer një monitorim periodik intensiv i të gjitha detyrimeve të pashlyera të institucioneve buxhetore, mbi bazën e një skeduli katërmujor. Ndërkohë, bazuar edhe në rekomandimin specifik të Fondit Monetar Ndërkombëtar, duke nisur nga shtatori 2017 ky monitorim dhe raportim do të kryhet mbi bazë tremujore, gjë që synon intensifikimin e rolit mbikqyrës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në këtë drejtim. Kjo, me qëllim përmbushjen e angazhimit të Qeverisë për zerimin e të gjitha detyrimeve të prapambetura deri në vitin 2020,

Me këtë fokus, gjatë vitit 2016, Ministria e Financave dhe Ekonomisë filloi t’u sigurojë institucioneve të drejtën e përdorimit direkt të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), duke bërë të mundur regjistrimin e angazhimeve/kontratave shumëvjeçare në përputhje me tavanet trevjeçare të miratuara. Aktualisht operojnë në sistem 15 institucione buxhetore (të cilat përbëjnë rreth 84% të totalit të buxhetit të shtetit). Duke konsideruar ecurinë e deritanishme të ritmeve të dizenjimit të sistemit të ri të Programimit Buxhetor Afatmesëm (AFMIS), i cili parashikohet të fillojë operimin në vitin 2019, synohet që në vitin 2020 rreth 100 institucione buxhetore të tjera të keë mundësinë e veprimeve online në SIFQ. Mbi këtë bazë, respektimi i angazhimeve buxhetore e financiare të institucioneve do të monitorohet dhe kontrollohet tërësisht nëpërmjet SIFQ.

Në këtë kontekst, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka sugjeruar të gjitha njësitë të auditimit të brendshëm në sektorin publik që në “Planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë audituese për vitet 2018 – 2020” të përfshijnë angazhime auditimi për analizimin dhe vlerësimin e situatës së detyrimeve të prapambetura të njësitë publike. Detyrimet e prapambetura janë përcaktuar si fushë me risk të lartë që duhet të trajtohet me përparësi nga auditimi i brendshëm i njësitë publike për të paraqitur gjendjen aktuale dhe për të dhënë rekomandime sa më të vlefshme shlyerjen e tyre në afate të përcaktuara.

7.1. MOSREALIZIMI NË KOHË I INVESTIMEVE PUBLIKE

Qeveria ka marrë një sërë masash për të siguruar realizimin në kohë të investimeve, nëpërmjet monitorimit rigoroz të tyre dhe rialokimeve të pjesshme brenda programeve, nga projektet me ecuri më të gadaltë në ato projekte të cilat kanë avancuar përtej fondeve të alokuara.

Në këtë kontekst, me Aktin Normativ Nr.2 datë 16.08.2017 janë bërë edhe rialokimet ndërmjet programeve apo edhe institucioneve në përputhje me ecurinë e zbatimit të projekteve, si dhe përditësime të tavanëve të financimit të investimeve sipas burimit të financimit, konkretisht përmes uljes së tavanit të financimit të huaj, ku realizimi i projekteve ka patur një performancë relativisht më të dobët dhe rritjes së tavanit të financimit të brendshëm. Kjo bazuar në ecurinë më të mirë që ka patur realizimi i projekteve me financim të brendshëm në raport me projektet me financim të huaj gjatë 6-mujorit të parë 2017.

Në referim të treguesve të monitorimit lidhur me realizimin e investimeve për muajin shtator 2017, realizimi i investimeve paraqitet më i lartë në raport me realizimin e investimeve për të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Edhe për vitin 2017 do të vazhdohet me aplikimin dhe përmirësimin e masave të mëposhtme për kryerjen në kohë të investimeve publike:

- *Sistem monitorimi (muajor) i cili do të verifikojë problematikën dhe do të propozojë masat për zgjidhje brenda një kohe më të shkurtër;*
- *Monitorimi i veçantë (javor) i portofolit të investimeve publike për projektet prioritare me impakt të gjerë, duke veçuar këtu projektet me impakt të ndjeshëm buxhetor, të cilat do të monitorohen sipas ecurisë së tyre në bazë javore për të siguruar realizimin e tyre në terma financiar dhe rrjedhimisht në plotësimin e objektivave të vendosura nga institucionet e linjës;*
- *Rialokime të fondeve buxhetore nga projektet me performancë të ulët në projektet me performancë më të lartë, duke konsideruar gjithashtu dhe mundësinë e rishikimit të ligjit të buxhetit 2017 për këtë qëllim.*
- *Çeljen e planeve të investimeve brenda muajit Janar dhe përgatitjen e dokumentacionit të prokurimit brenda muajit Shkurt për projektet e reja.*

Po kështu, të gjithë institucionet buxhetore do të kenë përgatitur paraprakisht listën e nevojave të tyre sa u përket investimeve prioritare, që në fillim të vitit 2018, me synim për të arritur plotësimin e kushteve dhe afateve për zbatimin në kohë të këtyre investimeve, dhe për faktorizimin e tyre në ekonomi.

7.2. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Borxhi publik gjatë vitit 2017 u karakterizua nga një ecuri pozitive, duke qenë në përputhje me buxhetin e planifikuar për vitin 2017 dhe objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit (SAMB).

Në përputhje me buxhetin e vitit 2017, gjatë nëntëmuorit u realizua me sukses huamarrja, e cila mundësoi rifinancimin e borxhit ekzistues dhe mbulimin e nevojave të Qeverisë për likuiditet. Nëpërmjet burimeve të brendshme dhe të huaja, huamarrja është realizuar përkatësisht në nivelin 68% dhe 92% të planit vjetor⁴.

Në linjë me objektivat e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit, gjatë vitit 2017 u menaxhua ulja e mëtejshme e ekspozimit ndaj risqeve duke mbajtur nën kontroll kostot e borxhit, si edhe u vijua me aktivitetet e planifikuara në kuadër të zhvillimit të tregut primar të titujve shtetërorë.

Në kuadër të uljes së ekspozimit ndaj risqeve, huamarrja e brendshme neto u realizua nëpërmjet titujve afatgjatë, ndërkohë që u ul përqëndrimi i portofolit të titujve afatshkurtër.

Në drejtim të mbajtjes nën kontroll të kostove të borxhit, u shfrytëzuan normat e interesit të titujve shtetërorë afatgjatë, të cilat vijnë të jenë në nivele relativisht të ulta, si edhe burimet e huaja të financimit me terma të favorshme (*të tilla si Mbështetja Buxhetore*).

Në vazhdim të angazhimit të marrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar të titujve shtetërorë, si edhe hedhjen e hapave për funksionimin e tregut sekondar, përgjatë vitit 2017 janë realizuar objektiva të tilla si:

- i) Konsolidimi i ankandëve të instrumenteve afatshkurtra;
- ii) Fokusimi në krijimin e madhësive *benchmark* për titujt afatgjatë;
- iii) Komunikimi i vazhdueshëm me aktorët kryesorë të tregut të titujve shtetërorë.

Gjatë vitit 2018, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus reduktimin e mëtejshëm të ekspozimit ndaj risqeve të portofolit të borxhit (*kryesisht portofolit të borxhit të brendshëm*), si edhe ruajtjen e raporteve të pranueshme ndërmjet kostos dhe riskut. Ndërkohë, do të vazhdojnë të ndërmerren aktivitete të cilat do të synojnë zhvillimin e mëtejshëm të tregut primar dhe nxitjen e aktivitetit të tregut sekondar për titujt shtetërorë.

Për sa më sipër, financimi i brendshëm në terma neto do të orientohet kryesisht në drejtim të titujve afatgjatë, duke shfrytëzuar normat e interesit në nivele ende të ulta, të cilat e bëjnë zbatimin e kësaj strategjie financimi më pak të kushtueshme dhe garantojnë përmirësim të raportit ndërmjet kostos dhe riskut. Prioritet do të ketë emetimi i titujve afatgjatë me norma interesi fikse. Megjithatë, edhe titujt me norma interesi të ndryshueshme do të vijnë të emetohen në vlera të cilat do të rishikohen dhe bëhen transparente nëpërmjet publikimit periodik të kalendareve të huamarrjes, në varësi të ecurisë së realizimit të objektivave, kushteve të tregut dhe preferencave të kreditorëve. Nëpërmjet titujve afatshkurtër kryesisht do të synohet rifinancimi me sukses i titujve ekzistues që maturohen dhe menaxhimi aktiv i nevojave për likuiditet.

Financimi i huaj do të mbështetet në financimin me terma pjesërisht të buta të projekteve ekzistuese, projekteve të reja të konsideruara si prioritare nga Qeveria për zhvillimin e vendit, si edhe në disbursimin

⁴ Referuar ligjit Nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”.

e kredive të akorduara nga institucionet ndërkombëtare financiare për të mbështetur politikat zhvillimore të vendit.

Gjatë vitit 2018, përveç sa më sipër, mund të ketë dhe një shtesë financimi të huaj në formën e huave tregtare ose nëpërmjet daljes në tregjet ndërkombëtare me Eurobond mbi baza oportuniste. Kjo shtesë financimi do të vlerësohet gjatë vitit në varësi të nevojës për të ulur presionin në tregun e brendshëm, me qëllim shmangien e kufizimeve që burojnë nga kapaciteti i limituar i tregut të brendshëm⁵, si edhe nevojës për të shërbyer detyrimet e borxhit në valutë, të cilat gjatë vitit 2018 vlerësohen rreth 20% më të larta se ato të vitit aktual.

Gjatë vitit 2018, duke marrë në konsideratë nivelin më të ulët historik të normave të interesit aktuale, pjerrësinë pozitive të kurbës së yield-it, si edhe direktivat e bankave mëma ndaj bankave të nivelit të dytë, për të mbajtur nivele të pranueshme ekspozimi ndaj borxhit sovran, pritet që të ketë një rritje të normave të interesit. Niveli i rritjes së normave në tregun e brendshëm pritet të jetë gradual dhe nën nivelin mesatar të tre viteve të fundit.

Në tregun e jashtëm, situata nuk paraqitet shumë e qartë për shkak të divergjencave në politikat monetare të BQE dhe Rezervës Federale. BQE synon të vijojë me politikat lehtësuese, ndërkohë që Rezerva Federale pritet të rrisë normat e interesit me qëllim normalizimin e politikave monetare. Në këto kushte, vlerësimet aktuale për periudhën afatmesme parashikojnë një rritje të moderuar të normave të interesit, kryesisht në segmentin e instrumenteve me norma interesi tregtare. Efektet mbi shërbimin e borxhit të huaj priten të jenë të moderuara pasi rreth gjysma e këtij borxhi është huazuar me norma interesi fikse dhe koncesionale.

Kostot e përgjithshme të borxhit priten të kenë një rritje të moderuar, që buron kryesisht nga rritja e borxhit në vlerë absolute. Efektet e ndonjë rritjeje të mundshme të normave gjatë vitit 2018 do të jenë minimale dhe do të materializohen kryesisht në vitet pasardhëse.

KËSHILLI I MINISTRAVE

⁵ Vlerësohet se kapaciteti optimal i tregut të brendshëm për të financuar nevojat për hua të Qeverisë është rreth 15-20 miliard Lek (në terma neto)

8. SHTOJCA ILUSTRUESE


8.1 TREGUESIT E PËRZGJEDHUR MAKROEKONOMIKË DHE FISKALË

Tabela 15: Rritja e ekonomike krahasuar me vendet e rajonit (në % të PBB)


Rritja ekonomike, ne %	2013	2014	2015	2016	2017	
					T1	T2
Shqipëria	1.0	1.8	2.6	3.2	3.9	4.1
Bosnja dhe Hercegovina	2.4	1.1	3.0	2.8		1.7
Kosova	3.4	1.2	4.1	3.6	3.8	4.6
Maqedonia	2.9	3.6	3.8	2.4	0.0	-1.8
Mal i Zi	3.5	1.8	3.4	2.1	3.2	5.1
Sërbia	2.6	-1.8	0.8	2.8	1.2	1.3

Burimi: Të dhëna zyrtare të vendeve përkatëse

Grafiku 7: Ndryshimi vjetor i inflacionit (%)



Grafiku 8: Treguesi i Ndjeshmërisë Ekonomike



Grafiku 9: Rritja e volumit të tregtisë me pakicë







Tabela 16: Tregtia e Jashtme

	Rritja	Kontributi në rritje	Rritja	Kontributi në rritje
Ushqime, pije, duhan	17.7	1.7	6.0	1.1
Minerale, lëndë djegëse, en.elektrike	1.6	0.3	16.6	1.4
Produkte kimike dhe plastike	11.2	0.2	8.6	1.2
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	10.1	0.1	7.7	0.2
Prodhime druri dhe letrë	1.2	0.0	0.5	0.0
Tekstile dhe këpucë	8.6	3.9	8.9	1.2
Materiale ndërtimi dhe metale	40.1	5.1	2.8	0.4
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	27.6	1.3	0.9	0.2
Të tjera	5.5	0.2	16.4	0.6
Gjithsej	12.8	12.8	6.3	6.3

Burimi: INSTAT

Grafiku 10: Dinamikat e rritjes së stokut total të Depozitave dhe Kredive



8.2 ZHVILLIMET FISKALE GJATË 9-MUJORIT 2017

Të ardhurat nga “Tatime dhe Dogana” (përfshirë kontributet e mbledhura nga DPT) për 9 mujorin 2017, u realizuan në vlerën 279.8 miliard lekë, 20.2 miliard lekë ose 7.8% më shumë se 9 mujori i vitit 2016 dhe 1.5 miliard lekë ose 0.6% më shumë se plani.

Tabela 17: Performanca DPD+DPT Janar- Shtator 2017

(në milion lekë)

Lloji i taksave	Fakt 2016	9-mujor Fakt 9-mujor 2017	Plan 2017	9-mujor Diferenca 2017/2016	Ndryshimi në 2017/2016	Diferenca	
						në % Fakt/2017	Ndryshimi në Plan % Fakt/Plan 2017
Tvsh në import	71,341	75,597	75,138	4,256	5.97%	459	0.61%

<i>Tvsh brenda vendit</i>	24,941	26,323	26,430	1,382	5.54%	-107	-0.40%
<i>Tatimi mbi fitimi</i>	21,733	23,465	23,440	1,732	7.97%	25	0.11%
<i>Akciza</i>	30,979	33,921	33,911	2,942	9.50%	10	0.03%
<i>Tatimi mbi të ardhurat personale</i>	24,407	24,528	25,474	121	0.50%	-946	-3.71%
<i>Taksat nacionale</i>	24,125	28,261	27,971	4,136	17.14%	290	1.04%
<i>Renta</i>	2,014	1,738	1,674	-276	-13.70%	64	3.82%
<i>Taksë doganore</i>	4,437	4,774	4,769	337	7.60%	5	0.10%
TOTALI TATIME + DOGANA	203,977	218,607	218,807	14,630	7.17%	-200	-0.09%
<i>Kontributet e mbledhura (DPT)</i>	55,562	61,150	59,420	5,588	10.06%	1,730	2.91%
TOTALI TATIME + DOGANA (përfshirë kontributet)	259,539	279,757	278,227	20,218	7.79%	1,530	0.55%


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për 9-mujorin e vitit 2017, ka performuar në masën 100.5%, ose në vlerën 538 milion lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, ka një tejkalim për këtë periudhë në masën 6.7%, ose në vlerën 7.3 miliard lekë.

Grafiku 11: Performanca e DPD-së Janar-Shtator 2017/2016

(në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë(2017)

Tabela 18: Performanca e DPD-së sipas taksave Janar-Shtator 2017

(në milion lekë)

	Plan	Fakt	Diferenca Fakt/ Plan	Fakt/ Plan (%)
Taksë doganore	4,769	4,774	5	0.10%
TVSH	75,138	75,597	459	0.61%
Akcizë	33,911	33,921	10	0.03%
a. Akcizë e arkëtuar		34,365		
b. Akcizë e rimbursuar		444		
Renta minerare	1,674	1,738	64	3.82%
Total	115,492	116,030	538	0.47%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Të ardhurat nga taksa doganore janë realizuar në vlerën 4.8 miliard lekë, 7.6% ose rreth 337 milion lekë më shumë se 9 mujori i vitit 2016, dhe 0.1% ose 5 milion lekë më shumë se plani. Importi i taksuar është rritur me 5.2% krahasuar me Janar – Shtator 2016.

Të ardhurat nga akciza janë realizuar në vlerën 33.9 miliard lekë, 9.5% ose 2.9 miliard lekë më shumë se 9 mujori i vitit 2016, dhe 0.03% ose rreth 10 milion lekë më shumë se plani. Ndikim kryesor ka pasur importi dhe prodhimi vendas i karburanteve që rezultoi rreth 422 mijë ton, me një rritje prej 40,040 ton ose + 10.5% krahasuar me 9 mujorin e vitit 2016. Gjithashtu rritje kanë shënuar, importi i Gazit të Lëngët me 24.1%, importi dhe prodhimi i birrës me 13.7%, importi i pijeve energjike me 15.5%, Importi dhe prodhimi i verës me 15.8%, dhe importi i cigareve me 3.7%. Importi i kafes ka shënuar një rënie prej 0.6% krahasuar me Janar- Shtator 2016 ndërkohë që është rritur deklarimi i prodhimit vendas të duhanit nga 0.7 ton në 7.5 ton të deklaruara në periudhën Janar- Shtator 2017.

Të ardhurat nga renta minerare në eksport janë realizuar në vlerën 1.7 miliard lekë, 13.7% ose 276 milion lekë më pak krahasuar me 9 mujorin e vitit 2016, dhe 3.8% ose 64 milion lekë më shumë se plani. Ndikim kryesor ka patur rritja e sasisë së mineraleve të eksportuara me 21.7% krahasuar me Janar- Shtator 2016. Të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto janë ulur me 777 milion lekë për shkak të rënies së sasisë së eksportuar, me rreth 375 mijë ton e destinuar kjo për përpunim vendas dhe janë rritur me 281 milion lekë për shkak të rritjes së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare krahasuar me Janar- Shtator 2016, duke sjellë rritje të rentës për njësi nga 2.1 Lek për kg në 2.9 lekë për kg.


Të ardhurat nga TVSH-ja në import janë realizuar në vlerën 75.6 miliard lekë, 6% ose rreth 4.3 miliard lekë më shumë se 9 mujori i vitit 2016 dhe 0.6% ose rreth 459 milion lekë më shumë se plani. Rritja e prodhimit vendas të karburantit ka ulur importin e këtij produkti dhe si rrjedhojë të ardhurat nga TVSH-ja në import. Karburanti prodhim vendas mbuloi rreth 30.8% të konsumit gjatë 9 mujorit të vitit 2017 krahasuar me 1.5% që ishte ky tregues vitin e kaluar.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Të ardhurat e mbledhura (përfshirë kontributet) për 9 mujorin e vitit 2017 janë realizuar në vlerën 163.7 miliard lekë, rreth 13 miliard lekë ose 8.6% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë dhe tejkalim të parashikimeve me 992 milion lekë ose 0.6%.

Grafiku 12: Performanca e DPT-së për periudhën Janar-Shtator 2017

(në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)


Tabela 19: Performanca e DPT sipas taksave Janar-Shtator 2017 (në milion lekë)

	Plan	Fakt	Diferenca Fakt/ Plan	Fakt/ Plan (%)
TVSH	26,430	26,323	-107	-0.40%
Tatim Fitimi	23,440	23,465	25	0.11%
Tatimi mbi të ardhurat Personale	25,474	24,528	-946	-3.71%
Taksa nacionale	27,971	28,261	290	1.04%
Kontributet	59,420	61,150	1,730	2.91%
Total	162,735	163,727	992	0.61%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë(2017)


Të ardhurat nga TVSH-ja brenda vendit janë realizuar në vlerën 26.3 miliard lekë, 5.5% ose 1.4 miliard lekë më shumë se 9 mujori i vitit 2016 dhe me një realizim të planit të periudhës në masën 99.6% ose rreth 107 milion lekë më pak. Rimbursimi i TVSH është realizuar në vlerën 9 miliard lekë, rreth 2.6 miliard lekë ose 39.7% më shumë se 9 mujori i vitit 2016 për shkak të rritjes së intensitetit të punimeve dhe e kërkesave për rimbursim nga investitorët e mëdhenj.

Grafiku 13: Të ardhurat nga TVSH brenda vendit Janar-Shtator ndër vite (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë(2017)


Grafiku 14: Rimbursimi i TVSH-së për periudhën Janar- Shtator ndër vite (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë realizuar në vlerën 23.5 miliard lekë, 8% ose reth 1.7 miliard lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe 0.1% ose 25 milion lekë më shumë se plani. Ndikimin kryesor në këtë rezultat e ka patur rritja e ndërgjegjësimit të taksapaguesve për deklarimin real të transaksioneve deri tek konsumatorët fundorë.


Grafiku 15: Të ardhurat e realizuara nga Tatimi Fitimi Janar-Shtator ndër vite (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Nga tatimi mbi të ardhurat personale janë realizuar 24.5 miliard lekë, 0.5% ose 121 milion lekë më shumë se 9 muhori i vitit 2016 dhe 3.7% ose 946 milion lekë më pak se plani. Ndikim në deklarimet e kësaj takse ka pasur reduktimi i pagesës së tatimit në burim për shitjet e pasurive të paluajtshme për shkak të ligjit të rivlerësimit në 2% nga 15% që është niveli bazë.


Grafiku 16: Të ardhurat e realizuara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale Janar-Shtator ndër vite (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Të ardhurat nga Taksat Nacionale janë realizuar 28.3 miliard lekë, 17.1% ose 4.1 miliard lekë më shumë se 9 mujori i vitit 2016 dhe me një realizim të planit në masën 101% ose 290 milion lekë. Faktor kryesor me ndikim në këtë realizim kanë qenë të ardhurat nga rivlerësimi i pasurive të paluajtshme rreth 3.6 miliard lekë.


Grafiku 17: Të ardhurat e realizuara nga Taksat Nacionale Janar- Shtator ndër vite (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Të ardhurat nga kontributet e DPT janë realizuar në vlerën 61.1 miliard lekë, 10.1% ose rreth 5.6 miliard lekë më shumë se 9 mujori i vitit 2016 dhe 2.9% ose rreth 1.7 miliard lekë më shumë se plani. Rezultati shumë i lartë me rritje të qëndrueshme buron kryesisht nga situata pozitive ekonomike dhe rritja si rrjedhojë e numrit të të punësuarve.

Grafiku 18: Të ardhurat e realizuara nga Kontributet për periudhën Janar-Shtator ndër vite (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë(2017)

8.3 SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR 9-MUJORIN 2017

BUXHETI QENDROR

Shpenzimet e përgjithshme publike, për muajin e nëntë të vitit 2017, arritën në rreth 320 miliardë lekë me një realizim në masën rreth 97.8 përqind të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016 ky zë ka rezultuar 11.3 përqind më i lartë ose rreth 32.5 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet e përgjithshme për 9 mujorin e vitit 2017 u realizuan në masën rreth 68.2 përqind të planit vjetor, të ndryshuar me Aktin Normativ Nr.2, datë 16.08.2017.

Shpenzimet korente dhe ato kapitale, kanë shënuar një realizim optimal, respektivisht në masën 99 përqind dhe rreth 90.5 përqind të planit të periudhës. Ndërkohë që, *në terma vjetorë* ato janë realizuar përkatësisht në 71.5 përqind dhe 53.6 përqind të tij.

Tabela 20: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 9 mujorin e vitit 2017 (në milion lekë)

Emertimi	Shtator 2017		Diferenca		Viti 2017	
	Plan	Fakt	Fakt-Plan	ne % mbi Plan	Plani Vjetor	% e realizimit vjetor
Shpenzimet e Pergjithshme	327,411	320,031	-7,380	97.7%	469,600	68.1%
<i>Shpenzimet Korente</i>	280,083	277,362	-2,721	99.0%	387,769	71.5%
<i>Shpenzimet Kapitale</i>	43,864	39,709	-4,155	90.5%	74,131	53.6%
Deficit/Suficit	-7,839	-462	7,377	5.9%	-31,199	1.5%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Tabela 21: Treguesit fiskalë të konsoliduar për 9 mujorin e vitit 2016 dhe 2017 (në milion lekë)

Emertimi	Fakt Shtator 2016	Plan 2017	Fakt 2017	Diferenca		Diferenca	
				Fakt 2017 Plan 2017	Ne % ndaj Plan 2017	Fakt 2017 Fakt 2016	Ne % ndaj Fakt 2016
Shpenzimet e Pergjithshme	287,541	327,411	320,031	-7,380	97.7%	32,490	111.3%
<i>Shpenzimet Korente</i>	252,876	280,083	277,362	-2,721	99.0%	24,486	109.7%
<i>Shpenzimet Kapitale</i>	34,665	43,864	39,709	-4,155	90.5%	5,044	114.6%
Deficit/Suficit	10,568	-7,839	-462	7,377	5.9%	-11,030	-4.4%


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet korente për periudhën 9 mujore të këtij viti rezultuan në rreth 277.36 miliardë lekë, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 9.7 përqind më i lartë ose rreth 24.49 miliardë lekë më shumë.

Shpenzimet kapitale për 9 mujorin e vitit 2017 paraqesin një realizim në masën rreth 39.7 miliardë lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, ky zë është 14.6 përqind më i lartë ose rreth 5.04 miliardë lekë më shumë.

Niveli i deficitit në 9 mujorin e parë të vitit 2017 rezultoi rreth 462 milion lekë, ose 11.03 miliardë lekë më i ulët se e njëjta periudhë e një viti më parë, ose 95.6 përqind më pak.


Grafiku 19: Shpenzimet e përgjithshme dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet korrente në raport me planin 9 mujor të këtij viti, paraqesin një realizim prej 99 përqind, duke rezultuar në rreth 277.36 miliardë lekë. Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korente kundrejt planit 9 mujor janë përkatësisht: shpenzimet e personelit me rreth 99.2 përqind, shpenzimet për fondet speciale me rreth 99.2 përqind, shpenzimet operative mirëmbajtje me rreth 93.8 përqind dhe shpenzimet e tjera sociale me 97.33 përqind. Niveli i realizimit të shpenzimeve publike, është shoqëruar me një nivel deficiti prej 462 milion lekë.


Grafiku 20: Shpenzimet Korente dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet e Personelit gjatë muajit Shtator 2017, përfaqësuan rreth 19.4 përqind të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 53.86 miliardë lekë, realizon nivelin e parashikuar për këtë zë në planin e periudhës 9 mujore, në masën rreth 99.2 përqind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, ky zë është 7.5 përqind më i lartë ose rreth 3.76 miliardë më shumë.


Grafiku 21: Shpenzimet e Personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet për Paga në fund të 9 mujorit 2017 u realizuan në masën rreth 46.4 miliardë LEK, duke qenë 7.5 përqind më të larta se e njëjta periudhë e vitit 2016, ose rreth 3.25 miliardë LEK më shumë. Për rrjedhojë, edhe shpenzimet për sigurime shoqërore rezultuan në masën rreth 7.3 përqind më të larta se një vit më parë. Realizimi faktik i këtyre zërave së bashku, është në nivelin rreth 99.2 përqind krahasuar me planin e periudhës, ose rreth 71.7 përqind e planit vjetor.


Grafiku 22: Shpenzimet e Pagave dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet për Interesa gjatë periudhës 9 mujore 2017 kanë përfaqësuar rreth 7.8 përqind të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 99 përqind të planit të periudhës. Në raport me planin vjetor, të ndryshuar, prej 37.9 miliardë lekë, në nivel 9 mujori këto shpenzime janë realizuar në masën 57 përqind të tij, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, ky zë ka rezultuar 16.1 përqind më i ulët, me një kursim nominal në masën rreth 4.13 miliardë lekë.


Grafiku 23: Shpenzimet për Interesa (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet Operative & Mirëmbajtje, gjatë 9 mujorit që lamë pas, kanë shënuar një realizim në masën rreth 27.9 miliardë lekë, ose 62.12 përqind e planit vjetor. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016, ky zë ka rezultuar 1.5 përqind më i lartë, ose 407 milion lekë më shumë.


Grafiku 24: Shpenzimet Operative dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet për Subvencione, në fund të periudhës 9 mujore 2017, arritën nivelin rreth 1.3 miliardë lekë, me një realizim në masën 90 përqind ose 143 milion lekë më pak se plani i periudhës. Në raport me planin vjetor, të ndryshuar, ky zë është realizuar në masën rreth 55.5 përqind, ndërkohë që kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2016 shpenzimet për subvencione rezultojnë 15.5 përqind më të larta ose 174 milion lekë më shumë.


Grafiku 25: Shpenzimet për Subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet për Fondet Speciale për 9 mujorin e vitit 2017 rezultuan në nivelin rreth 118.7 miliardë lekë, me një realizim prej rreth 99.2 përqind kundrejt planit të periudhës. Përkatësisht, shpenzimet për Sigurime Shoqërore u realizuan në masën rreth 86.9 miliardë lekë dhe shpenzimet për sigurime shëndetësore në rreth 28.1 miliardë lekë. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2016, shpenzimet për sigurime shoqërore janë rreth 5.16 miliardë lekë më të larta, ndërsa shpenzimet për sigurime shëndetësore janë rreth 3.06 miliardë lekë më shumë.

Grafiku 26: Shpenzimet për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore (në miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet për Papunësinë për 9 mujorin 2017 janë realizuar në masën rreth 81.9 përqind e planit të periudhës ose 45.2 përqind e planit vjetor, të ndryshuar. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2016 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën rreth 49.1 përqind, ose 261 milion lekë në terma nominalë.

Shpenzimet për Ndhimën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK) në 9 mujorin 2017 u realizuan në masën rreth 98.1 përqind ose 283 milion lekë më pak kundrejt planit të periudhës. Në raport me planin vjetor ato janë realizuar në masën 71 përqind të tij. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2016 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën rreth 11.5 përqind ose 1.5 miliardë lekë më shumë në terma nominalë.


Grafiku 27: Shpenzimet për Ndhimën Ekonomike, PAK dhe Papunësinë (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet për Pushtetin Vendor, gjatë periudhës 9 mujore kanë përbërë rreth 13.6 përqind të shpenzimeve korente. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2016 ky nivel rezulton rreth 11.75 miliardë më i lartë ose 45.1 përqind më shumë. Kjo rritje vjen në kuadër të përforcimit të rolit të njësive të reja/të riorganizuara të qeverisjes vendore.

Grafiku 28: Shpenzimet e Pushtetit Vendor dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet kapitale, në vijim të analizës së ecurisë së realizimit të investimeve publike, për 9 mujorin e parë të vitit 2017 është konstatuar një realizim në masën rreth 39.7 miliardë lekë ose rreth 90.5 përqind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Respektivisht, projektet e investimeve me financim të brendshëm kanë shënuar një realizim në masën rreth 25.1 miliardë lekë ose 90.65 përqind të planit të periudhës, investimet nga të ardhurat e Arsimit të Lartë shkojnë në masën 416 milionë lekë, ndërkohë që

ato me financim të huaj janë realizuar në masën rreth 14.2 miliardë lekë ose rreth 90.7 përqind të planit të periudhës.


Krahasuar me planin vjetor, për 9 mujorin e parë të vitit 2017 është konstatuar një realizim i përgjithshëm i investimeve publike në masën rreth 39.7 miliardë lekë ose rreth 53.6 përqind e tyre. Financimi i brendshëm dhe financimi i huaj janë realizuar respektivisht në masën rreth 52.6 përqind dhe rreth 55.9 përqind të planit vjetor.

Grafiku 29: Shpenzimet Kapitale dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)


Grafiku 30: Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Grafiku i mëposhtëm paraqet ndarjen e shpenzimeve publike faktike për 9 mujorin e parë të vitit 2017. Shpenzimet korente për këtë periudhë përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve totale faktike me 87.5 përqind, kurse shpenzimet kapitale përbëjnë 12.5 përqind.


Grafiku 31: Detajimi i Shpenzimeve Buxhetore (në milion lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Sikurse evidentohet nga tabela e treguesve fiskal të konsoliduar, realizimi i shpenzimeve të përgjithshme është rreth 320 miliardë lekë ose rreth 97.8 përqind kundrejt planit të periudhës. Kjo situatë është shoqëruar me një deficit buxhetor prej 462 milion lekë. Grafiku i mëposhtëm tregon tendencat pozitive të treguesve kryesorë të buxhetit të shtetit.

Grafiku 32: Të ardhurat, shpenzimet dhe deficitit/suficitit - Plan vs Fakt 2017 (në milion lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

BUXHETI VENDOR

TË ARDHURAT E PUSHTETIT VENDOR

Për 9 mujorin e parë të vitit 2017, njësitë e vetëqeverisjes vendore në nivel kombëtar kanë mbledhur të ardhura (tatimore dhe jo-tatimore) në masën 15.4 miliard lekë dhe krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë janë 4 miliard lekë më shumë ose 33 për qind më e lartë. Në mënyrë krahasimore në tabelën e mëposhtme paraqiten nivelet e të ardhurave sipas taksave për të njëjtën periudhë për disa vite.

Grafiku 33: Të ardhurat sipas burimit për njësitë vendore




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Të ardhurat e qeverisjes vendore ndër vite kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu dhe në strukturë. Taksat lokale gjenerojnë pjesën më të madhe të të ardhurave vendore me rreth 72.3 % të vlerës totale të tyre. Kjo konfirmon edhe një herë që procesi i decentralizimit kryesisht në vitin 2016 ka dhënë një efekt shumë pozitiv duke bërë që njësitë e vetëqeverisjes vendore të mbledhin më shumë të ardhura dhe sigurisht të ofrojnë më shumë shërbime dhe investime publike. Pas kësaj takse pjesën më të madhe të të ardhurave e zënë ato që vijnë nga taksa mbi pasurinë, afërsisht rreth 4 miliard lekë ose 26 % të totalit të të ardhurave.

Parë në këtë këndvështrim, rritja e efektshmërisë së mbledhjes së taksave nga qeverisja vendore bën të mundur që njësitë të sigurojnë një nivel më të lartë decentralizimi dhe burimesh financiare për të ofruar shërbime dhe investime më të mira vendore. Nëse do të referohemi zërave të të ardhurave në raport me 9 mujorin e një viti më parë konstatojmë se rritjen më të madhe e ka zëri i të ardhurave nga Taksa Lokale i cili është rritur me rreth 3.9 miliard lekë ose në shifër relative 53% më shumë. Në të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël vihet re një rënie raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Megjithatë, kjo takse nuk ka peshë të lartë në të ardhurat vendore prandaj edhe efekti nga rënia nuk ka ndikim në ecurinë fiksale të pushtetit vendor për 9 mujorin e vitit 2017. Nga ana tjetër taksa mbi pasurinë në 9 mujorin e 2017 ka patur një rritje në raport me një vit më parë, e cila mbetet në nivelet e 5% më e lartë ose 182 milion lekë më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Grafiku 34: Të ardhurat totale nga pushteti vendor




Burimi: Ministria e Financave (2017)

Nga analiza 9 mujore konstatohet që, në tërësi qeverisja vendore ka rritur peshën e të ardhurave të veta vendore në raport me të ardhurat në tërësi. Rritja e të ardhurave të veta lokale është tregues thelbësor i faktit që rritja e autonomisë dhe decentralizimit të tyre ka rritur përgjegjësinë dhe efektshëmërinë fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Taksa mbi Pasurinë

Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të pushtetit vendor. Për 9 - mujorin e vitit 2017 kjo taksë është mbledhur në vlerën 4 miliardë lekë, ose rreth 182 milion lekë më shumë se 9 - mujori i vitit 2016. Parë në këndvështrimin e efencës, mbledhja e kësaj takse është përmirësuar në raport me një vit më parë. Gjithashtu, në kuadër të procesit të reformimit të kësaj takse duke ndryshuar legjislacionin dhe ngritur kadastrën fiskale nga kjo taksë pritet që në vitin 2018 të rriten të ardhurat me 2.8 miliard lekë më shumë se sa në vitin 2017 duke u bërë kështu një zë të rëndësishëm i të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Grafiku 35: Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave (2017)

Taksa e biznesit të vogël

Të ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogël, për 9 mujorin e vitit 2017 janë realizuar në masën 262 milionë lekë, shifër kjo që vjen me një ulje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo ulje vjen si rezultat i ndryshimeve të prezantuara në fundin e vitit 2015, ku subjektet me një xhiro nga 0-5 milionë

lekë janë përjashtuar nga detyrimi tatimor ndërsa ato me xhiro 5-8 milionë kanë përfituar një reduktim me 2.5% të detyrimit, ndryshime të cilat kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin e klimës së biznesit. Megjithatë këto me ndryshime u shoqëruan me masa për kompensimin e këtyre të ardhurave për qeverisjen vendore.

Grafiku 36: Të ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogël




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Taksa lokale

Të ardhurat nga taksat lokale rezultojnë me një rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë. Për 9 - mujorin 2017 këto taksa janë mbledhur në vlerën rreth 11.1 miliardë lekë, ose rreth 3.9 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e një vitit më parë. Rritja e kapaciteteve të krijuara nga njësitë e reja dhe kontrolli më i mirë i shtrirjes territoriale ka rritur mbledhshmërinë e këtyre taksave duke ndikuar pozitivisht në qëndrueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Grafiku 37: Të ardhurat nga taksat lokale



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017);


SHPENZIMET E QEVERISJES VENDORE

Shpenzimet e qeverisjes vendore janë një tregues i rëndësishëm i procesit të menaxhimit të financave publike në nivel vendor dhe tendencave zhvillimore të ekonomisë në tërësi. Ndër vite shpenzimet e qeverisjes vendore janë një tregues në rritje dhe kjo vjen si pasojë e rritjes së nivelit të shërbimeve dhe funksioneve që qeverisja vendore ofron për qytetarët e saj të financuara nëpërmjet rritjes së të ardhurave vendore dhe mbështetjes financiare nga qeveria. Rritja e kompetencave dhe hapësirës administrative ka

bërë që tashmë njësitë e vetëqeverisjes vendore të rrisin përgjegjësinë, transparencën dhe konsultimin publik në përdorimin e financave publike vendore.

Buxheti vendor ndër vite ka një rritje të dukshme që është rrjedhojë e decentralizimit fiskal në aspektin e mbledhjes dhe përdorimit në mënyrë autonome të të ardhurave dhe rritjes së transfertave nga qeveria. Kjo reflektohet edhe në nivelin e shpenzimeve për 9 mujorin e vitit 2017, në raport me atë të vitit 2016. Nga grafiku i mëposhtëm kuptohet qartë që buxheti i qeverisjes vendore është rritur me afërsisht 11.7 miliard lekë, ndër të cilat shpenzimet kapitale janë ato që kanë ndikimin më të lartë për shkak të rritjes me 6.3 miliardë lekë më shumë së e njëjta periudhë e një vitit më parë. Gjithashtu, konstatohet një rritje e shpenzimeve të personelit për këtë periudhë.


Grafiku 38: Shpenzimet për pushtetin vendor dhe ritmi i rritjes së tyre



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet e pushtetit vendor sipas zërave kanë pësuar luhatje të ndjeshme në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016. Duke ju referuar grafikut të mëposhtëm, konstatohet se në raport me 9 mujorin i vitit 2016 kemi një rritje prej 6.3 miliard lekë të shpenzimeve kapitale shifër kjo e konsiderueshme për strukturën e shpenzimeve të qeverisjes vendore. E thënë ndryshe, shpenzimet për investime publike janë pothuajse dyfishuar në raport me 9-mujorin e vitit 2016. Gjithashtu konstatohet që në vitin 2017 shpenzimet e personelit kanë pësuar një rritje të ndjeshme në raport me një vit më parë. Kjo ka ardhur për arsye të transferimit të funksioneve në qeverisjen vendore si dhe si efekt i rritjes së pagave që nisi në muajin mars të vitit 2017. Tendencat e rritjes së shpenzimeve për investime tregojnë qartë që shumë shpejt kjo do të shoqërohet me efekte të drejtpërdrejta pozitive në punët publike dhe cilësinë e shërbimeve të cilat ndikojnë në jetën e qytetarëve.

Grafiku 39: Shpenzimet e qeverisjes vendore sipas strukturës



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Pas miratimit dhe jetësimit të reformës administrativo-territoriale janë bërë analiza periodike të ecurisë së shpenzimeve vendore në raport me shpenzimet para reformës, kryesisht në termat e tendencës së shpenzimeve të personelit dhe atyre kapitale. Krahasuar me vitin 2014 si vit para reformës konstatohet se ka një ndryshim të strukturës së shpenzimeve në favor të rritjes së shpenzimeve kapitale. Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur tabela e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore midis të njëjtës periudhë të vitit 2017 dhe 2016.

Tabela 22: Të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisjes vendore sipas natyrës

Të dhëna progresive (në milion LEK)

Nr	E M Ë R T I M I	Fakt 9 mujori		Diferenca	
		2017	2016	2017 / 2016	% e 2017 kundrejt 2016
I.	Të ardhura nga Pushteti vendor	15,358	11,624	3,734	132%
I.1	<i>Taksa mbi pasurinë</i>	4,009	3,827	182	105%
I.2	<i>Taksa e biznesit të vogël</i>	262	565	-303	46%
I.3	<i>Taksa Lokale</i>	11,087	7,232	3,855	153%
II.	Shpenzime nga Pushtetit Vendor	37,795	26,047	11,748	145%
II.1	Shpenzime Korente	24,123	18,672	5,451	129%
	<i>Personeli</i>	14,890	11,538	3,352	129%
	<i>Shpenzime Oper. Mirmbajtje</i>	8,346	6,589	1,757	127%
	<i>Interesa</i>	33	36	-3	92%
	<i>Subvencione</i>	428	72	356	594%
	<i>Te tjera</i>	426	437	-11	97%
II.2	Shpenzime Kapitale	13,672	7,375	6,297	185%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Shpenzimet e Personelit, përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të njërive të vetëqeverisjes vendore. Për 9 mujorin e vitit 2017, këto shpenzime janë realizuar në masën 14.8 miliard lekë ose rreth 3.3 miliard lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2016. Rritja e këtyre shpenzimeve për vitin 2017, argumentohet me faktin se në buxhetin e vitit 2017 u sistemua shtimi i buxhetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore për arsye të problematikave të shfaqura në financimin për funksionet e transferuara në vitin 2016. Në buxhetin e vitit 2017, në vijim të konsolidimit të funksioneve të decentralizuara në vitin 2016, u shtua numri i punonjësve për funksione si: shërbimi i mbrojtjes nga zjarri (zjarrëfikës) në 15 bashki, administrimi i pyjeve (roje pylli), drejtues dhe mirëmbajtës të eskavatorëve në të gjitha bashkië etj. Gjithashtu gjatë vitit 2017, edhe në nivel vendor është zbatuar politika e rritjes së pagave e cila ka pasur efekte në rritjen e shpenzimeve të personelit. Po ashtu shtimi i investimeve e për rrjedhojë shtimi i asetëve vendore kanë kërkuar në njësitë respektive edhe shtim të shpenzimeve të personelit me qëllim ofrimin e shërbimit sa më afër qytetarëve. Nëse bëjmë abstragimin nga faktorët e mësipërm shpenzimet për personelin për 9 mujorin e vitit 2017 do të rezultojnë në të njëjtin nivel me ato të 9 mujorit të vitit 2016.

Shpenzimet Operative, të cilat janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve, rezultojnë me një luhatje të lehtë në 9 mujorin e parë vitit 2017 në krahasim më të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shpenzimet operative përbëjnë rreth 34.6% të shpenzimeve korrente në total për 9 mujorin e parë të vitit 2017 dhe 35.2% të këtyre shpenzimeve për vitin 2016. Në vlerë absolute në 9 mujorin e vitit 2017 janë shpenzuar rreth 8.3 miliard lekë ose e thënë ndryshe rreth 1.7 miliard lekë më shumë se në të

njëjtën periudhë të një vitit më parë. Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e nivelit të shpenzimeve operative janë të lidhura me rritjen e numrit të punonjësve për funksionet e transferuara në vitin 2016, përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike vendore, si dhe shtimin e aseteve të ndryshme nga investimet që kërkojnë shpenzime për ruajtje dhe mirëmbajtje. Por nga ana tjetër vihet re tendenca pozitive e uljes nga viti në vit i peshës që zënë shpenzimet operative në totalin e shpenzimeve korrente.

Shpenzimet për interesa, subvencione dhe të tjera, janë shpenzimet që zhvillojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për të paguar interesat, për të subvencionuar politikat e ndryshme vendore dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Në këto kushte nga sa përcaktohet në tabelën mësipër në raport me 9 mujin e vitit 2016, këto shpenzime në 9 mujin e vitit 2017 kanë rritje në të tre zërat duke paraqitur në këtë mënyrë një tendencë të përgjithshme rritje të shpenzimeve. Këto ndryshime janë rezultat i procesit të riorganizimit dhe të shtrirjes së re që ka marrë njësitë e vetëqeverisjes vendore ku nën juridiksionin administrativ tashmë përmban më shumë përgjegjësi për të ushtruar. Njësitë e reja të vetëqeverisjes vendore duhet në të ardhmen të kenë strategji afatgjata në ofrimin e shërbimeve publike sa më afër qytetarëve, në mënyrë të tillë që efienca e ofrimit të shërbimit të rritet ndjeshëm.

Shpenzimet Kapitale, janë një zë mjaft i rëndësishëm jo vetëm për faktin që përbëjnë pjesën më të madhe të buxhetit vendor por edhe për shkak se këto shpenzime janë ato që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen ekonomike dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve. Nga tabela e mësipërme vëmë re që në krahasim me 9 mujin e vitit 2016, gjatë të njëjtës periudhë në vitin 2017 shpenzimet për investime janë dyfishuar duke rregjistruar një rritje me rreth 6.3 miliardë lekë. Kjo rritje e konsiderueshme shpenzimeve për investime është një nga efektet më pozitive që sjell reforma administrativo-territoriale.

Në periudhë afatgjatë vazhdimi i kësaj tendence rritëse të shpenzimeve për investime nga njësitë e vetëqeverisjes vendore do të sigurojë vepra infrastrukturore dhe punë publike në interes dhe favor të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Treguesit fiskal të qeverisjes vendore të 9-mujorit të vitit 2017, premtojnë një optimizëm për vazhdimësinë e tyre pozitive edhe për muajt e mbetur të vitit buxhetor 2017. Si rrjedhojë, parashikohet që edhe për vitin 2018 njësitë e vetëqeverisjes vendore të kenë një buxhet më të plotë financiarisht dhe më të konsoliduar në proceset e menaxhimit të financave të tyre.

8.4 ECURIA E BORXHIT PUBLIK PËR 9-MUJORIN 2017

Borxhi publik gjatë periudhës Janar-Shtator 2017 është karakterizuar nga një ecuri pozitive, kryesisht në aspektin e plotësimit të nevojave të Qeverisë për likuiditet, në aspektin e përmirësimit të raporteve ndërmjet kostos dhe riskut, si dhe në aspektin e aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të zhvillimit të tregut primar dhe krijimit të kushteve për zhvillimin e tregut sekondar.

Në fund të muajit shtator 2017 borxhi i Qeverisjes Qendore vlerësohet në vlerën 1,074.9 miliard Lek ose 69.11% e PBB⁶. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, niveli i borxhit të Qeverisjes Qendore në raport me PBB ka shënuar një rënie prej 3.33 pikë përqindje. Rënia e nivelit të borxhit në raport me PBB i atribuohet parashikimeve të rritjes ekonomike, planifikimit të balancës primare pozitive si edhe rënies së kursit të këmbimit EUR/LEK.

Në terma nominal stoku i borxhit të Qeverisjes Qendore është rritur me rreth 9.2 miliard Lek krahasuar me fundin e vitit 2016, nga të cilat 13.4 miliard Lek i korrespondojnë rritjes së borxhit të brendshëm dhe -4.3 miliard Lek borxhit të jashtëm. Borxhi i jashtëm paraqitet me rënie kryesisht për shkak të mbiçmimit

⁶ PBB mbi bazë vjetore; referuar Draft Kuadrit Makroekonomik 2019-2021, datë 14.10.2017.

të monedhës vendasë në raport me monedhën Euro. Rritja e borxhit në terma nominal është brenda kufijve të parashikuara në ligjin vjetor të buxhetit dhe në përputhje me objektivat afatmesme makro-fiskale për uljen e nivelit të borxhit në raport me PBB.

Duke iu referuar deficitit buxhetor të planifikuar, parashikimeve të rritjes ekonomike dhe supozimeve të kursit të këmbimit, në fund të vitit 2017 borxhi i Qeverisjes Qendore në raport me PBB pritet të ulet me rreth 2.5 pikëpërqindje krahasuar me vitin e kaluar, duke vazhduar tendencën rënëse, e cila ka nisur që në vitin 2016.

Tabela 23: Ecuria e stokut të borxhit të Qeverisjes Qendrore

(në milion Lek)

	2013	2014	2015	2016	Sht-17
Stoku Borxhit të Qeverisjes Qendrore	884,692	977,102	1,042,272	1,065,709	1,074,868
I. Stoku i Borxhit të Brendshëm	520,786	564,674	551,375	561,120	574,545
<i>Shtetëror</i>	500,868	538,641	520,936	530,834	544,371
<i>Garantuar</i>	19,918	26,033	30,439	30,286	30,174
II. Stoku i Borxhit të Jashtëm	363,906	412,429	490,897	504,589	500,323
<i>Shtetëror</i>	332,500	383,922	465,306	481,407	479,718
<i>Garantuar</i>	31,406	28,507	25,591	23,182	20,605
Prodhi i Brendshëm Bruto	1,350,053	1,395,305	1,427,799	1,472,791	1,555,202
Borxhi i Qeverisjes Qendrore/PBB	65.53%	70.03%	73.00%	72.36%	69.11%
Borxhi i Brendshëm/PBB	38.58%	40.47%	38.62%	38.10%	36.94%
Borxhi i Jashtëm/PBB	26.95%	29.56%	34.38%	34.26%	32.17%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Huamarrja e brendshme

Huamarrja gjatë nëntëmuorit 2017 është realizuar me sukses, duke mundësuar rifinancimin e borxhit ekzistues, mbulimin e nevojave të Qeverisë për likuiditet dhe financimin e planifikuar të deficitit buxhetor.

Në tregun e brendshëm janë emetuar tituj në vlerën 265.3 miliard Lek, nga të cilat 251.5 miliard Lek kanë shërbyer për rifinancimin e titujve ekzistues dhe 13.8 miliard Lek për financimin e deficitit buxhetor të planifikuar. Financimi i brendshëm neto është realizuar plotësisht nëpërmjet titujve afatgjatë, ndërkohë që është shoqëruar dhe me maturim të titujve afatshkurtër, në përputhje me objektivat strategjike për uljen e ekspozimit ndaj risqeve. Rol të rëndësishëm në realizimin e këtij objektiivi kanë pasur emetimet e suksesshme dhe në vlera të konsiderueshme të obligacioneve 7 dhe 10 vjeçare.

Tabela 24: Financimi i brendshëm sipas titujve shtetërorë

(në milionë lekë)

Tituj Shtetërorë	Financim bruto (9m-2017)		Financim neto (9m-2017)	
	Në milion Lek	Në %	Në milion Lek	Në %
Financimi Gjithsej	265,274.24	100.00%	13,810.80	100.00%
Instrumenta Afatshkurtër	179,793.01	67.78%	-7,955.01	-57.60%
- <i>Bono Thesari</i>	179,793.01	67.78%	-7,955.01	-57.60%
Instrumenta Afatgjatë	85,481.23	32.22%	21,765.81	157.60%
- <i>Obligacione 2 vjeçare</i>	46,693.07	17.60%	5,524.56	40.00%
- <i>Obligacione 3 vjeçare</i>	2,999.90	1.13%	-2,246.70	-16.27%
- <i>Obligacione 5 vjeçare</i>	19,500.00	7.35%	2,199.70	15.93%
- <i>Obligacione 7 vjeçare</i>	7,812.24	2.94%	7,812.24	56.57%
- <i>Obligacione 10 vjeçare</i>	8,476.02	3.20%	8,476.02	61.37%


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Kostot dhe Risqet

Gjatë periudhës janar-shtator 2017, ka vazhduar tendenca e uljes së kostos së borxhit dhe përmirësimit të treguesve të riskut. Shërbimi i borxhit ka rezultuar me ulje gjatë kësaj periudhe kryesisht si rezultat i efektit që ka dhënë rënia e normave të interesit gjatë vitit 2016 dhe viteve paraardhëse.

Struktura e borxhit ka shfaqur përmirësim, kryesisht në aspektin e reduktimit të ekspozimit ndaj riskut të rifinancimit dhe riskut të normave të interesit. Përmirësimi i risqeve është i lidhur ngushtë me rritjen e peshës së borxhit afatgjatë dhe me reduktimin e borxhit afatshkurtër.

Grafiku 40: Jetëgjatësia mesatare (DMM) dhe kosto mesatare e borxhit të brendshëm (YMP)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Kostot

Krahasuar me periudhën janar-shtator 2016, shpenzimet për interesa të Borxhit Shtetëror⁷ ranë me 4.1 miliard Lek, duke u vlerësuar në 21.6 miliard Lek ose 1.39% e PBB⁸. Reduktimi i shpenzimeve për interesa i atribuohet efektit të rënies së normave të interesit në tregun e brendshëm (*kryesisht gjatë tre viteve paraardhëse për Obligacionet dhe gjatë vitit 2016 për Bonot e Thesarit*), si edhe zëvendësimit të borxhit që maturohet me borxh me norma interesi më të favorshme.

Grafiku 41: Shërbimi i Borxhit Shtetëror




⁷ Përfshihen edhe interesat që janë paguar nga buxheti i shtetit për huatë për të cilat është lëshuar Garanci Shtetërore.

⁸ PBB mbi bazë vjetore; referuar Draft Kuadrit Makroekonomik 2019-2021, datë 14.10.2017.

Nga analizat e realizuara rezulton se nga rënia e normave të interesit në tregun e brendshëm gjatë vitit 2016, buxhetit të shtetit i janë kursyer rreth 3 miliard Lek në vitin aktual. Nga ana tjetër kosto e borxhit të brendshëm për njësi (*yield-i mesatar i ponderuar*) gjatë vitit 2017 është ulur me 0.02 pikë përqindje krahasuar me fundin e vitit 2016, megjithëse në portofolin e borxhit është rritur ndjeshëm pesha e borxhit afatgjatë, duke reflektuar një përmirësim të ndjeshëm në raportin ndërmjet kostos dhe riskut.

Grafiku 42: Kosto mesatare e borxhit të brendshëm shtetëror dhe borxhi afatshkurtër vs afatgjatë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Risqet


Risku i rifinancimit është përmirësuar ndjeshëm pasi në harkun kohor të nëntë muajve jetëgjatësia e borxhit është rritur me 44 ditë duke prekur nivelin e 797 ditëve në fund të muajit shtator 2017, krahasuar me 753 ditë në dhjetor 2016. Ndërkohë, vlera e instrumenteve që maturohen në harkun kohor të një viti është ulur nga 53.5% në dhjetor 2016 në 48.7% në shtator 2017.

Risku i normave të interesit gjithashtu është përmirësuar, pasi pesha e instrumenteve që rivlerësojnë normën e interesit në harkun kohor të një viti është ulur nga 62.6% në dhjetor 2016 në 56.3% në shtator 2017. Në këtë drejtim, ndikim ka pasur reduktimi i peshës së titujve afatshkurtër dhe atyre me norma interesi të lëvizshme në portofolin e borxhit të brendshëm, përkatësisht me 2.4 pikë përqindje dhe 2.9 pikë përqindje. Ulja e ekspozimit ndaj këtij risku ka ulur ndjeshmërinë e borxhit ndaj goditjeve të normave të interesit, duke reduktuar burimet që Qeveria duhet të angazhojë në raste të tilla.

Zhvillimet e tregut primar

Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë nëntëmujorit 2017 përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive, ndër të cilat mund të përmenden: i) kërkesa e tregut për tituj shtetërorë në nivele të kënaqshme, e cila ka arritur të mbulojë nevojat e Qeverisë për huamarrje; ii) rritja e diversifikimit të kërkesës në drejtim të kategorisë së Institucioneve Financiare dhe Institucioneve jo Financiare dhe; iii) qëndrimi i normave të interesit në nivele të krahasueshme me ato të vitit 2016.

Grafiku 43: Kërkesa për tituj shtetërorë sipas investitorëve



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Kërkesa në rritje për tituj shtetërorë në kategorinë e Institucioneve Financiare dhe jo Financiare ka qenë e lartë për shkak të normave të interesit më të favorshme që ofrojnë titujt shtetërorë krahasuar me depozitat. Ndërkohë kërkesa e lartë nga Sektori Bankar vjen si rezultat i riskut më të ulët që ofrojnë titujt shtetërorë krahasuar me kreditë ndaj sektorit privat. Ulja e kërkesës për tituj shtetërorë nga BSH është në linjë me iniciativën për uljen e volumit të titujve shtetërorë të tregtuar me norma interesi jokonkurrese në tregun primar, me qëllim stimulimin e zhvillimit të tregut sekondar. Ndërkohë, ulja e kërkesës në kategorinë e Individëve vlerësohet se është shkaktuar nga rënia e interesit për tituj shtetërorë, për shkak të nivelit të ulët të normave që ofron investimi në instrumente financiare gjatë kësaj periudhe.


Tabela 25: Treguesit e ecurisë së ankandeve

Periudha	Treguesi	B.Thesari	Obligacione	Gjithsej
9M. 2017	Nr i ankandeve	26	20	46
	Kërkesa (në mld Lek)	230.8	124	354.8
	Oferta (në mld Lek)	188.3	90.4	278.7
	Raporti i mbulimit	1.23	1.37	1.27
9M. 2016	Nr i ankandeve	32	25	57
	Kërkesa (në mld Lek)	247.6	108.6	356.2
	Oferta (në mld Lek)	209.2	80.2	289.4
	Raporti i mbulimit	1.18	1.35	1.23

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Gjatë nëntëmujorit 2017 kërkesa për tituj shtetërorë ka rezultuar në vlerën 354.8 miliard Lek, nga të cilat 230.8 miliard Lek i përkasin Bonove të Thesarit dhe 124.0 miliard Lek Obligacioneve. Kërkesa gjatë nëntëmujorit ka qenë relativisht më e lartë se oferta e Qeverisë për tituj shtetërorë duke rezultuar në një raport mbulimi prej 1.27. Gjithsej gjatë nëntëmujorit janë realizuar 46 ankande, nga të cilat vetëm në 13 ankande nuk është plotësuar oferta e Qeverisë.

Grafiku 44: Raporti i mbulimit të ankandëve të titujve shtetërorë



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Normat mesatare të ponderuara (me përjashtim të normave të Obligacioneve 3 dhe 10 vjeçare) kanë pësuar një rritje të moderuar krahasuar me ato të vitit 2016. Megjithatë, kjo rritje ka qenë brenda pritshmërive dhe nuk ka pasur ndikim në koston mesatare të portofolit të borxhit të brendshëm, pasi në fund të muajit shtator kosto mesatare vlerësohet pothuajse në të njëjtat nivele me fundin e dhjetorit 2016 (përkatësisht 4.35% dhe 4.37%).

Grafiku 45: Kurba e yield-it për titujt shtetërorë




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Pjerrësia pozitive e kurbës së normave të interesit tregon se ka pritshmëri për rritje të normave të interesit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Borxhi i jashtëm

Borxhi i jashtëm shtetëror gjatë nëntëmuajorit 2017 paraqitet i qëndrueshëm duke pësuar disa ndryshime relativisht të vogla në drejtim të kompozimit të monedhave, dhe peshës së stokut sipas koncesionalitetit. Në fund të muajit shtator 2017 pjesa më e madhe e portofolit të borxhit të jashtëm shtetëror është e përbërë nga tre monedha kryesore (EUR, USD, JPY), ku peshën më të madhe e mban monedha Euro me 65.8 % të portofolit.

Grafiku 46: Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas monedhave



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Përqindja e lartë e stokut në Euro është në përputhje me objektivat strategjike për huamarrje në monedhën Euro dhe në përputhje me aspiratat e vendit tonë për t'u integruar në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, gjatë viteve të fundit politikat monetare dhe dinamikat e ekonomisë vendase kanë arritur të sigurojnë një qëndrueshmëri dhe stabilitet të kursit të këmbimit të monedhës vendase ndaj monedhës Euro.

Ecuria e disbursimeve gjatë nëntëmuajorit 2017, ka qenë e kënaqshme dhe relativisht më e lartë se vitin e kaluar. Gjithsej janë disbursuar rreth 273.1 milion Euro, nga të cilat 146.1 milion Euro janë disbursime në formën e mbështetjes buxhetore, të akorduara në kuadër të marrëveshjes me FMN dhe Bankën Botërore. Diferenca prej 126.9 milion Euro i përket disbursimeve të projekteve me financim të huaj. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, rezulton se në vitin 2017 ecuria e disbursimeve ka qenë rreth 26.4 milion Euro ose 10.7% më e lartë. Nëse përjashtojmë disbursimet e akorduara për mbështetje buxhetore, rezulton se disbursimet për projektet me financim të huaj janë rreth 33.4 milion Euro më të larta se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Sektorët që kanë pasur ecurinë më të lartë të disbursimeve janë sektori i Transportit, Ujësjetës Kanalizime dhe ai i Energjisë, përkatësisht me 19.8%, 12.5% dhe 7.0% të totalit të disbursimeve.

Tabela 26: Disbursimet e borxhit të jashtëm të Qeverisë Qendrore

Disbursime të Borxhit Shtetëror	Jan.2016-Sht.2016		Jan.2017-Sht.2017	
	Në mln EUR	Në %	Në mln EUR	Në %
Disbursime Gjithsej	246.7	100.0%	273.1	100.0%
I. Financim Projektsh	93.5	37.9%	126.9	46.5%
-Energjia	18.1	7.3%	19.1	7.0%
-Transporti	30.1	12.2%	54.0	19.8%
-Ujësjetës Kanalizime	27.8	11.3%	34.1	12.5%
-Infrastruktura Urbane	13.7	5.6%	17.2	6.3%
-Të tjera	3.9	1.6%	2.5	0.9%
II. Mbështetje Buxhetore	153.2	62.1%	146.1	53.5%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017)

Një nga çështjet që mbetet për t'u adresuar në vijim është ajo e lidhur me vlerën e lartë të projekteve të padisbursuara (rreth 1.3 miliard Euro), të akumuluar ndër vite kryesisht për arsye si:

- Performanca e dobët e kontraktorëve;
- Ndryshimet e bëra në projektet fillestare për shkak të problematikave të hasura gjatë zbatimit të projekteve;

- Kushtet natyrore dhe atmosferike (*sidomos në projektet e infrastrukturës*);
- Proceset e tejzgjatura të shpronësimeve;
- Vonesat e shkaktuara nga kreditorët në dhënien e aprovimeve;
- Mungesa e bashkërendimit mes institucioneve, për dhënien e lejeve të ndërtimit, për menaxhimin e mbetjeve që dalin nga ndërtimet, për marrjen në dorëzim të objekteve, etj.

Në marrëdhënie me kreditorët e huaj Republika e Shqipërisë vazhdon të mbajë marrëdhënie të qëndrueshme duke paraqitur një nivel bashkëpunimi të lartë dhe duke përcjellë besim tek kreditorët nëpërmjet likuidimit të detyrimeve të saj në kohë.

8.5 LISTA E KONCESIONEVE/PPP

Tabela 27: Lista e Kontratave Koncesionare/PPP aktive (ekzistuese+parashikim 2018)

Kategoria	Lloji	Objekti i Kontratës	Vlera e kontrates
Total			504,877,137,243
Sektori i Mjedisit			25,488,716,407
	Kontrate Sherbimesh		49,660,000
		Menaxhimi dhe zhvillimi teknologjik i prodhimit të fidanëve pyjor/arror në Fidanishten Shtetërore të Cërrikut, Elbasan	49,660,000
	Ndertim, Operim, Transferim		24,935,343,761
		Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të përpunuar të mbetjeve urbane të qarkut Elbasan	2,894,400,000
		Për ndërtimin e administrimin e Impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë	3,666,177,561
		Inceneratori i Tiranës	18,374,766,200
	Shfrytezim		503,712,646
		Shfrytezimi i Burimit ujor "Sasaj, Bunec", Sarandë	503,712,646
Sektori i Transportit			37,513,358,873
	Kontrate Sherbimesh		1,354,539,000
		Menaxhimi, Operimi, Mirembajtja, Përmiresimi teknik dhe Adaptimi i	555,162,000

		terminalit të trageteve dhe krocerave Durrës.	
		Projektim, financim, rehabilitim, testim, shfrytëzim dhe mirembajtje të Qendrave të Kontrollit Teknik të mjeteve.	561,003,000
		Dhënie me koncesion të shërbimeve detare.(ASHD),	238,374,000
	Ndertim, Operim, Transferim		36,158,819,873
		Menaxhimi, operimi, mirembajtja dhe pëmirësimi teknik i terminalit të konteinerve në portin e Durrësit	3,705,000,000
		Ndërtim, Shfrytëzim dhe Transferim në pronësi të shtetit, të Portit të Jahteve Shëngjin	730,338,000
		Ndërtimi i portit të jahteve në Kalanë e Turrës, Komuna Synej, Kavajë.	4,450,000,000
		Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi i Aeroportit "Nënë Tereza"	9,310,000,000
		Ndërtimi, Operimi, Transferim i parkimit nëntokësor në parkun "Rinia", Tiranë	1,937,932,800
		Ndërtimi, përmirësimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e Autostradës Milot-Morinë	2,005,314,422
		Ndërtimi, shfrytëzimi i portit të jahteve në qytetit e Durrësit. (BOT)	1,356,144,750
		Ndërtimi, Shfrytëzimi dhe Transferimi të portit të tipit MBM, Porto Romano, Durrës	1,162,800,000
		Operimi, Ndërtimi,	2,069,371,737

		Mirëmbajtja, Përmiresimi Teknik dhe Adaptimi i Terminalit Lindor Durrës.	
		Ndërtim, operim dhe transferim Infrastruktura Hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë	2,431,918,164
		Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese	7,000,000,000
Spektori i Bujqesise			1,906,500
	Ndërtim, Operim, Transferim		1,906,500
		Kontratë Koncesioni për kultivimin e ullirit deri në 1000 ha, Kavajë	1,906,500
Spektori i Energjise			379,478,818,639
	Ndërtim, Operim, Transferim		379,478,818,639
		Financimi, Projektimi, Ndërtimi, Vënia në Punë, Administrimi, Mirëmbajtja dhe Transferimin e Hidrocentraleve "Shkallë", "Cerrujë", "Plesha", "Bejni1", "Bejni2", "Klos".	1,465,039,743
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve Gjuraj, Kashec, Ragam dhe Lepurushe	780,000,000
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve mbi Lumin Kardhiq	1,041,453,039
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve mbi Përroit Ujëmbledhës të Përroit të Zhejës	61,916,210
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve në Pellgun Ujëmbledhës	1,165,964,018

	të Shmilit dhe Zallit të Gjurait, Rrethi Librazhd	
	Ndertimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve RAPUN 3, RAPUN 3A dhe RAPUN 4	790,361,250
	Ndertimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve TREBINJA 1, TREBINJA 2, POTGOZHAN, KALIVAÇ dhe DUNICE	175,585,602
	Ndertimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve, Cemerica 1, Cemerica 2 dhe Cemerica 3	300,673,715
	Ndertimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit ARSTI	225,125,130
	Ndertimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Begaj	2,794,366,000
	Ndertimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Egnatia	321,956,600
	Ndertimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit KALIVAR	465,326,140
	Ndertimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Lingjaca	149,524,860
	Ndertimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit QYTEZË	27,700,000
	Ndertimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit VILIQ	199,260,305
	Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentralit LLËNGË	252,559,542
	Ndërtim, operim dhe transferim e hidrocentraleve SHEBA 1, SHEBA 2, SHEBA 3 dhe SHEBA 4	416,000,000
	Ndërtim, operim dhe transferim Hec Holta Kabash dhe Holta Porocan	500,000,000

		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve GERMANI 1, 2, 3, 4 dhe 5	348,238,001
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve mbi Lumin SETA	1,400,805,550
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve PRELLE 1 dhe PRELLE 2	1,512,585,536
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve të Lashkizës	322,691,040
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali "Gjoni", "Blishta", "Klosi", "Domi", "Luci", "Shoshaj", "Zenishti" dhe "Burreli"	4,069,596,314
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Batra	369,786,250
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Blaç	44,000,032
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Bushtrica 1	506,147,190
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Dars	1,230,440,516
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Dragostunje	39,000,000
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Dukagjini 1 2 3	18,876,907,000
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Grabova 2	1,486,571,351
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Guri i Bardhe	800,908,292

		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali HEC-et ne pellgun ujembledhes te perroit Malind	294,085,200
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Kaskada e Devollit	130,000,000,000
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Lusa	621,368,362
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Malla	176,321,017
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Mbi lumin Shkumbin (9 hece-QUKES)	6,249,092,892
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Mbi perroit e Truenit	192,560,000
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Mbi perroit Sheja e Librazhdit 5 hidrocentrale	492,775,800
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Rapuni 1, Rapuni 2	749,080,000
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Seke	1,177,887,502
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Selca 2 dhe Mesmal	269,981,177
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Sllabinje 2	847,000,000
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Staravecka (Backa 1,2,3)	1,156,808,769
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Stavec	870,315,194

		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Stojan	124,333,623
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Shushice	2,433,789,054
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Shutri 1,2	136,783,700
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Topcias (Rrethi Elbasan)	128,221,000
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Valbona	7,331,612,960
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Valbone	274,000,000
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Vlushe	1,715,320,000
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Zalle Xhuxh 1,2	85,780,000
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Zalli i Qarrishtes	5,273,943,244
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentralit RUNJA	351,244,805
		Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve ARRËZ, SHËNDELLI, SOTIRE, PODE, MESARE, URA, RAJAN 2, RADON, DEDOVE, PESHTAN, OSNATI DHE GRADISHT	837,404,386
		Ndërtim, operim dhe transferim I hidrocentraleve FLETI 1, FLETI 2, FLETI A dhe FLETI B	815,963,996
		Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve KUKUR 1, 2, 3, 4 dhe 5	4,547,551,449

	Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentralit Dragobia	2,404,858,492
	Ndërtim, operim dhe transferim të Hidrocentraleve në Kaskadën e Osumit	30,994,337,216
	Ndërtim, operim dhe transferim, i Hidrocentraleve, Prishta1, Prishta 2,	329,256,843
	Ndërtim, operim dhe transferimin e hidrocentraleve ZAJE, TUJAN, XHAFERAJ, KOLLOVOZ, NOVOSEJË, MËSHTEKËN	223,087,239
	Ndërtim, operim dhe transferimin e hidrocentralit ZEREC	120,311,959
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Arrez 1, Arrez 2, Arrez 3 dhe Arrez 4	295,860,000
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Backa 1, Backa 2, Backa A, Backa B, Backa C	115,680,876
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Ballenjë	138,314,960
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bershi-Klos	250,548,894
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bënçë dhe Tepelenë	675,221,200
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bigas dhe Veleshnje	42,420,000
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bregu i Madh	128,136,000
	Ndërtim, operim,	62,650,250

		transferim e Hidrocentraleve Cangonj	
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Çaje, Reke, Livadhe, Shkinak, Lapaj 2, Bushtrica 1, Bushtrica 2 dhe Bushtrica 3	3,673,402,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Gavran1 dhe Gavran	164,333,245
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Guri I Kuq 1/1 dhe Guri I Kuq 1/2	136,963,790
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Iballe 1, 2, Sapaç 1, 2, Berisha dhe Liqeni, Rrethi Pukë	1,572,169,360
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kaskada e Hec-eve të Hotolishtit	567,859,875
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kasollet e Selcës	526,318,254
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kryezi 3, Kryezi 4 dhe Kryezi 5	131,064,360
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lajthia, Kolesjan, Domaj	123,761,020
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lefter 1, Lefter 2A, Lefter 2B, Lefter 3	208,659,212
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lumzi	1,725,593,333
		Ndërtim, operim,	1,592,690,975

		transferim e Hidrocentraleve mbi Lumin Gjader	
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Meshanik dhe Guvë	216,152,500
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Myhejani 1, Myhejani 2, Myhejani 3	577,625,340
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve në Pellgun Ujëmbledhës të Zallit të Bulqizes/Vajkal-Rrethi Bulqize	587,563,575
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Potam	291,900,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Quki 1 dhe Quku 2	150,894,676
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Steblevë	159,680,320
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Suha 2	360,000,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shkopet 2 dhe Shkopet 3	2,273,383,994
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shpella Poshtë II dhe Shpella Poshtë III	144,560,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shutri	139,666,667
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vendresh, në Pellgun ujëmbledhës Përroi	37,250,000

	Vendreshes, Komuna Vendresh, Rrethi Skrapar	
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vernik 1, Vernik 2, Vernik 3 dhe Vernik 4	971,365,040
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vokopola 1, Vokopola 2 dhe Vokopola 3	497,257,690
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Denas	936,000,000
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Dobrenje-Tomorrice, në Përroin e Hijes, Skrapar	106,780,000
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Kaçinar	315,219,168
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Nishan	212,520,000
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Plepi, në Përroin e Plepit, Komuna Okshtun, Rrethi Diber	86,818,382
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Skatinë	129,541,704
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Shengjon, Komuna Fan, Rrethi Mirditë	101,242,260
	Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Shengjun	349,864,502
	Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve mbi Lumin Curraj, Rrethi Tropojë	13,728,387,330
	Ndërtim, Operim, Transferim i hidrocentralit Poçem	14,134,724,113

		Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Spathare	80,070,750
		Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Suha-1	3,181,563,000
		Ndërtim, operim, transferim i hidrocentralit Labinot Fushë	347,706,122
		Ndërtim, shfrytëzim dhe transferim të Hidrocentraleve Lura 1, 2 dhe 3	1,300,177,500
		Ndërtim. operim, transferim i Hidrocentralit Tuçep 2	166,000,000
		Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentralit Lapaj	1,453,500,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Orgjost i Ri; Ble1, 2; TopoJan 1,2	3,565,744,707
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Belesova 1 dhe 2	46,315,030
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bistrica 3 dhe 4	756,400,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bishnica 1 dhe 2	250,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Borje, Oreshkë, Cernalevë, Cernalevë 1	830,097,322
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Çekrezë 1, 2	123,858,465
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Dobjot i Madh, Arrëz, Miras, Menkulas,	124,254,000

		Bracen, Kuç.	
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Gomsiqe 1,2,3,4	2,149,411,466
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Gostivisht, Langarica3, Ura e Dashit	309,815,533
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Hurdhasi 1, 2, 3	200,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Kozel, Helmes 1 dhe Helmes 2	108,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Lengarica 1 dhe 2	1,980,904,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Nishova 1, 2	89,684,218
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Progonat, Lekdush - Bënçë e Sipërme	929,146,830
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Strelca 1, Strelca 2, Strelca 3	1,084,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Shemri dhe Mgulle	69,026,908
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Shtika 1,2,3,4	87,570,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Zerec 1,2	199,921,096
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Bisak	50,617,908

		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Driza	151,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Hotolisht, Librazhd	424,080,723
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kabash 1 dhe 2	671,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kacni	133,121,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Klos	96,422,100
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit koka 1	392,862,289
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Koxheraj	102,963,375
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kryezi dhe Kryezi i Epërm	50,419,481
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Lumi Treskës	656,545,309
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Lumi Zalli i Okshtunit	4,443,351,400
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Martanesh	857,861,985
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Nicë	49,800,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Ostren i Vogël	46,870,792
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Peqin	521,573,382
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Perrollaj	51,434,808

	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Përroi i Trebishit, Bulqizë	209,336,441
	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Pobreg	995,034,550
	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Qarr Kaltanj	273,892,660
	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Radovë	188,000,000
	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Selishtë	120,000,000
	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Sllabinjë	1,290,117,487
	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Stravaj	503,529,364
	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Shutinë	115,000,000
	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Thanë, Mollas	1,042,888,000
	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Ujanik 2	134,550,000
	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vërtop	283,950,430
	Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vlushë	1,884,040,000
	Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Gur Shpat1, Gur Shpat 2	176,738,773
	Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Sotirë, Sotirë 2	144,554,509
	Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentralit Mollaj	79,700,000
	Ndërtimi operimi	354,282,240

		mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve Lenie, Shalës, Strelcë	
		Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve të kaskadës së lumit Dardhë.	907,956,000
		Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Lena 1, Lena 2, Lena 2-A	311,332,059
		Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Picar 1	35,455,750
		Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Qafëzezë	51,955,070
		Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Verbë - Selcë.	315,570,000
		Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferim te hidrocentraleve Murdhar 1 dhe Murdhar 2	501,411,750
		Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Fterë dhe Fterë 1.	650,565,750
		Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit Çarshovë	83,500,000
		Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit Dishnicë	15,300,000
		Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit Façekuq 1 dhe 2	587,975,273
		Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit	39,000,000

		Lubonjë	
		Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Tervol	325,800,167
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve Kaskada e Luses	743,776,400
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve VRANISHT, STROPAN, GRAPSH-ZICISHT dhe HOCISHT	92,548,781
		Ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Hidrocentralit të ri në Ashta	19,520,000,000
		Për ndërtimin, operim dhe transferim të Hidrocentraleve Veleshica 1, 2, 3, 4, 5, 6 Sllove dhe Bjeshke	3,254,323,134
		Për ndërtimin operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Peshku	188,055,946
		Rehabilitimi, Operimi dhe Transferimi i Hidrocentralit "Labinot-Mal"	12,500,000
		Rehabilitimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit DOMAJ, Has	12,369,610
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali mbi lumin Fan I Madh dhe Fan I Vogel (5 hec-e: gojan, gjegjan, peshqesh, Ura e fanit, fangu), rrethi Mat	13,600,000,000
		Ndërtim, operim dhe transferim Hidrocentralet mbi perroin Zalli I Lunikut	1,702,149,000

		Ndërtim, operim dhe transferim Hec-et mbi lumin Gostime (Egnatia Shushice)	7,806,058,026
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentrali Lunik	786,900,000
Kontrata mbi Baze Tarifore			-
	Kontrate Sherbimesh		-
		"Dhënie me Koncesion/Partnerite t Publik Privat të Shërbimit të Sistemimit dhe Menaxhimit të Parkimit në Qytetin e Vlorës	-
		Krijimi dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të pullave fiskale.	-
		Kryerja e shërbimit të rimorkimit të anijeve, Shërbimi i Sektori i Transportit, Sektori i Transportitimi i Ekuipazheve të anijeve, Operacionet e ngarkim-shkarkimit.	-
		Prodhimi dhe shpërndarja e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike.	-
Sektori i Shendetesise			34,255,592,000
	Kontrate Sherbimesh		34,255,592,000
		Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale.	10,055,472,000
		Shërbimi i Hemodializës	8,706,600,000
		Ofrimi i Shërbimit të Kontrollit Bazë (Check-Up)	6,435,520,000

		Ofrimi i shërbimeve laboratorike spitalore	9,058,000,000
Sektori Tatimor dhe Doganor			28,138,744,824
	Kontrate Sherbimesh		28,138,744,824
		Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë.	27,663,364,824
		Shërbimi i markimit dhe monitorimit të karburanteve	475,380,000

Kontrata te Parashikuara per v.2018			156,717,120,000
Sektori i Arsimit			6,440,000,000
	Ndertim, Operim, Transferim		6,440,000,000
		Ndertimi i Shkollave ne Arsimin Parauniversitar ne Bashkine e Tiranës	6,440,000,000
Sektori i Shendetesise			9,598,120,000
	Ndertim, Operim, Transferim		9,598,120,000
		Spitali Rajonal i Fierit	9,598,120,000
Sektori i Transportit			140,679,000,000
	Ndertim, Operim, Transferim		140,679,000,000
		Ndertimi dhe Operimi i Aksit Tirane-Thumane-Vore	34,307,000,000
		Ndertimi dhe Operimi i Rruges Kardhiq - Delvine	8,652,000,000
		Ndertimi dhe Operimi i Rruges Kashar - Rogozhine	41,580,000,000
		Ndertimi dhe Operimi i Rruges Milot - Balldren	14,280,000,000
		Ndertimi dhe Operimi i Rruges Orikum - Himare	17,808,000,000
		Ndertimi dhe Operimi i Rruges se Arbrit	24,052,000,000
Total Kontrata (Ekzistuese+Parashikim)			661,594,257,243

KËSHILLI I MINISTRAVE